

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

Çështje të sigurisë - 13

ÇËSHTJE TË SIGURISË *Security Issues*

Revistë e përtremuajshme mbi sigurinë

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

Bordi botues:**Kryetar**

Sotiraq Hroni – Drejtor i Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim

Anëtarë

Dr. Arshi Çela

Dr. Arjan Starova

Arjan Dymishi

Ambasador Pëllumb Qazimi (Gjen. R)

Konsulentë

Geron Kamberi – M.A. në Studime Europiane

Artan Karini – M.A. në Administrim Publik

Redaktor përgjegjës

Mariola Qesaraku – M.A. në Studime Bashkëkohore Europiane

Ndihmoi në përgatitje

Jerina Xhaferri

Ky numër reviste botohet me mbështetjen financiare të **Divizionit të Diplomacisë Publike të NATO-s** në Bruksel dhe **Fondacionit Friedrich Ebert**, Tiranë

PËRMBAJTJA

Jos Boonstra

NATO bëhet 60 vjeç: Si mund të vazhdojë e shëndetshme? ... 7

Ted Galen Carpenter

NATO në 60-vjetor: Një aleancë e pakuptimtë 16

Jens Ringsmose dhe Sten Rynning

Kthim në shtëpi, NATO? Koncepti i ri Strategjik i Aleancës
së Veriut 42

Antonio Missiroli

Rishikimi i strategjisë europiane të sigurisë: Përtej 2008-s
dhe përtej politikës së jashtme dhe të sigurisë së
përbashkët (PJSP) 71

Elira Hroni

Karta e Adriatikut – Një model zhvillues dhe ndikues në Ballkanin
Perëndimor 85

Evis Gjebrea

Kriza financiare botërore dhe ndikimi i saj mbi sigurinë 102

Gjen. Pëllumb Qazimi

Kombi shqiptar asnjëherë agresor 127

English summery 145

JOS BOONSTRA

NATO BËHET 60 VJEÇ SI MUND TË VAZHDOJË E SHËNDETSHME?

THEKSIME

NATO-s i duhet të zhvillojë një Koncept Strategjik kompakt dhe realist.

Misioni në Afganistan ISAF nuk është një test mbijetese por një test që dëshmon aftësinë për të drejtuar operacione me distancë të madhe dhe me kohë të gjatë me një seri partnerësh civil.

NATO nuk duhet të shpejtojë për të rindërtuar marrëdhëniet me një Rusi që ka nevojë për kohë për të gjetur vendin dhe pozicionin e saj drejt Aleancës.

Aleanca duhet të vazhdojë politikën e saj me dyer të hapura dhe me kontributin mbi demokratizimin dhe mbrojtjen e vendeve partnere; ato vende që duan të bashkohen me NATO dhe janë gati do të mirëprehen.

Më 3 dhe 4 prill NATO do celebrojë gjashtëdhjetëvjetorin në një samit që do mbahet në Francë (Strasbourg) dhe Gjermani (Kehl/ Baden Baden). Samiti nuk do përfshijë vetëm festime dhe një rishikim të historisë së NATO-s; NATO-s do t'i duhet edhe të jetë vendimtare mbi të ardhmen e saj dhe të dërgojë një mesazh të qartë për rëndësinë dhe urgjencën e detyrave që e presin.

Lajmi i mirë është që NATO po funksionon relativisht mirë krahasuar me organizata të tjera europiane të orientuara mbi sigurinë. BE-ja është e impenjuar me reformat e brendshme dhe ka vendosur zgjerimin në një rol dytësor, ndërsa OSBE-ja ka humbur rëndësinë e saj si rezultat i mosmarrëveshjeve midis anëtarëve lindor dhe perëndimor mbi vlerat dhe qëllimin e saj. Ndërkohë, NATO mirëpret

Francën përsëri në strukturat e saj ushtarake dhe anëtarët janë bashkuar gjerësisht mbi rolet kyçe të NATO-s: ofrimin e garantimit të sigurisë; zhvillimin e marrëdhënieve transatlantike; dhe ndërmarrjen e operacioneve më efektive. Shqipëria dhe Kroacia do hyjnë në Aleancë gjatë samitit; por nga ana tjetër, Maqedonia dhe anëtarja e NATO-s Greqia nuk kanë arritur akoma në një zgjidhje mbi çështjen e zgjatur të emrit, e cila bllokoi anëtarësimin e Shqipërisë dhe Kroacisë.

Lajme të tjera të këqija kanë të bëjnë me luftën në Afganistan, ku luftimet e vazhdueshme po komplikojnë dhe vonojnë në mënyrë serioze përpjekjet për zhvillim dhe rindërtim. Dihet tashmë që NATO-s do t'i duhet të qëndrojë në Afganistan për një kohë të gjatë, por jo të gjithë anëtarët duan të përfshihen duke dërguar trupa apo pësuar viktima. Rënia e kontributeve dhe divizionet politike kanë afektuar dhe misionin me profil më pak të lartë në Kosovë. Kohët e fundit Spanja deklaroi unilateralisht që do tërheqë trupat e saj nga Kosova, duke rritur midis partnerëve të NATO-s përshtypjen që është një anëtar që përfiton nga Aleanca pa marrë pjesë në të. Lajme të këqija vijnë edhe nga Rusia, e cila vazhdon ta shikojë NATO-n si një bllok armiqësor në vend të një partneri; nga kjo situatë e zgjatur mbeten të viktimizuara Gjeorgjia dhe Ukraina.

NATO-s do t'i duhet gjithashtu të gjej një Sekretar të Përgjithshëm të ri meqenëse mandati i dytë i Scheffer-it po përfundon. Kjo mund të jete e vështirë, pasi kandidatët që kanë kritikuar ashpër Rusinë ose që shikohen negativisht nga bota Islamike lihen jashtë. Një SP i ri duhet të përfaqësojë unitet të brendshëm dhe të promovojë partneritetin me të gjithë partnerët e NATO-s; samiti i përvjetorit do shpërndajë këtë mesazh të përgjithshëm.

Ndërsa NATO arrin në moshën 60 vjeç, asnjë anëtar nuk mendon në tërheqjen e Aleancës. Megjithatë, Aleancës do t'i duhet t'i përshtatet mjedisit aktual ndërkombëtar dhe sfidave të reja të sigurisë. Këto me poshtë janë pesë veprime që do ndihmojnë NATO-n të qëndrojë e shëndetshme në moshën 60-vjeçare.

Thjeshtësi në konsum

Së pari, NATO duhet të jetë e kujdesshme për të mos kaluar aftësitë e saj ndërsa shtetet anëtare vazhdojnë të ulin buxhetin mbi mbrojtjen dhe nuk janë entuziastë për të kontribuar në operacione. Gjatë samitit, NATO planifikon të fillojë procesin e rishikimit të Konceptit të tij Strategjik të vitit 1999. Takimi i përvjetorit ka shume gjasa që të prodhojë një Deklaratë mbi Sigurinë e Atlantikut për të përsëritur drejtimin e përbashkët. Sigurisht që kjo nuk mund të zëvendësoj Kartën e Atlantikut por shërben si një pikënisje për të draftuar një Koncept të ri Strategjik që duhet të jetë gati përpara 2011-ës.

Koncepti Strategjik është korniza politike e zgjeruar që shpjegon qëllimin e NATO-s dhe thekson perspektivat strategjike të saj. Koncepti i 1999-s duhet të azhurnohet për të marrë parasysh 11 Shtatorin, luftën pasuese mbi terrorin, pranimin e shtatë anëtarëve të rinj në NATO dhe zhvillimin e Politikave Europiane të Sigurisë dhe Mbrojtjes (PESM). Duhet që të lidhet më shumë me Strategjinë e Sigurisë Europiane të vitit 2003, përfshi raportin e saj të azhurnuar që u shfaq në dhjetor 2008. Koncepti i ri ofron gjithashtu një rast për një nisje të freskët mbas ndarjes së dy administratave të Bush-it.

Një axhendë dinamike mund të ishte jo produktive dhe mund të ndërhynte në territorin e institucioneve të tjera si BE, OSBE, dhe Organizata për Bashkëpunimin dhe Zhvillimin Ekonomik (OBZE). Një shembull i qartë i kësaj është sigurimi i energjisë. NATO ka debatuar vite me radhë mbi faktin se cili duhet të jetë roli i saj në çështje: disa kanë argumentuar që një rol në sigurinë e energjisë do të përkeqësonte më tej marrëdhëniet me Rusinë, ndërsa të tjerë kanë propozuar një 'energji NATO.' Koncepti Strategjik duhet të ndihmojë për të gjetur një kontribut realist këtu, me rolin e NATO-s të kufizuar për të mbrojtur infrastrukturën e lidhur me energjinë e dobët dhe rrugët kryesore të transportit. Kjo aplikohet në një varietet temash të tjera të tilla si sigurimi i mjedisit ose mbi misionet 'jashtë zone'. NATO nuk duhet të përjashtojë përfshirjen, por nuk duhet të bëjë më shumë në qoftë se do të qëndrojë efektive.

Shumë ushtrime

Në moshën 60 vjeçare NATO duhet të qëndrojë e gatshme dhe e aftë të arrijë sfidat ushtarake. NATO është si një organizatë politike ashtu dhe ushtarake dhe ashtu duhet të ngelet. Fundi i Luftës së Ftohtë e shtyhu NATO-n për të kërkuar një qëllim të ri, gjë e cila rezultoi jo vetëm në procesin e zgjerimit dhe në kushtëzimin e asistencës demokratike për vendet partnere por edhe te nevoja për tu përfshirë në misione 'jashtë zonës'. Në këtë poçes NATO-ja është shndërruar më e orientuar politikisht. Nevoja për të arritur konsensus në misionet paqësore në Ballkan dhe tani në Afganistan e ka çuar atë në terren të vështirë politik, por Aleanca nuk duhet të humbasë gjurmët e themelimit kryesor të saj, që është kryesisht ushtarak.

Sfida më e dukshme është lufta në Afganistan, ku misioni ISAF nuk është i aftë të lëviz nga një konflikt i plotë me talebanët në rindërtim dhe në një aksion të koordinuar me organizatat civile. Paqëndrueshmëria dhe paaftësia e Pakistanit për tu kundërvepruar talebanëve në territorin e tyre është shumë problematike, por edhe fqinjë të tjerë krijojnë vështirësi për NATO-n dhe SHBA-në në bërjen e progresit në Afganistan. Këto përfshijnë shtete të ndryshme të Azisë Qendrore që nuk kanë qenë bashkëpunuese në dhënien e mbështetjes: Uzbekistani u ndje i paaftë për të ndërthurur marrëdhëniet me Rusinë dhe Vendet Perëndimore dhe i ndryshoi preferencat e tij brenda natës, ndërsa Kirgistani zgjodhi fondet e shpejta nga Rusia ndaj marrëdhënieve të shëndetshme me Uashingtonin dhe kohët e fundit ka mbyllur bazën ushtarake të SHBA-së në vend.

Nga brenda, NATO ka problem serioze në mbledhjen e mbështetjes midis anëtarëve të saj europianë. Ndërsa SHBA-ja po planifikon rritje substanciale në trupa në muajt e ardhshëm, mbetet për të parë në qoftë se europianët do ta ndjekin shembullin.

Aleancës do t'i duhet t'i përshtatet mjedisit aktual ndërkombëtar dhe sfidave të reja të sigurisë.

Disa nuk dëshirojnë të investojnë fonde, trupa dhe materiale në zona me rrezik të ulët ose në luftë të vërtetë; të tjerë thjesht nuk kanë eksperiencën dhe forcat e kualifikuara për të kontribuar në stabilizimin e provincave jugore dhe lindore të Afganistanit.

Të ashtuquajturat paralajmërimet kombëtare komplikojnë më shumë misionin ISAF, me

trupat që operojnë me mandate të ndryshme në terren. Samiti duhet të shmange matjen e suksesit mbi bazën e kujt shteti anëtar ofron trupa andej këtej, në vend të kësaj duhet që të përdoret si një platformë për tu fokusuar në transformimet e nevojitura për të arritur sfidat bashkëkohore ushtarake.

Përfitim nga eksperiencia

NATO ka akumuluar aq eksperiencë sa që e bën më të kompletuar me të tërë. Gjatë Luftës së Ftohtë fokusimi ishte drejt lindjes dhe kjo qëndroi edhe mbas vitit 1991, edhe pse më vonë ishte nëpërmjet partneritetit dhe zgjerimit. Ka qenë më e vështirë për NATO-n për të zgjeruar horizontin e saj në rajone të tjera, veçanërisht në Afrikën Veriore dhe Lindjen e Mesme. NATO ka dialogun e saj të Mesdheut dhe procesin e Bashkëpunimit me Stambollin, por në praktikë vazhdon të punojë kryesisht me vendet e Ballkanit dhe ish republikat sovjetike. Që nga Luta Ruso-Gjeorgjiane e gushtit 2008 dhe pozicionet negative të Moskës, duket legjitime për NATO-n që të fokusohet përsëri në 'paragjykimin lindor' të saj meqenëse është rajoni ku NATO ka eksperiencë dhe mund të kontribuoj në reformat dhe në stabilitet.

NATO ka sinjalizuar që do filloj përsëri bisedimet me Rusinë nëpërmjet Këshillit NATO-Rusi. E ka bërë dhe më parë këtë para samitit për të shmangur tensionet e larta Ruso-Gjeorgjiane në axhendë, por është e paqartë në qoftë se NATO do t'i rikthehet plotësisht 'të zakonshmes'. Rusia nuk ka bërë

lëshime por as sinjale. A do jenë bisedimet e rinovuara me Rusinë mbi çështje thelbësore si kontrolli i armëve, bashkëpunimi në Afganistan dhe mbrojtja raketore (të cilat mund të jenë coptuar nga administrata Obama)? Apo thjesht do përsërisin linjën vazhduese mbi njohjen e Abkazisë dhe Osetisë së Jugut nga Gjeorgjia dhe Rusia.

NATO nuk duhet të shpejtojë të komfortojë Rusinë pa pasur më parë sinjale pozitive nga Moska. Rusia po dërgon trupa në Abkazi dhe Osetinë e Jugut duke injoruar integritetin territorial të Gjeorgjisë. Kremlini preferon të luftojë beteja gjeopolitike në Azinë Qendrore mbi baza ushtarake në vend që të mbështesë misionin e NATO-s në Afganistan. Rusia e sheh NATO-n si një bllok ushtarak, pra si një kërcënim. Rusia është duke ndërtuar identitetin e saj, kjo ka çuar në konsiderimin e NATO-s në një armik dhe përdorimin e një retorike shumë negative. Administrata e re Obama duhet të bindë Rusinë të ndërmarrë një përqasje më pozitive, kriza ekonomike dhe rënia e çmimeve të naftës që kanë prekur Rusinë mund të shtyjnë Kremlinin drejt një sjelljeje më bashkëpunuese.

Përqendrim në forcat kyçe

NATO ka qenë gjerësisht i suksesshëm në përpjekjet e tij për të stabilizuar Ballkanin dhe me procesin e zgjerimit, dhe duhet të mbetet e përqendruar në të dyja deri në përfundim. Shqipëria dhe Kroacia do t'i bashkohen Aleancës gjatë samitit, por Maqedonia që është e mirë përgatitur njësoj, është e bllokuar nga Greqia.

Operacioni i dytë më i madh i NATO-s është akoma aktiv në Kosovë dhe mbetet thelbësor për të shmangur violencën midis serbëve kosovarë dhe kosovarëve. Trupat e KFOR-ti do të reduktohen gjatë viteve në vazhdim ndërsa misioni civil EULEX po forcohet shpejt. Mbetet akoma për të gjetur një zgjidhje për Mitrovicën, pjesa veriore e Kosovës e banuar kryesisht nga Serbët dhe e kontrolluar gjerësisht nga Beogradi, ku një prani e KFOR-it do të mbetet e nevojshme. Vendet e

NATO-s nuk kanë qenë në gjendje të bien dakord mbi një format të qartë partneriteti midis Kosovës dhe NATO-s. Ndërkohë, marrëdhëniet e NATO-s me Serbinë janë përmirësuar, por integrimi i Serbisë mbetet një perspektivë e largët për shkak të trashëgimisë së bombardimeve të vitit 1999. Dy anëtarët e tjera të Partneriteti për Paqe (PpP) në Europën Juglindore - Bosnja dhe Hercegovina (BiH) dhe Mal i Zi - përmbajnë më pak çështje serioze për NATO-n, meqenëse të dyja bashkëpunojnë me NATO-n por anëtarësimi është i largët.

Sfida më e madhe e NATO-s në zgjerim ka të bëjë me Gjeorgjinë dhe Ukrainën. Në samitin e vitit të kaluar në Bukuresht, Aleanca e bëri të qartë që të dyja vendet do anëtarësohen por nuk pranoi të kalonte nga bisedimet për partneritetet në bisedimet për anëtarësim. Anëtarë të ndryshëm të NATO-s kanë pikëpamje të ndryshme mbi aplikimin e këtyre vendeve, nga ku disa besojnë që NATO duhet të kritikojë Rusinë me perspektivën për të vazhduar, ndërsa të tjerë preferojnë të injorojnë Moskën dhe të përfitojnë nga rëndësia strategjike që të dyja vendet ofrojnë. Disa vende argumentojnë që anëtarësimi i shpejtë do të çonte në rritjen e stabilitetit dhe në një demokraci efektive, ndërsa të tjerë argumentojnë në vazhdimin e rrugës që nxit thellimin e reformave para zgjerimit.

Mbështetja e publikut për anëtarësimin në Ukrainë mbetet nën gjysmën e popullsisë. Gjeorgjia u kthye mbrapa nga lufta e Gushtit, meqenëse zgjidhja e dy konflikteve ‘të ngrira’ në territorin e saj - Abkazi dhe Oseti e Jugut - është bërë më e vështirë tani që ato janë njohur si shtete të pavarura nga Rusia. Kredencialet demokratike të President Saakashvili-t nuk janë përmirësuar dhe vendi është politikisht i paqëndrueshëm. NATO duhet t’i japi mbështetje aktive procesit reformativ të Gjeorgjisë, veçanërisht në sektorin e mbrojtjes. Politika e vjetër ‘me dyer të hapura’ duket se është e vetmja politikë e arsyeshme dhe efektive në këtë aspekt.

Mbajtja e interesit në zhvillimet personale

NATO duhet të mbetet entuziaste në zhvillimin e mëtejshëm të partneritetit të saj, të cilët janë të fortë por edhe të mbi-ngatërruar dhe disa herë jo-efektivë. Më kryesorja është marrëdhënia me BE-në, e cila ka zhvilluar kapacitetet e veta të mbrojtjes dhe tani drejton misione nëpërmjet PESM-it. Një shenjë e veçantë pozitive e përfundimit të marrëdhënies dhe veçanërisht koordinimit do të jetë ri-integrimi i Francës në strukturën ushtarake të NATO-s. ndërkohë, një ndarje më e qartë e roleve, por edhe shpërndarja e burimeve në një mënyrë efektive, do të jetë tema kryesore në sfidat e sigurisë.

Ndërsa marrëdhëniet BE-NATO kërkojnë konsolidime të mëtejshme, programi ekzistues PpP (Partneritet për Paqe) nevojit reforma ose rrezikon të bëhet jo-efektiv. Në vend që bashkoj akronime konfuzuese (IPP, PAPDIB, PAP-T, IPAP, Dialogë Intensifikues, dhe MAPs) PpP-ja duhet të thjeshtëzohet. Duhet të bëjë një dallim të qartë midis vendeve të hapura për bashkëpunim por jo entuziaste për reforma demokratike dhe atyre që dëshirojnë të përfshihen në të fundit. Kjo do të jetë e vështirë meqenëse si NATO ashtu dhe partnerët nga Europa dhe Euro-Azia janë mësuar me PpP-në gjatë viteve. Do të jetë logjike përfshirja e partnerëve të Mesdheut dhe të Lindjes së Mesme në PpP: edhe pse Dialogu i Mesdheut, dhe në një nivel më të ulët, iniciativa e Bashkëpunimit të Stambollit janë të modeluara mbi PpP, aktualisht këto nuk janë pjesë e negociatave të Këshillit të Partneritetit Euroatlantik (KPEA). Një PpP e gjerë do të përfshinte vende të interesuara në bashkëpunim strategjik, vende demokratike Perëndimore jo anëtare të NATO-s, regjimet autoritare që kanë si synim të paktën të hapin kanale komunikimi dhe vendet me një perspektivë anëtarësimi. Ndërsa këto vende janë bashkuar në një forum transatlantik, ato duhet të ndahen sipas dëshirës për anëtarësim dhe kredencialeve demokratike; NATO pra mund t'i qëndroj besnik vlerave për të cilat është krijuar për të mbrojtur.

Konkluzion

Dy temat kryesore të samitit të përvjetorit do jenë Afganistani dhe nisja e një procesi për draftimin e një Koncepti Strategjik të ri. Edhe pse NATO ka treguar që do të ri-hapë bisedimet me Rusinë mbas samitit, situata në Gjeorgji do të jetë e vështirë për tu injoruar.

NATO është akoma e rëndësishme, por duhet të jetë e kujdesshme për të mos marrë më detyra ose misione jashtë zonës euroatlantike. Një rritje e tillë do të rrezikonte në humbjen e objektivave ushtarake dhe të mbrojtjes dhe do rriste pyetjen ‘kush vjen më pas?’. Në qoftë se NATO arrin sukses në kombinimin e kontrollit të konsumit dhe të qëndruarit fizikisht në formë me zhvillimin e eksperiencës, do të qëndrojë e shëndetshme. Skena ndërkombëtare e sigurisë është një ambient pune jo i shëndetshëm me rreziqe thelbësore në punë. Sigurisht që nuk ka nevojë për një dalje në pension, pjesërisht sepse nuk ka një seri institucionesh të reja të post-Luftës së Ftohtë që mund të marrin përsipër situatën. Por, nga ana tjetër, shumë punë ekstra do të çonte në stres dhe lodhje. NATO është e shëndetshme por duhet që të planifikojë të ardhmen me kujdes. Kontrolli shëndetësor i ardhshëm: Portugali, në fund të vitit 2010/ fillim 2011.

*Jos Boonstra është Senior researcher,
Programi mbi Demokratizimin, FRIDE*

TED GALEN CARPENTER

NATO NË 60-VJETOR: NJË ALEANCË E PAKUPTIMTË

Ndërsa Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut feston 60-vjetorin e saj, ka shenja të theksuara shqetësimi brenda aleancës dhe arsye për të dyshuar rëndësinë e organizatës në lidhje me sfidat e politikës së jashtme të shekullit XXI. Disa zhvillime i kontribuojnë këtyre dyshimeve.

Megjithëse NATO ka shtuar shumë anëtarë të rinj gjatë dekadës së fundit, shumica e tyre zotërojnë aftësi të kufizuara ushtarake. Disa prej tyre kanë gjithashtu sisteme të turbullt politikë dhe marrëdhënie të diskutueshme me shtetet fqinjë, përfshirë (dhe më shqetësuesen) Rusinë, e cila zotëron armë nukleare. Kështu anëtarët e rinj të NATO-s janë të dobët, të pambrojtur dhe provokues - një kombinim veçanërisht i rrezikshëm për Shtetet e Bashkuara të Amerikës në rolin e drejtuesit të NATO-s.

Ka gjithashtu një shtim të mosmarrëveshjeve në aleancë rreth mënyrës se si do të sillen me Rusinë. Më të vjetrit, fuqitë e Europës Perëndimore synojnë të favorizojnë një politikë të matur, ndërmjetësimi, ndërsa vendet e Europës Qendrore dhe Lindore mbështesin më tepër një qasje ballafaquese të vijës së fortë. Shtetet e Bashkuara të Amerikës gjenden në mes të kësaj grindjeje brenda aleancës. Ndoshta më shqetësueset, janë nivelet e shpenzimeve të mbrojtjes dhe aftësitë ushtarake të anëtarëve kryesorë europianë të NATO-s gjatë këtyre viteve të fundit. Rrënimi i këtyre forcave ushtarake ka arritur në atë pikë që udhëheqësit amerikanë tashmë shqetësohen që operacionet e përbashkëta midis tyre dhe forcave amerikane po vështirësohen, në mos po bëhen të pamundura. Paefektshmëria e ushtarakëve europianë është gjithashtu e dukshme në performancën qorrollisëse të NATO-s në Afganistan.

NATO i ka mbijetuar çfarëdo problemi ka pasur. Sipërfaqësisht, ajo mbetet një institucion impresionues, por është bërë një guaskë e zbrazët - shumë më tepër një shoqëri politike nderi sesa një organizatë kuptimplotë sigurie. Ndërkohë për aq sa organizata ekziston, mbetet një mjet për shtetet europiane për t'u mbështetur gratis në angazhimet amerikane në vend që të shpenzojnë në mënyrë adekuate për mbrojtjen e tyre dhe të marrin përgjegjësinë për sigurinë në rajonin e tyre. Thirrjet amerikane për një ndarje më të madhe të përgjegjësisë janë madje më të padobishme sot sesa kanë qenë gjatë 60 viteve të fundit. Derisa Shtetet e Bashkuara të Amerikës t'i ndryshojnë stimuluesit duke tërhequr trupat e tyre nga Europa dhe duke i shtuar angazhimet e saj kundrejt NATO-s, europianët do të vazhdojnë të lumtur t'i shmangin përgjegjësitë e tyre.

Sot, NATO është një marrëveshje e keqe për Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ne kemi detyrime sigurie kundrejt vendeve që i shtojnë shumë pak fuqisë sonë ushtarake. Madje më keq, disa prej këtyre vendeve mund ta ngatërrojnë lehtësisht Amerikën në zënka të rrezikshme lokale. Ka ardhur koha për t'i dhënë fund kësaj aleance mosfunksionuese gjithnjë e më tepër.

Hyrje

Ndërsa NATO sipërfaqësisht mbetet një organizatë impresionuese, aftësia e saj për të qenë një mekanizëm efektiv i sigurisë po venitet me shpejtësi.

NATO feston 60-vjetorin e saj më 4 prill. Do të ketë festime të shumta, jo vetëm për jetëgjatësinë e organizatës dhe sukseset në të shkuarën, por edhe rreth qëllimeve të saj në dekadat që do të pasojnë. Pikëpamja që aleanca është në të njëjtën kohë një aktor i shëndetshëm dhe kryesor politik dhe i sigurisë në shekullin XXI është përforcuar nga qëndrimi i dukshëm i fuqisë udhëheqëse të qeverisë së re të NATO-s, Shtetet e Bashkuara

të Amerikës. Administrata e George W. Bush shpesh është dukur se ka preferuar një qasje unilaterale të marrëdhënieve të punëve të jashtme, dhe udhëheqësit amerikanë me raste kanë treguar një përçmim për disa nga aleatët europianë të Uashingtonit - kujtojmë referencën ironike të Sekretarit të Mbrojtjes Donald Rumsfeld për “Europën e Vjetër” duke përshkruar Gjermaninë, Francën dhe vendet e tjera të Europës Perëndimore të cilat ishin kundër politikës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Irak.

Përkundrazi skuadra e politikës së jashtme të Presidentit Barak Obama ka theksuar në mënyrë të vazhdueshme angazhimin e saj kundrejt multilateralizmit në përgjithësi dhe NATO-s në veçanti. Gjatë dëgjimeve përforcuese përpara Komitetit të Marrëdhënieve me Jashtë të Senatit, Sekretaria e Shtetit Hillary Clinton, theksoi se politika e Uashingtonit duhet të jetë ajo e “fuqisë së zgjuar”. Midis aspekteve të tjera Clinton shpjegoi se fuqi e zgjuar “nënkupton fuqizimin e aleancave që i kanë qëndruar sprovës së kohës, kryesisht me partnerët tanë të NATO-s dhe me aleatët tanë në Azinë Lindore.

Optimizmi i shfaqur në të dyja anët e Atlantikut, gjithsesi, nuk mund të fshehë shtimin e dyshimeve rreth relevancës së sfidave politike të NATO-s të shekullit XXI, dhe, me të vërtetë, rreth jetëgjatësisë së organizatës në afat të gjatë. Ndërsa NATO sipërfaqësisht mbetet një organizatë impresionuese, aftësia e saj për të qenë një mekanizëm efektiv i sigurisë po venit me shpejtësi. Ka një thënie popullore thumbuese në Teksas për njerëzit të cilët kanë një reputacion të rëndësishëm, por zotërojnë informacion të paktë: “të gjithë kanë kapele, por asnjë dele”: që i përshtatet aktualisht NATO-s. Ka shenja të pagabueshme shqetësimi në disa aspekte: si dobësia dhe vulnerabiliteti i anëtarëve të rinj dhe i anëtarëve të ardhshëm; politikat e ngathëta të aleancës që kanë krijuar tensione serioze me Rusinë; shtimi i ndarjeve brenda aleancës në lidhje me politikën kundrejt Rusisë; performanca anemike e NATO-s në Afganistan; dhe dobësimi alarmues i aftësive ushtarake të anëtarëve europianë kryesorë të aleancës.

Zgjerimi i NATO-s: Duke shtuar anëtarë ushtarakisht të paaftë dhe vulnerabël

Në prill 2008 në Samitin e NATO-s në Bukuresht udhëheqësit e Aleancës i dhanë shpresë për një anëtarësim të mundshëm dy shteteve të tjera: Kroacisë dhe Shqipërisë. Deklarata e Samitit pohonte: “Sot, ne kemi vendosur të ftojmë Shqipërinë dhe Kroacinë të fillojnë bashkëbisedimet e pranimit për t’u bërë pjesë e Aleancës sonë”. Ne i përgëzojmë këto vende për këtë arritje historike, të fituar me punë të vështirë gjatë viteve dhe angazhimin që tregojnë kundrejt sigurisë sonë dhe ndarjes së vlerave të përbashkëta të NATO-s. Pranimi i këtyre vendeve do të forcojë sigurinë për të gjithë në zonën euroatlantike”. Një shtet tjetër ballkanas, Maqedonia, mund të kishte marrë një ftesë nëse nuk do të kishte qenë për mosmarrëveshjen e fshehtë të pazgjidhur midis saj dhe Greqisë, vend anëtar i NATO-s në lidhje me përdorimin e emrit “Maqedoni” - për të cilin Athina pretendon se i përket ekskluzivisht një rajoni në Greqi.

Shtimi i propozuar i Kroacisë dhe i Shqipërisë përfaqëson raundin e tretë të zgjerimit për aleancën. Ky vendim thekson gjithashtu venitjen e sigurisë së NATO-s dhe cilësitë përherë e më të dyshimta në periudhën e pas Luftës së Ftohtë. Shtimi i vendeve të vogla me karakteristika të turbullta politike, me aftësi ushtarake të parëndësishme, dhe marrëdhënie të pasigurta me shtetet fqinjë është një zhvillim që është kryesisht i drejtpërdrejtë nga pikëpamja e interesave të sigurisë së Amerikës duke pasur parasysh detyrimet e këtij vendi si udhëheqës i aleancës. Shtimi i këtyre anëtarëve nuk bën asgjë për të shtuar fuqinë e madhe ushtarake të Shteteve të Bashkuara të Amerikës ose të rrisë sigurinë e popullit Amerikan. Gjithë ajo çfarë mund të shkaktojë zgjerimi është një dhembje potenciale koke për Uashingtonin.

Dikur NATO ka qenë një aleancë serioze me një qëllim serioz. Gjatë Luftës së Ftohtë ajo shmangu që Bashkimi Sovjetik të frikësonte apo (ose të paktën) të sulmonte Europën Perëndimore Demokratike - një rajon i një rëndësie të veçantë strategjike dhe ekonomike. Është e vërtetë që Shtetet e

Bashkuara të Amerikës kanë luajtur gjithmonë një rol dominues në aleancë, por Uashingtoni mund të mbështetet te fuqitë dytësore më të njohura ushtarakisht, Britania, Franca, Gjermania, Italia dhe Turqia. Ky nuk është më rasti.

Aleatët e vegjël

Anëtarët e rinj që Aleanca ka pranuar që nga fundi i Luftës së Ftohtë janë shtete të dobët që presin Shtetet e Bashkuara të Amerikës t'i mbrojnë. Kjo ishte krejtësisht e vërtetë madje që në raundin e parë të zgjerimit që shtoi vendet e përmesave mesatare si Polonia, Republika Çeke dhe Hungaria. U bë akoma dhe më evidente në raundin e dytë që përfshiu aktorë akoma më të vegjël ushtarakisht si Sllovakia, Sllovenia, Latvia, Lituania dhe Estonia. Këto mikro aleatë janë konsumues të sigurisë dhe jo prodhues të saj. Nga pikëpamja e interesave të Amerikës, ata nuk përbëjnë një kapital, por janë një përgjegjësi - dhe potencialisht përgjegjësi shumë të rrezikshme.

Duke marrë përsipër detyrimin e mbrojtjes së vendeve baltike NATO bën një hap aspak inteligjent, pasi tani i vendos një sfidë gjeopolitike Ruisë, në pragun e derës së Moskës. Marrëdhëniet midis Ruisë dhe fqinjëve të vegjël baltikë janë gjaknxehta dhe të paqëndrueshme. Për momentin Rusia mund të jetë shumë e dobët për të sfiduar angazhimet e sigurisë së SHBA/NATO kundrejt këtyre vendeve, por ne nuk mund të jemi të sigurtë që do të jetë kështu e vërtetë gjithmonë.

Miratimi i anëtarësimit në NATO për Kroacinë dhe Shqipërinë konfirmon që aleanca tashmë ka hyrë në botën e farsës. Kapacitetet ushtarake të këtyre dy vendeve janë mjaft të vogla. Sipas edicionit të 2009 të *Bilancit Ushtarak*, të botuar nga Instituti Ndërkombëtar për Studimet Strategjike, buxheti i Kroacisë për ushtrinë është vetëm 962 milion dollarë, dhe numri i personelit ushtarak aktiv në detyrë konsiston në 18,600 individë. Buxheti i Shqipërisë për ushtrinë llogaritet në 233 milion dollarë dhe numri i forcave të armatosura të saj llogaritet në 14,295. Këto do t'i shtohen 425 milion dollarëve dhe 5,300

trupave të Estonisë, 513 milion dollarëve dhe 8,850 trupave të Lituanisë, dhe 576 milion dollarëve dhe 7,200 trupave të Sllovenisë. Duke mos i ofruar anëtarësinë Maqedonisë, NATO do të bëjë pa 163 milion dollarët dhe 10,890 trupat e Shkupit. Kolektivisht këto vende shpenzojnë më pak në ushtritë e tyre në një vit sesa Shtetet e Bashkuara të Amerikës në Irak në dy javë.

Anëtarët e rinj janë sa të rrezikshëm aq edhe të panevojshëm

Këta anëtarë të rinj nuk janë thjesht të padobishëm; ata përbëjnë potencialisht një pengesë për aleancën, dhe një rrezik të mundshëm serioz. Kur zëvendës-presidenti Dick Cheney gjatë një vizite në Ballkan në 2006 afirmoi se anëtarët e rinj do të ndihmojnë në “përtëritjen” e NATO-s dhe ridedikojnë aleancën “drejt vlerave bazë dhe kryesore të lirisë dhe demokracisë”, ai tregoi se sa e largët me realitetin ishte tashmë politika e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe e NATO-s.

Miratimi i Anëtarësisë në NATO për Shqipërinë dhe Kroacinë, konfirmon që aleanca tashmë ka hyrë në mbretërinë e farsës.

Kroacia vetëm pak vite më parë shfarosi regjimin fashist të Franjo Tudjman dhe vazhdon të ketë marrëdhënie të ngrira me fqinjën e saj Serbinë. Shqipëria është një aleat i ngushtë i Shtetit të ri të dominuar kryesisht nga shqiptarë, një entitet pavarësinë e të cilit si Serbia ashtu edhe Rusia (si edhe shumë vende të tjera) nuk e njohin dhe e kundërshtojnë furishëm. Shqipëria është gjithashtu e njohur se është nën influencën e krimit të organizuar. Mafia shqiptare në fakt është e njohur në të gjithë Europën, pasi kontrollon pjesën më të madhe të kumarit, prostitucionit dhe trafikut të drogës.

Përpjekjet për të shtuar Ukrainën dhe Gjeorgjinë në aleancë, një politikë e nxitur nga administrata e Presidentit Bush dhe e miratuar nga administrata e Presidentit Obama, do të ishin madje më të këqija se ato të raundit të parë të zgjerimit.

Marrëdhënia e Ukrainës me Rusinë është pothuajse kontencioze. Marrëdhënia me Gjeorgjinë është natyrisht madje më e keqe sesa ajo e çështjes së luftës së konfirmuar verën e kaluar. Amerikanët e arsyeshëm kanë psherëtirë të çliruar që Gjeorgjia nuk ishte anëtare e NATO-s në kohën kur shpërtheu konflikti.

Mbështetësit e zgjerimit të NATO-s drejt lindjes ngandonjëherë veprojnë sikur aleanca të ishte tashmë thjesht një shoqëri politike nderi. Logjika e tyre kryesore është që, duke qenë se shtetet e Europës Lindore janë bërë tashmë demokraci kapitaliste, ata e meritojnë të jenë anëtarë të klubit më të spikatur perëndimor. Por pothuajse të gjithë anëtarët më të rinj të NATO-s, të cilët janë më të shqetësuarit rreth ndryshimeve të pavalitshme të sigurisë të përhapura nga Rusia, e konsiderojnë aleancën më tepër sesa një organizëm politik. Ata kanë shpresë në mbrojtjen konkrete nga plaçkitjet e fqinjit të tyre të madh lindor. Dhe, po kaq e rëndësishme, është se edhe Moska nuk e shikon personifikim aktual të NATO-s thjesht me natyrë politike.

Konflikti i Gjeorgjisë duhet të na kujtojë nëse NATO është akoma zyrtarisht shumë më tepër sesa një klub politik. Ajo mbetet një aleancë ushtarake me detyrime gjithë përfshirëse veçanërisht për Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Neni 5 i Traktatit të Atlantikut të Veriut deklaron se një sulm kundër njërit prej anëtarëve të NATO-s është një sulm kundër të gjithëve. Kjo do të thotë se Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë të detyruara të asistojnë në mbrojtjen e çdo anëtari - nuk ka rëndësi sa i vogël mund të jetë, sa i parëndësishëm ushtarakisht apo ekonomikisht ose sa i ekspozuar strategjikisht mund të jetë ky anëtar.

A janë angazhimet e sigurisë së NATO-s një bluf strategjik?

Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë të detyruara të asistojnë në mbrojtjen e çdo anëtari - nuk ka rëndësi sa i vogël mund të jetë, sa i parëndësishëm ushtarakisht apo ekonomikisht ose sa i ekspozuar strategjikisht mund të jetë ky anëtar.

Kjo i përafrohet në mënyrë të rrezikshme të qenit një bluf strategjik. Lufta midis Rusisë dhe Gjeorgjisë ilustron natyrën e shtirur të aftësisë së NATO-s për të mbrojtur anëtarët e vegjël dhe vulnerabil. E vërteta është se Gjeorgjia nuk ishte një anëtar i Aleancës, dhe prandaj Neni 5 nuk mund të gjente zbatim. Por ishte e qartë që vendi ishte një klient - ndonëse një klient jo zyrtar - i Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Udhëheqësit Amerikanë gjithmonë e kanë brohoritur Presidentin Gjeorgjian Mikheil Saakashvili si një mik të Amerikës dhe si një simbol të reformave demokratike në atë pjesë të botës. Mençuria klasike hamendësoi që Rusia nuk do të shqetësonte kurrë atë klient. Dhe Gjeorgjianët natyrisht që dukeshin të pritnin ndihmën, nëse do të lindte ndonjë shqetësim. Si raportuan dhe korrespondentët e *New York Times* Andrew E. Kramer dhe Ellen Barry, nga Gjeorgjia gjatë ditëve të para të luftimit, kur trupat gjeorgjianë që tërhiqeshin u takuan me gazetarët Perëndimorë, “ata të gjithë thanë të njëjtën gjë: Ku janë Shtetet e Bashkuara Amerikës? Kur do të vijë NATO?” Sërish Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe NATO nuk bënë asgjë më tepër sesa zhurmë dhe shqetësim të kotë kundër ofensivës ushtarake të Rusisë dhe ofruan ndihmë për rindërtimin e Tbilisit pas luftës. Përgjigjja anemike si e NATO-s ashtu edhe Bashkimit Europian inatosi përkrahësit e vijës së fortë në Perëndim. Një shkrim i *Wall Street Journal* në mënyrë shpotitëse e përshkroi këtë politikë si atë të “Ndal! Ose Ne do të themi Ndal Sërish!”.

Disa analistë u shprehën të bindur se nëse Gjeorgjia do të kishte qenë anëtare e NATO-s, Rusia do të ishte tërhequr. Gazetari George Will, për shembull, shtroi pyetjen: “Nëse Gjeorgjia do të ishte në NATO, a do të ishte NATO në luftë me Rusinë? Ka shumë të ngjarë” konfirmoi ai se “Rusia nuk do të kishte qenë në Gjeorgji”.

Ndoshta. Por ka një arsye për të qenë skeptik për atë konkluzion. Realiteti është se nëse Uashingtoni dhe partnerët e tij të NATO-s do të përpiqeshin t'i përmbaheshin angazhimeve të tyre sipas Nenit 5 sepse shpërtheu një konflikt midis Rusisë dhe një vendi të vogël anëtar të aleancës, ata do të rrezikonin luftën me një kundërshtar të armatosur

nuklearisht. Ky kërcënim mund të kishte pasur një besueshmëri të arsyeshme gjatë Luftës së Ftohtë kur duhej mbajtur Europa Demokratike, si rezultat i rreziqeve të përfshira - një kapital madhor ekonomik dhe strategjik - jashtë orbitës së një fuqie agresive dhe totalitare. Gatishmëria e deklaruar për të rrezikuar një luftë me ndërlikime bërthamore është më pak e besueshme kur shkak i luftës është thjesht një mosmarrëveshje midis një Rusie autoritare dhe një fqinji të vogël - i cili në rastin e luftës së Gjeorgjisë ishte një mosmarrëveshje mbi statusin politik të dy zonave secesioniste në atë rajon.

Jo vetëm pushteti i përfrikësimit do të sillte mungesën e besueshmërisë në atë situatë, por matura themelore do të diktonte që ky nivel rreziku nuk duhej marrë në konsideratë përveç rasteve të mbrojtjes së interesave vitalë. Mosmarrëveshjet e Gjeorgjisë me Rusinë - dhe për këtë çështje zënkat e shumta që kombet në kufi me Rusinë kanë me Moskën - nuk arrijnë të kalojnë provën madje as me fuqitë më të mëdha të Europës, aq më pak për Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Duket shumë e mundshme që jo ky Uashington nëse do të përballlej me rrjedhojat e tmerrshme potenciale të ballafaqimit me ushtrinë Ruse do t'i bënte bisht përgjegjësive të tilla. Dhe nëse Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk veprojnë, fuqitë dytësore të NATO-s natyrisht që nuk do të mundin. Mos përgjigjja e Aleancës kundrejt sulmit të Rusisë kundër Gjeorgjisë sugjeron që parashikimi i sigurisë së NATO-s për anëtarët e rinj dhe i atyre që do të bëhen pjesë në të ardhmen do të ishte mirë të mendohej.

NATO dhe Rusia: Luajnë me zjarrin

Një problem dytësor që shqetëson NATO-n është se politikat e ndryshme të ndjekura që nga fundi i Luftës së Ftohtë - veçanërisht sipërmarrjet e Aleancës në Ballkan dhe zgjerimi i NATO-s duke përfshirë anëtarë të rinj në kufirin perëndimor të Rusisë - kanë vënë në rrezik marrëdhëniet me Moskën dhe kanë ri - ndezur tensionet e sigurisë në Europë.

Dhunimi i interesave të Rosisë në Ballkan

Në vitin 1995, forcat e NATO-s ndërhyjnë në luftën civile në Bosnje për të ndaluar serbët, një njohje e vjetër e Rosisë dhe aleat i saj fetar dhe politik. Më pas në 1999, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe aleatët e tyre zhvilluan një luftë ajrore kundër Serbisë duke e detyruar të hiqte dorë përfundimisht nga provinca e Kosovës. Duke vepruar në këtë mënyrë ata ndryshuan drejtimin e rrymës së Këshillit të Sigurisë së Kombeve të Bashkuara me shmangien e vetos së Rosisë. Megjithëse drejtuesit politikë të Rosisë u shqetësuan për një trajtim të tillë, ata nuk mund të bënin më shumë sesa të lëshonin ankesa të pafuqishme. Vendi ishte shumë i dobët për të vepruar ndryshe, pasi si ekonomia ashtu edhe ushtria ishin të rrënuara.

Politika Perëndimore në lidhje me ndjeshmërinë e Rosisë dhe interesat e saj të prekshëm në Ballkan nuk ka arritur të bëhet më kompetente me kalimin e viteve. Sërish duke refuzuar objektivat e Moskës, Shtetet e Bashkuara dhe aleatët e saj europianë ndryshuan sërish drejtimin e Këshillit të Sigurisë, duke i siguruar Kosovës pavarësinë në shkurt 2008. Ministri i Jashtëm rus Sergei Lavrov paralajmëroi se një hap i tillë përbën një precedent të rrezikshëm ndërkombëtar që mund të inkurajonte lëvizjet secesioniste në botë. “Amerika dhe NATO, - tha ai, - kanë hapur kutinë e Pandorës”. Në mënyrë kërcënuese ai vuri në dukje se veçanërisht precedenti i Kosovës dukej të aplikohet në rajonet secesioniste të Gjeorgjisë, Ossetias së Jugut dhe Abkhazias.

Gjashtë muaj më vonë, kur qeveria e Gjeorgjisë u përpoq të rifitonte kontrollin e Ossetias së Jugut, forcat ruse e shfrytëzuan këtë lëvizje të pamatur dhe nisën një kundër ofensivë kundër fqinjët të tyre jugor. Kur këto operacione ushtarake përfunduan, Kremli e njohu menjëherë pavarësinë e Ossetias së Jugut dhe Abkhazias. Të paktën pjesërisht veprimet e Rosisë në Gjeorgji u dukën të ishin restoja e veprimeve të Perëndimorëve në Kosovë.

Zgjerimi i NATO-s dhe sigurimet e pandershme

Zgjerimi drejt lindjes i aleancës është shoqëruar me sigurime qetësuese për Moskën, premtime të cilave u ka munguar gjithnjë e më tepër besueshmëria

Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe zyrtarët europianë përëndimorë, jo vetëm nëpërkëmbën interesat e vjetra të Ruisë në Ballkan, por edhe përfituan nga shkatërrimi ekonomik dhe ushtarak i Ruisë gjatë viteve 1990 për të pasur një pozicion dominant në Europën Qendrore dhe Lindore. Mbështetësit e NATO-s jo vetëm ruajtën një institucion ushtarak qëllimi primar i të cilit ishte zhvillimi i betejës së Luftës së Ftohtë kundër Bashkimit Sovjetik në Europë, por edhe zgjeruan aleancën drejt lindjes në sferën tradicionale të influencës së Ruisë. Kjo lëvizje dhunoi qartë premtimet që administrata e Presidentit George H. W. Bush kishte bërë në Moskë në këmbim të pranimit të Kremlinit mbi ribashkimin e Gjermanisë dhe anëtarësimin e kësaj të fundit në NATO.

Zgjerimi drejt lindjes i aleancës është shoqëruar me sigurime qetësuese për Moskën - premtime të cilave u ka munguar gjithnjë e më tepër besueshmëria. Ronald D. Asmus (i cili më vonë do të kishte postin e zëvendësasistentit të Sekretarit të Shtetit në administratën Clinton) dhe ekspertë të tjerë përkrahës të NATO-s argumentuan në 1993: “Se zgjerimi i aleancës drejt lindjes duhej parë si lëvizja përëndimore drejt Ruisë dhe jo kundër saj”. Duke qenë se NATO është tashmë të paktën një strukturë politike po aq sa një organizatë ushtarake, Rusia nuk ka pse t’i frikësohet apo t’i dalë kundër zgjerimit të saj - madje dhe në kufijtë e vetë Ruisë.

Disa përkrahës të zgjerimit madje argumentuan se Rusia do të përfitonte nga zgjerimi i Aleancës me përfshirjen e vendeve të Europës Qendrore dhe Lindore që kishin qenë pjesë e Paktit të Varshavës të Bashkimit Sovjetik. Stephen S. Rosenfeld nga *Washington-ton Post* doli kundër se: “Duke siguruar një pjesë të përçarë të Europës në kufirin e ndjeshëm të Ruisë, zgjerimi i jep zemër dhe hapësirë politike Partisë

Liberalet të drejtimit perëndimor të Ruisë duke dalë mbi Partinë Konservatore dhe Nacionaliste e prirur për të krijuar tension dhe aventura. Zyrtarët perëndimorë ndërkohë i sigurojnë Rusët që një zgjerim i NATO-s madje edhe përfshirja e Ukrainës dhe Gjeorgjisë nuk përbën rrezik për vendin e tyre. Gjatë vizitës në nëntor 2008 në Estoni, Sekretari i Mbrojtjes Robert Gates pohoi se “Rusia nuk duhet të pengojë dëshirën e çdo vendi sovran për t’u integruar plotësisht me Perëndimin”. Ky integrim pohoi ai nuk përbën rrezik “për sigurinë e Ruisë”.

Politika drejt Ruisë ka krijuar çarje të dukshme në Aleancë

Por sërish veprimet e NATO-s (veçanërisht ato të Shteteve të Bashkuara të Amerikës) i mohojnë këto siguri. Në kundërshtim me premtimet që i ka bërë Moskës NATO ka dislokuar herë pas here personel ushtarak dhe armatime luftarake në shtete baltike. Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë theksuar gjithashtu që NATO duhet të jetë e mirë përgatitur për t’i mbrojtur këto vende nga ndonjë sulm i mundshëm i Ruisë. Uashingtoni ka nënshkruar gjithashtu marrëveshje me Poloninë dhe Republikën Çeke për të dislokuar sistemet e mbrojtjes së raketave balistike në këtë vende. Megjithëse këto sisteme synojnë sa për t’u dukur të mbrojnë nga ndonjë sulm i mundshëm i Iranit, Moska e shikon këtë dislokim si një kërcënim të integritetit dhe besueshmërisë së armatimit të saj bërthamor. Gjithsesi sistemi i mbrojtjes misilistike është pa dyshim një masë ushtarake dhe jo thjesht një lëvizje që çdo kush do të priste nga një organizatë thjesht politike.

Raundi i parë i zgjerimeve në 1998 i dha anëtarësinë Polonisë, Hungarisë dhe Republikës Çeke, duke mos i marrë parasysh objektivat e qeverisë së Jeltsinit. Ky zgjerim i aleancës nuk i ishte provokativ, gjithsesi, i krahasuar me raundin e dytë në 2004 që përfshiu (midis shumë vendeve të tjera) Latvian, Estoninë dhe Lituaninë - shtete që kanë qenë pjesë e Bashkimit Sovjetik.

Elita politike Rusia reagoi furishëm kundrejt kësaj sjelljeje, dhe veprimet e NATO-s penguan forcat politike, demokratike,

pro-perëndimore në atë vend ndërsa fuqizonin elementët autoritarë nacionalistë. Pavarësisht sensit të përhapur të inatit dhe tradhtisë, Moska nuk mund të bënte asgjë më tepër sesa të lëshonte ankesa të pafuqishme. Vendi ishte mjaft i dobët si ekonomikisht ashtu edhe ushtarakisht për të kundërvepruar. Por kjo situatë ka ndryshuar dhe Kremlini ka filluar të zmbrahet. Në mënyrë të veçantë Kremlini ka theksuar që përpjekjeve të NATO-s për t'i dhënë anëtarësinë Gjeorgjisë dhe Ukrainës do t'i vihej një kryq i kuq dhe nuk do të toleroheshin.

Politika në drejtim të Rusisë nxjerr në pah plasaritje të reja brenda Aleancës

Politika në drejtim të Rusisë ka krijuar plasaritje të dukshme brenda NATO-s. Në Samitin e NATO-s në Bukuresht në Prill 2008 kundërshtimi i Gjermanisë, Francës dhe i anëtarëve të tjerë të rëndësishëm pengoi mos realizimin e qëllimit të Uashingtonit për t'i ofruar Plan-Veprimin e Anëtarësisë (faza e parë e përgatitjes e një vendi për të marrë anëtarësinë e NATO-s) Gjeorgjisë dhe Ukrainës. Zyrtarët gjermanë dhe francezë argumentuan se shtimi i këtyre vendeve në Aleancë do të provokonte në mënyrë të panevojshme Rusinë dhe do të dëmtonte më tej marrëdhëniet tashmë të tensionuara të Perëndimit me Moskën. Deklarata e Samitit ofroi premtimin e zbrazët që “Dera e NATO-s do të jetë e hapur për Demokracitë Perëndimore që duan dhe janë të afta të përmbushin detyrimet dhe përgjegjësitë e anëtarësisë”.

Ndërsa ajo gjuhë mund të ketë qenë një çmim ngushëllimi për Shtetet e Bashkuara dhe mbështetësit e Europës Lindore të zgjerimit, gjuha rreth kandidimit të Gjeorgjisë dhe Ukrainës sugjeroi një fitore për skeptikët europianë perëndimorë. Deklarata afirmoi që “NATO mirëpret aspiratat euroatlantike të Gjeorgjisë dhe të Ukrainës” për anëtarësim dhe vulos marrëveshjen “që këto vende do të bëhen anëtare të NATO-s”. Në vend që t'i ofronin një Plan-Veprimi për Anëtarësimin (PVA), gjithsesi Samiti u zotua të “adresonte çështjen akoma

të rëndësishme në lidhje me aplikimin e tyre për PVA” dhe u kërkoi ministrave të jashtëm të vlerësonin progresin e këtyre vendeve kundrejt përmbushjes së detyrimeve për anëtarësim. Në mënyrë të dukshme nuk kishte afat për pranimin në aleancë. Në bazë të detajeve operacionale vendimtare, mbizotëruan në Bukuresht kritikët e Europës Perëndimore në lidhje me anëtarësimin e Gjeorgjisë dhe Ukrainës.

Ndarjet brenda Aleancës u bënë akoma dhe më evidente në përgjigje të Luftës Ruse-Gjeorgjiane në gusht 2008.

Anëtarët e NATO-s të Europës Qendrore dhe Lindore u alarmuan me gatishmërinë e Rusisë për të përdorur forcën kundër një fqinji të vogël dhe detyruan partnerët e tyre të aleancës të ndërmerrnin një linjë të fortë kundër Moskës.

Si shprehet një nga ushtarakët zyrtarë të NATO-s për *Times*, Londër, fqinjët më të afërt të Rusisë që ishin tashmë në NATO “janë ata që udhëheqin sulmin e rrezikut Rus sërish në plan të parë”. Për shkak të luftës së Gjeorgjisë, “ka anëtarë të NATO-s si Polonia, Republika Çeke dhe shtetet baltike” të cilët dëshirojnë që aleanca të përqendrohet sërish në “strukturat ushtarake” për ta penguar Rusinë.

Shumica e anëtarëve nga Europa Perëndimore, megjithatë kanë favorizuar një qasje më të kujdesshme, duke i kujtuar kolegëve të tyre se Perëndimit i nevojitet bashkëpunimi me Rusinë për një sërë çështjesh të ndryshme, përfshirë këtu edhe përpjekjet për të penguar ambiciet bërthamore të Iranit. Gjermania, Franca dhe vendet e tjera ishin gjithashtu të ndërgjegjshëm mbi aftësinë e Moskës për të shfrytëzuar varësinë e Europës në furnizimin me gaz natyror që vinte nga Rusia për pushtet diplomatik dhe politik. (Çdo dyshim në lidhje me këtë çështje u zhduk në shkurt 2009, kur zënka e Rusisë me Ukrainën mbi çmimin e gazit natyror sollli mbylljen virtuale të tubave të gazit që drejtoheshin në Europën Qendrore dhe Perëndimore).

Vendet e Europës Perëndimore duken akoma dhe më të pavendosur për të pranuar Gjeorgjinë dhe Ukrainën në NATO në vijim të përleshjeve të armatosura midis Moskës dhe Tbilisit. Ministri i Jashtëm i Polonisë në garë për t’u bërë Sekretari i Përgjithshëm i ardhshëm i NATO-s pohoi se

anëtarësimi për këto dy vende ishte, të paktën një “perspektive mjaft e largët”. Për momentin, tha ai ka thjesht “një mos dëshirë” brenda aleancës për një zgjerim të tillë. Një ushtarak i lartë Amerikan arriti në të njëjtin konkluzion duke deklaruar se “Unë mendoj se është e ndershme për të parashikuar që nuk do të ketë një ofertë të NATO-s për anëtarësim në vitet në vijim. Përgjigjja e Luftës Ruse-Gjeorgjiane tregoi se preferencat e politikës së Uashingtonit ishin më afër pozicionit të linjës së fortë të mbështetur nga anëtarët më të rinj të NATO-s (europianët e Lindjes) sesa kundrejt pikëpamjeve të aleatëve tradicionalë partnerë të Amerikës. Por Qeveritë e Europës Perëndimore, kryesisht ato të Gjermanisë dhe të Francës këmbëngulën dhe refuzuan për të miratuar propozimet në fjalë. (Ky ngurrim për të marrë masa të forta kundërshtuese krijoi gjithashtu një çarje të fortë të politikës Lindje-Perëndim brenda Bashkimit European, dhe një përgjigje të paduruar të SHBA-së kundrejt fitores së dukshme të përkrahësve të ndërmjetësimit me Rusinë).

Në fund përgjigjja e NATO-s kundrejt sulmit të Ruisë në Gjeorgji nuk ishte më tepër sesa protestë e pafuqishme diplomatike dhe një ndërprerje e përkohshme e takimeve midis NATO-s dhe Kremlinit. Drejtuesit Rusë i shpërfillën hapur “fjalët boshe” të NATO-s. Udhëheqësit europianë perëndimorë i ofruan një koncesion të rëndësishëm Shteteve të Bashkuara të Amerikës duke rënë dakord dhe duke miratuar dislokimin e predhave balistike të mbrojtjes në Poloni dhe në Republikën Çeke, duke mos marrë parasysh kundërshtimin e furishëm të Ruisë kundrejt këtij sistemi. Aleatët vepruan në këtë mënyrë edhe pse disa nga Drejtuesit e Europës Perëndimore ishin skeptikë në lidhje me zgjuarsinë e këtij dislokimi.

Dikush që mund të parashikonte më tej, tregoi se do të shtoheshin mosmarrëveshjet midis anëtarëve të aleancës në lidhje me politikën kundrejt Ruisë. Në të vërtetë ka shumë pak unitet në NATO rreth mënyrës se si të sillen me këtë fqinj të rëndësishëm dhe ngandonjëherë sedërmadh të lindjes. Megjithëse kishte disa divergjenca në aleancë gjatë Luftës së Ftohtë, këto divergjenca janë zvogëluar nga mosmarrëveshjet aktuale.

Misioni i pasigurt i NATO-s në Afganistan

Vendet e Europës Perëndimore duken akoma më të pavendosura për të pranuar në NATO Gjeorgjinë dhe Ukrainën në vijim të konflikteve të armatosura midis Moskës dhe Tbilisit

Ndarjet kryesore të politikës midis anëtarëve të aleancës dhe strategjia e dyshimtë e shtimit të anëtarëve të rinj të pambrojtur dhe jo të rëndësishëm në aspektin ushtarak nuk janë treguesi i vetëm që NATO ka humbur mbështetësit e saj dhe është duke u bërë e parëndësishme si një aktor serioz i sigurisë. Një tregues tjetër është misioni i dështuar i aleancës në Afganistan.

Udhëheqësit perëndimorë kanë dëshmuar vazhdimisht se Afganistani është çelësi i suksesit dhe i efektshmërisë së NATO-s në shekullin XXI. Nëse kjo është e vërtetë, aleanca e ka e dështuar këtë test.

Menjëherë pas sulmeve terroriste të 9/11 qeveritë e NATO-s vunë në zbatimin Nenin 5 për të parën herë në historinë e Aleancës. Udhëheqësit amerikanë e mirëpritën zotimin europian për mbështetje dhe fushata ushtarake e SHBA-së në Afganistan së shpejti pati një komponent të rëndësishëm të NATO-s.

Dislokimet simbolike ushtarake

Si rezultat se aleatët e NATO-s kanë mbajtur pozicion dhe janë lëkundur në Afganistan, misioni në atë vend ka dështuar shumë keq.

Por që në fillim filluan të lindnin dyshimet mbi seriozitetin e aleatëve europianë kundrejt angazhimeve të tyre ushtarake. Me të vërtetë shumica e qeverive të NATO-s i panë trupat e tyre të dislokuara si personel për ndihmë humanitare dhe në misionet e ndërtimit të shteteve sesa në operacione luftimi. Ngarkesa e rëndë ushtarake në shumicën e rasteve iu la forcave Amerikane, Kanadeze dhe atyre të Britanisë së Madhe. Në gusht 2003 NATO mori formalisht komandën e Forcës së

Asistencës së Sigurisë Ndërkombëtare (ISAF), e autorizuar me një mandat të përforcimit të paqes nga Këshilli i Sigurisë. Si pohon dhe kërkuesi i Institutit CATO Stanley Kober “ISAF nuk është parë kurrë si një forcë luftarake”. Madje qëllimi i saj ishte rindërtimi i Afganistanit”.

Në fakt, me përjashtimin e vetëm të trupave të Britanisë, Kanadasë dhe Gjermanisë, shumica e kontributeve të trupave të NATO-s nuk është më shumë sesa një simbolikë ushtarake. Qeveritë e NATO-s mund të argumentojnë se ato janë duke kontribuar për misionet ushtarake të drejtuara nga SHBA, por në fakt shumica e dislokimeve nuk janë të rëndësishme në aspektin ushtarak. Është e vërtetë madje që niveli i përgjithshëm i trupave të aleancës në Afganistan është rritur gradualisht.

Shumica e anëtarëve të NATO-s kanë përcaktuar një sërë paralajmërimesh që duhen përdorur nga personeli i tyre ushtarak. Disa i ndalojnë ato të angazhohen në operacionet në mbrëmje (të cilët janë kryesisht më të rrezikshmet). Të tjerat i ndalojnë forcat e tyre për t’u dislokuar në disa zona të veçanta të vendit - veçanërisht në ato zona ku janë duke u kryer luftime të rëndësishme dhe ku trupa të tjera mund të jenë të mjaftueshme. Gjermania është një nga fajtorët kryesorë në këtë drejtim. Berlini i ka mbajtur trupat e tij në zonën veriore të Afganistanit, ku virtualisht nuk po kryhet asnjë luftim. Përveç kërkesave të vazhdueshme të Uashingtonit, qeveria e Gjermanisë ka refuzuar ta heqë këtë kufizim. Raporti i Parlamentit Gjerman në nëntor 2008, vuri në dukje se trupat gjermane në Afganistan harxhojnë pjesën më të madhe të kohës së tyre duke u sorollatur dhe duke pirë birrë, dhe si rezultat shumica ishin tashmë shumë të shëndoshë dhe nuk ishin në kushte të përshtatshme për të luftuar kundër talebanëve ose Al-Qaeda-s.

Si rezultat i pozicionit dhe lëkundjes së aleatëve të NATO-s në Afganistan, misioni ka dështuar shumë keq. Gjatë tre - katër viteve të fundit, talebanët dhe Al-Qaeda janë fuqizuar ndjeshëm dhe i kanë goditur fuqishëm forcat e qeverise Amerikane dhe Afgane. Si administrata e Bush ashtu edhe ajo e Obamës kanë qenë shumë të shqetësuar kundrejt këtyre risive

dhe kanë ushtruar presion tek aleatët europianë për të angazhuar më tepër trupa.

Përgjigjja kryesisht nuk bëri përshtypje. Megjithëse Parlamenti Francez votoi në shtator 2008 të mbante 3500 trupa franceze në Afganistan, Parisi nuk ka plane aktuale për ta shtuar këtë kontingjent. Ministri i Mbrojtjes së Francës, Herve' Morin tha hapur në shkurt 2009 se Franca tashmë e ka “bërë një përpjekje të konsiderueshme” drejt stabilizimit të Afgnaishtanit dhe nuk “arsye për momentin për të dërguar më tepër trupa”.

Holanda, e cila ka qenë një nga kontribuuesit kryesorë, jo vetëm refuzon ta shtojë kontingjentin e saj, por ka deklaruar që do të fillojë t'i zvogëlojë trupat e saj në 1770 në vitin 2010. Gjermania, argumenton se ushtria e saj është thjesht shumë ngushtë për të angazhuar më tepër sesa 4500 trupa të pranishëm tashmë në vend. Kryesisht Berlioni insiston se dislokimi i më tepër trupave të luftimit nuk është i nevojshëm, pasi fokusi primar i misionit të Afganistanit do të jetë në rindërtimin e vendit.

Europianët “i bien qylit”

Mungesa e seriozitetit nga ana e anëtarëve kryesorë të NATO-s në lidhje me Afganistanin ka irrituar madje disa nga zyrtarët europianë. Në një fjalim në janar 2009 Sekretari i Mbrojtjes së Britanisë së Madhe John Hutton, akuzoi qeveritë europiane për dështimin në ndarjen e ndershme të përgjegjësive të përbashkëta.

“Rehatia në kurriz të sigurisë amerikane nuk është një mundësi nëse ne duam të jemi partnerë të barabartë të Aleancës Transatlantike” paralajmëroi ai. “Kushdo që do të përfitojë nga siguria kolektive duhet të jetë i përgatitur të ndajë edhe çmimin e fundit”. Hutton pati gjithashtu një qortim për Gjermaninë dhe aleatët e tjerë që duken të besojnë se operacionet humanitare dhe ato të ndërtimit të vendit mund të jenë një zëvendësues i denjë për përgjegjësitë ushtarake. “Nuk është mirë që gjithmonë t'i shikojmë Shtetet e Bashkuara të Amerikës si një mburojë politike, financiare dhe ushtarake.

Ky mos balancim nuk do të eliminohet duke i ndarë përgjegjësitë e NATO-s - të “vështirat” ushtarake për SHBA dhe pak të tjerë, ndërsa “diplomacinë e lehtë” për europianët.

Kjo zvarritje e acaroi Sekretarin e Përgjithshëm të NATO-s Jaap de Hop Scheffer. “Të them të drejtën unë jam i shqetësuar kur dëgjoj se SHBA po planifikon një angazhim të madh në Afganistan, në një kohë, kur aleatët e tjerë po heqin dorë për të bërë më tepër. Një nga arsyet e shqetësimit të tij lidhej me pohimin se: “Kjo nuk është aspak pozitive për balancën politike të misionit. Kjo nuk është aspak e drejtë për balancën brenda aleancës së Atlantikut të Veriut” Ai paralajmëroi që dështimi i anëtarëve kryesorë europianë për të bërë më tepër në Afganistan “bën që zëri i Europës të humbasë në Uashington”. Me fjalë të tjera, Sekretari i Përgjithshëm ka frikë se mos udhëheqësit amerikanë mbase nuk mund t’i marrin partnerët e tyre europianë, ose mbase edhe vetë aleancën, seriozisht në të ardhmen.

Por ngurrimi i anëtarëve të tjerë të NATO-s për të devijuar angazhimet e tyre ushtarake në Afganistan është mjaft i habitshëm, sepse publiku europian duket tërësisht kundër dërgimit të më tepër trupave. Një vëzhgim publik opinionist i kryer në Janar 2009 nga *Financial Times* gjeti kundërshtime të forta mbi angazhimet e trupave. 60 për qind e gjermanëve ishin kundër, sikundër dhe 53 për qind e francezëve dhe italianëve. Madje dhe në Britaninë e Madhe, aleati më i ngushtë i Uashingtonit dhe vendi me praninë e dytë më të madhe ushtarake në Afganistan, 57 për qind e të intervistuarve ishin kundër dërgimit të trupave të tjerë. Këto sjellje janë në kontrast me opinionin publik në SHBA, ku ka një mbështetje të fuqishme kundrejt fushatës kundër talebanëve dhe Al-Qaeda-s. Politika në lidhje me Afganistanin dhe “lufta kundër terrorit” e Uashingtonit, është një shembull tjetër i çarjeve të mëdha që po zhvillohen brenda aleancës.

Aftësitë gjërryese ushtarake të aleatëve kryesorë europianë

Hapësira midis aftësisë ushtarake të Amerikës dhe aftësisë së partnerëve europianë është thelluar shumë.

Performanca e pa aftë ushtarake e NATO-s në Afganistan vë në dukje një problem më të madh. Jo vetëm shumica e anëtarëve të rinj të aleancës janë aktorë margjinale, por edhe aleatët kryesorë tradicionalë europianë kanë lejuar rrënimin e institucioneve të tyre ushtarake. Hapësira midis aftësisë ushtarake të Amerikës dhe aftësisë së partnerëve europianë është thelluar shumë. Drejtuesit ushtarakë amerikanë paralajmërojnë se operacione të përbashkëta me anëtarë të tjerë të NATO-s janë gjithnjë e më të vështira dhe mund të bëhen së shpejti të pamundura. Me fjalë të tjera forcat e armatosura të anëtarëve të tjerë të aleancës po bëhen më të vjetra dhe më pak të efektshme.

Shpenzimet dhe niveli i forcave ushtarake po reduktohen

Kjo nuk është e habitshme. Me pritjet e pjeshme të Britanisë së Madhe dhe Francës, buxheti ushtarak - duke përjashtuar shpenzimet kryesore për modernizimin - i fuqive kryesore Europiane Perëndimore ka rënë ndjeshëm që me fundin e Luftës së Ftohtë. Shpenzimet dhe niveli i forcave të këtyre tre anëtarëve kryesorë të NATO-s - Gjermania, Italia dhe Spanja - ilustron problemin në fjalë. Spanja i ka kushtuar 1.85 të GDP-së së saj mbrojtjes dhe ka dislokuar me tepër se 274,000 trupa dhe 244 avionë ushtarakë. Në 2008 këto shifra u ulën në 0.73 të GDP, 150,000 trupa dhe 197 avionë ushtarakë. Shuma në shpenzimet dhe aftësitë ushtarake për Italinë ka qenë njësoj dramatike. Në 1998, përqindja e GDP-së e harxhuar në ushtri ishte 1.94 dhe vendi kishte afërsisht 390,000 trupa dhe 425 avionë luftarakë. Në vitin 2008 shifrat ishin 0.96 për qind, 185,000 trupa dhe 266 avionë luftarakë.

Tatëpjeta e shpejtë e Berlinit në shpenzime ushtarake dhe nivelin e forcave të armatosura është ndoshta me dekurajuesja. Gjatë Luftës së Ftohtë, Gjermania Perëndimore ishte shteti i parë dhe partneri kryesor ushtarak në ruajtjen nga Bashkimit Sovjetik. Shpenzimet ushtarake të Berlinit në 1989 ishin 2.27 për qind e GDP-së dhe Bundeswehr kishte 469,000 trupa aktivë në detyrë dhe 621 avionë luftarakë. Në 2008 shpenzimet u ulën në 1,19 për qind të GDP-së dhe numri i forcave aktive u ul në 245,000 ndërsa avionët luftarakë në 310. Marina vanitoze Gjermane u zvogëlua gjithashtu me afërsisht 50% nga 280 anije në 111.

Reduktimet në numër në Britani dhe Francë janë gjithashtu shqetësuese, megjithëse nivelet e shpenzimeve ishin më të lartat në fillim dhe mbesin në nivele marginale më të respektueshme sesa ato të të tre vendeve të tjera. Edhe Parisi, i cili i kishte kushtuar 2.98 % të GDP-së shpenzimeve ushtarake në 1989 kishte 461,000 trupa tokësorë dhe 697 avionë luftarakë, po shpenzon tashmë 1.54 % të GDP-së dhe niveli i trupave dhe i avionëve ka rënë respektivisht në 249,000 dhe 351. Për Britaninë e Madhe shifrat në 1989 ishin 3.98 për qind e GDP-së, 306,000 trupa dhe 583 avionë luftarakë. Në 2008 shifrat ranë në 2,33 % të GDP-së, më pak se 161,000 trupa dhe vetëm 356 avionë ushtarakë. Madje dhe marina e famshme britanike u zvogëlua nga 206 në 109 anije.

Vetëm katër anëtarët europianë kanë arritur të paktën qëllimin që anëtarët e aleancës përcaktuan disa vite më parë që të gjitha vendet e NATO-s të shpenzonin të paktën 2% të GDP-së së tyre për mbrojtjen. Në kontrast, shpenzimet ushtarake amerikane (duke përfshirë shpenzimet për misionet në Irak dhe në Afganistan) është afërsisht 5 për qind e GDP-së. Meqenëse ekonomia amerikane është më e madhe se ajo e çdo vendi europian, pesë për qind e GDP-së do të thotë se Uashingtoni shpenzon shumë më pak se sa aleatët e tij. Por numrat reale nuk të bindin plotësisht mbi thelbin e problemit. Jo vetëm që vendet europiane janë duke shpenzuar më pak dhe janë duke reduktuar numrin e armëve kryesore si anije dhe avionë, por përpjekjet e tyre për të modernizuar forcat e tyre kanë qenë shumë modeste. Kështu në shumicën e rasteve,

sistemet kryesore të armatimeve po vjetrohen dhe zvogëlohen në sasi. Komponenti ushtarak europian i NATO-s rrezikon kështu të bëhet një forcë e vjetruar si edhe shumë e vogël.

Shkurtimisht, anëtarët kryesorë europianë të NATO-s janë shndërruar nga vende që investuan pak për mbrojtjen gjatë Luftës së Ftohtë në vende shpenzimet ushtarake të cilave dështojnë të përmbushin edhe detyrimet e një testi serioz. Nuk ka çudi që udhëheqësit Amerikanë të mos i konsiderojnë me shumicën e aleatëve si partnerë të besueshëm në operacionet luftarake të përbashkëta. Në fjalimin e tij në Janar, John Hutton pohoi se mungesa e efektivitetit të NATO-s në Afganistan është të paktën pjesërisht rezultat i “mos investimeve të disa prej shteteve anëtare europiane në forcat e tyre të armatosura”.

Politikë bërësit amerikanë janë të shqetësuar rreth degradimit të aftësisë ushtarake europiane. Si në Luftën e Gjirit Persik në 1991, kur shumica e vendeve europiane e kishte të vështirë të grumbullonte avionë të mjaftueshëm për të transportuar forcat e e tyre në rajon. Problemi u bë edhe më evident gjatë luftës 78-ditëshe kundër Serbisë gjatë krizës së Kosovës in 1999. Hendeku i kapaciteteve ishte aq i madh sa Shtetet e Bashkuara, jo vetëm që fluturuan në pjesën më të madhe të operacioneve të luftimit, por gjithashtu vëzhguan dhe rifurnizuan misionet. Uashingtoni duhet të siguronte pothuajse të gjithë funksionet e inteligjencës dhe ngarkesën logjistike për operacionin. Duke vënë re këtë situatë të pakënaqshme në një mbledhje të Ministrave të Mbrojtjes së NATO-s në vitin në vijim, Sekretari i Mbrojtjes William Cohen i detyroi aleatët europianë të lëviznin shpejt për të eliminuar hendekun si në shpenzime ashtu edhe në aftësitë ushtarake.

Por në vend që të mbyllej hendeku u zgjerua dhe më shumë në dy vitet që pasuan. Sekretari Shtetit Colin Powell paralajmëroi anëtarët e tij të NATO-s në Maj 2002 mbi krijimin e një aleance me “dy-shpejtësi” në të cilën Shtetet e Bashkuara të Amerikës kujdesen për eliminimin e krizave imediate me përdorimin e papërmbajtur të fuqisë më të lartë tekno-ushtarake dhe anëtarët e tjerë janë shndërruar thjesht në spektatorë. Një muaj më parë Ambasadori Amerikan në

NATO theksoi një temë të ngjashme. Burns paralajmëroi se “Pa veprimin dramatik për të mbyllur hendekun e aftësive, ne përballemi me perspektivën e vërtetë të një aleance shumë të lodhur”. Aleanca “mund të bëhet” në këtë mënyrë qaç e pabilancuar saqë ne nuk do të mundim më të luftojmë së bashku në të ardhmen”.

Gjërat janë përkeqësuar më shumë që nga e folura e Powell dhe Burns më 2002. Edhe atëherë shenjta e sigurimit falas për europianët ishin të qarta. Nëntë prej vendeve europiane anëtare të aleancës ishin duke shpenzuar më pak se 2 për qind të GDP-së për mbrojtjen, me dobësimin e Gjermanisë në 1.4 për qind që përbënte kryesisht një shqetësim. Si dhe shkurtime të forcat e armatosura dhe reduktimi i sistemeve të armatimit po procedonin me ritme shumë të shpejta. Nivelet në 2002, megjithatë mund të konsiderohen më të forta nëse krahasohen me situatën sot.

Ndarja iluzioniste e përgjegjësisë

Disa amerikanë ekspertë të politikës këmbëngulin se vetëm duke shpenzuar më tepër sesa shumata e mëdha që ka shpenzuar deri tani Uashingtoni në gatishmërinë ushtarake do të kenë influencë të mjaftueshme për t’i detyruar vendet europiane t’i shtojnë përpjekjet e tyre të vogla. Robert Kagan, i asociuar pranë Carnegie Endowment për Paqe Ndërkombëtare, deklaroi mundësinë që administrata e Obamës mund të zvogëlojë vërshimin e shpenzimeve ushtarake të Ushtrisë Amerikane që u vunë në zbatim që nga 11 Shtatori. Kjo lëvizje, pohon ai “do të vështirësonte presionin tek aleatët për të bërë më tepër”. Administrata e Obamës me të drejtë planifikon të inkurajojë aleatët europianë t’i shtojnë mundësitë e tyre ushtarake me qëllim që t’i ndajnë në mënyrë më të barabartë shpenzimet globale. Kjo do të jetë e vështirë për t’u pranuar meqenëse Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë duke reduktuar buxhetin e tyre për mbrojtjen.”

Uashingtoni i ka inkurajuar aleatët europianë të angazhohen më shumë në ndarjen e përgjegjësive që nga krijimi i NATO-s më 1949, por pa shumë sukses.

Nocioni që anëtarët europianë të NATO-s janë të interesuar për të ngritur buxhetet e të tyre ushtarake - kryesisht për t'i ndihmuar Shtetet e Bashkuara të Amerikës të merren me përgjegjësitë globale, shumica e të cilave do të jetë jashtë Europës - është naive. Për më tepër argumenti i Kagan është rasti klasik i triumfit të shpresës mbi eksperiencën. Uashingtoni i ka inkurajuar (me të vërtetë shpesh herë duke iu ngacmuar ose madje duke iu lutur) aleatët europianë të angazhohen më shumë në ndarjen e përgjegjësive që nga krijimi i NATO-s në 1949, por pa shumë sukses. Kjo ishte e vërtetë madje edhe gjatë Luftës së Ftohtë kur Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Europa u përballën me një kundërshtar të përbashkët, Bashkimin Sovjetik. Alan Tonelson, një studiues pranë Biznesit Amerikan dhe Fondacionit të Këshillit Industrial të Edukimit si dhe një analist prej një kohe të gjatë për çështjet e NATO-s paraqet një përmbledhje të dëshpëruar të zhgënjimeve të Uashingtonit:

Përpyekjet e Amerikës për ndarjen e përgjegjësive të Luftës së Ftohtë dështuan për shumë arsye. Por shpjegimet kryesore janë se udhëheqësit amerikanë nuk u dhanë kurrë europianëve stimulues të mjaftueshëm për të marrë përgjegjësi më të mëdha ushtarake. Uashingtoni nuk e besoi kurrë që mund ta përballonte të largohej nga NATO, ose madje të zvogëlonte rolin e tij nëse aleatët do të kishin qëndruar të vendosur. Më keq akoma, udhëheqësit amerikanë e telegrafuan në mënyrë të përsëritur këtë mesazh tek europianët - ngandonjëherë në mes të polemikës për ndarjen e përgjegjësive.

Ky fakt historik sugjeron që teza e Kagan i rikthen në mendje rolin e stimuluesve. Plani i veprimeve më i mundshëm është se nëse Shtetet e Bashkuara të Amerikës vazhdojnë të shpenzojnë më shumë për ushtrinë dhe të ndihmojnë hapur në sigurinë e aleatëve të tyre europianë, ata do të jenë mjaft të kënaqur ta vazhdojnë këtë marrëveshje. Në fakt kjo është, ajo që ata kanë bërë për pothuajse gjashtë dekada. Gjendja aktuale ekonomike ndoshta mund ta rrisë tendencën e lëvizjes së lirë.

Duke pasur parasysh qëllimin e europianëve për sigurinë e brendshme, politikat e brendshme zgjedhore mund të ushtrojnë presion mbi qeveritë e tyre t'i devijojnë më tepër të ardhurat e tyre për programet e mirëqenies. Ndoshta do të ketë pak zgjedhje të bujshme për të nxitur shpenzimet ushtarake - veçanërisht kur Shtetet e Bashkuara të Amerikës detyrimisht duhet të kujdesen për nevojat e sigurisë me paratë e taksa paguesve amerikanë.

Nëse Uashingtoni dëshiron të maksimizojë shpresën që anëtarët e NATO-s do të shtojnë shpenzimet e tyre ushtarake, zyrtarët amerikanë kanë nevojë të adaptojnë kursin e kundërt të veprimit: të ulin në mënyrë të ndjeshme shpenzimet dhe të implementojnë një fazë të largimit të trupave amerikanë nga Europa. Kjo alarmon strukturat stimuluese. Kryesisht me Rusinë që po çmpin muskujt, kujdesi do të diktonte se fuqitë europiane i marrin çështjet e sigurisë shumë seriozisht dhe krijojnë të paktën kapacitete të respektueshëm ushtarakë si bazë për sigurinë. Nëse do të vepronin ndryshe do të thotë të rrezikoje të ishte vulnerabil për të shkallëzuar presion nga Moska mbi një sërë çështjesh.

Roli më i madh se zakonisht i Uashingtonit në qarqet e shkurtra të NATO-s është një stimulues kryesor për fuqitë europiane për të bërë më shumë për mbrojtjen e tyre.

Kagan pohoi hapur se pranonte rolin e stimuluesve në 2003, duke vënë në dukje se europianët “mund të shpenzojnë lehtësisht dy herë më shumë sesa po shpenzojnë aktualisht për mbrojtjen nëse ata besojnë se është e rëndësishme për të vepruar kështu”. Ai i shikonte me skepticizëm argumentat e europianëve mbi ekzistencën e disa “realiteteve strukturore” në buxhetet e tyre kombëtare, “duke shtuar limite për të rritur shpenzimet ushtarake”. Nëse Europa do të pushtohet, pyet Kagan, “a do të insistonin politikanët që buxhetet e mbrojtjes nuk duhej të shtoheshin, sepse kjo do të dhunonte termat e rritjes europiane dhe të Paktit të Stabilitetit? Nëse Gjermania do të ndjehej me të vërtetë e kërcënuar, a do të insistonin ata që programet e tyre të mirëqenies sociale të mbeteshin të paprekur?”

Por perceptimi i kërcënimit është vetëm një komponent i kuadrit të stimuluesve. Njësoj e rëndësishme është kur vendet në fjalë të mbështeten te një mbrojtës i jashtëm, ose nëse

mbështeten në burimet e tyre ushtarake për mbrojtjen. Është kjo përlllogaritje që politika aktuale amerikane e mbrojtjes, për të mos thënë asgjë mbi politikën zbutëse që Kagan dhe mbështetës të tjerë të hegjemonisë amerikane përkrahin, shtrembëron në mënyrë të veçantë gërryese. Roli më i madh se zakonisht i Uashingtonit në qarqet e shkurtra të NATO-s është një stimulues kryesor për fuqitë europiane për të bërë më shumë për mbrojtjen e tyre.

NATO në matufepsjen e saj

Të gjitha këto zhvillime - shtimi i ndarjeve të politikës (kryesisht në lidhje me Rusinë), shtimi i anëtarëve të rinj, të vegjël, të dobët, performanca e papërshtatshme e aleancës në Afganistan dhe erozioni i kapaciteteve ushtarake të partnerëve europianë, tradicionalë të Uashingtonit - konfirmon që NATO po bëhet një parodi e asaj çka qenë më parë. Është ndjeshëm pak më tepër se një vëllazëri politike sesa një aleancë e besueshme sigurie. Kjo është e trishtueshme, sepse aleanca ka qenë dikur një shoqëri e aftë dhe serioze ushtarake me një qëllim të rëndësishëm.

Ky nuk është më rasti dhe ka shumë pak mundësi që procesi i rrënimit të përmbysset. Sot NATO është një guaskë e zbrazët. Paraqitja e jashtme është ajo e një organizate impresionuese - me oficerë madhorë të kapardisur, me një sërë organizatash, dokumentesh dhe studimesh për një rrjet të pafund studiuesish dhe ekspertësh të cilët përfitojnë nga përjetësimi i burokracisë së nderuar. Por sipas thënies së famshme të Gertrudë Stein nga Oakland “nuk ka një atje, atje”. NATO nuk është më një organizatë efektive ose, në shumicën e rasteve, madje as një aleancë e besueshme sigurie. Natyrisht NATO në formën e saj aktuale nuk e favorizon sigurinë dhe mirëqenien e republikës amerikane. Ka ardhur koha për t’i dhënë fund kësaj aleance gjithnjë e më shumë mosfunksionuese - ose të paktën të shpëtojme Shtetet e Bashkuara të Amerikës prej saj.

Ted Galen Carpenter është zëvendëspresident për studime mbi politikat e mbrojtjes dhe politikave të jashtme tek Instituti Cato, SHBA

JENS RINGSMOSE DHE STEN RYNNING

KTHIM NË SHTËPI, NATO? KONCEPTI I RI STRATEGJIK I ALEANCËS SË VERIUT

Në këtë raport, ne sigurojmë një panoramë të çështjeve politike dhe ushtarake që do t'i japin formë diskutimit të ardhshëm mbi Konceptin e Ri Strategjik të NATO-s. Koncepti aktual Strategjik i NATO-s i përket vitit 1999 dhe gjatë viteve të fundit një numër në rritje politikëbërësish kanë sugjeruar që është koha për të vendosur nën kontroll Aleancën transatlantike. Veprimi është domethënës pasi Koncepti Strategjik përfaqëson pikëpamjen e gatshme të Traktatit të Uashingtonit - teksti thelbësor i NATO-s - dhe sepse do t'i japë një drejtim të ri Aleancës.

Në raport ne paraqesim tri argumente. Një është që Koncepti Strategjik ka funksione të ndryshme: kodifikon vendime të së kaluarës dhe praktikat ekzistuese; siguron drejtim strategjik; dhe shërben si një instrument i diplomacisë publike. Argumenti ynë i dytë është që Koncepti i ri Strategjik duhet të balancojë divergjencat e dy vizioneve konkurruese, njëra është "Kthim në shtëpi NATO"; tjetra është "Të Globalizosh, budallallëk". Gara midis këtyre vizioneve divergjente ka pasojë për një numër çështjesh që Koncepti Strategjik duhet t'i adresohet. Si përfundim, ne argumentojmë që edhe pse axhenda e globalizimit është vënë në dyshim, NATO do vazhdojë në rrugën e përfshirjes globale.

Hyrje

NATO është gati të fillojë një shqyrtim të Konceptit të tij Strategjik në samitin e prillit 2009 në Strasburg-Kehl që do shënojë përvjetorin e gjashtëdhjetë të Aleancës. Një Koncept

Strategjik i ri do të jetë gati për vitin 2010 ose 2011, në varësi të nivelit të ambicies politike dhe shpejtësisë së negociatave. Koncepti Strategjik aktual do të mbushë 10 vjet deri në kohën e samitit të 2009-s, që atëherë Aleanca ka ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme, politikisht dhe ushtarakisht. Ndjenja e përhapur kudo në NATO, është që ka ardhur koha për të marrë nën kontroll Aleancën e Atlantikut. Veprimi është domethënës pasi Koncepti Strategjik përfaqëson pikëpamjen e gatshme të Traktatit të Uashingtonit - teksti thelbësor i NATO-s - dhe sepse do t'i japë një drejtim të ri Aleancës.

Në këtë raport, ne sigurojmë një panoramë të çështjeve politike dhe ushtarake që do t'u japin formë Konceptit të ri Strategjik. Ne japim tre argumente. Një është që Koncepti Strategjik është më pak "strategjik" se sa përcakton emri. Koncepti Strategjik kodifikon vendimet e së kaluarës dhe ia paraqet ato publikut si një tërësi koherente: me të vërtetë, kodifikimi dhe diplomacia publike janë funksionet e tij thelbësore. Gjithsesi, edhe drejtimi strategjik mbetet një funksion, dhe është e mundur që ky po përjeton një ringjallje në ditët e sotme. Ne e paraqesim këtë argument në kontekstin e tij historik në seksionin e parë të këtij raporti. Një argument tjetër është që një Koncept Strategjik i ri duhet të balancojë divergjencat e dy vizioneve konkurruese, njëra është "Kthehu në shtëpi, NATO"; tjetra është "Të Globalizosh, budallallik". Ne mund të vëzhgojmë këto vizione konkurruese dhe implikimet politike në një numër çështjesh që Koncepti Strategjik në mënyrë të pashmangshme duhet të adresojë, dhe ne prezantojmë pikëpamjen tonë në seksionin e dytë të raportit. Gjithsesi, duhet të jetë theksuar disa herë që do të ishte një gabim për të bërë dallime të qarta midis shteteve anëtare që po promovojnë vizionin global dhe ato që po e influencojnë NATO-n të kthehet në shtëpi: shumë anëtarë duhet të bëjnë akoma prononcimet finale mbi këtë çështje. Një argument i fundit i tretë ka të bëjë me të ardhmen: ne nuk mund të parashikojmë ngjarjet, por mund të ofrojmë gjykimin tonë të informuar, i cili është që NATO do të vazhdojë gjatë rrugës së përfshirje globale.

1. Cili është koncepti strategjik i NATO-s?

Koncepti Strategjik është pikëpamja operationale dhe dinamike e traktatit të tij të themelimit. Traktati i Uashingtonit (i nënshkruar më 4 prill 1949) është një dokument i përgjithshëm që përcakton vlerat thelbësore (demokraci, liri individuale, shteti i së drejtës, institucionet e lira) të cilat Aleanca do t'i "ruajë" sipas mënyrës konsistente me kartën e Kombeve të Bashkuara. Traktati nuk përcakton në asnjë mënyrë një kërcënim ose ndonjë zonë të veçantë me rëndësi gjeografike. Ndryshe nga kjo, Neni 4 adapton një perspektivë globale kur shpreh që "Shtetet do të konsultohen së bashku atëhere kur, me opinionin e gjithësecilit, integriteti territorial, pavarësia politike ose siguria e secilit prej antarëve është nën kërcënim". Kjo pikëpamje globale balancohet nga Neni 6, i cili përcakton zonën gjeografike - kryesisht territore dhe forca në "detin e Mesdheut ose zona e Atlantikut të Veriut në veri të Tropikut të Gaforres" - që është zbuluar nga klauzola e mbrojtjes kolektive në Nenin 5.

Aty ku traktati i Uashingtonit e lë të hapur balancën midis detyrave globale dhe rajonale, Koncepti Strategjik mundet të interpretojë specifikisht rrethanat konkrete gjeopolitike. Cilat janë kërcënimet, dhe cilat janë komplikacionet e tyre ushtarake? Këto janë dy pyetje kyçe dhe thelbësore që Koncepti Strategjik duhet t'u japë përgjigje.

Që nga krijimi i Aleancës së Atlantikut më 1949, organizata e sigurisë transatlantike ka prodhuar gjashtë Koncepte Strategjike bona fide.¹ Procedurat e vendimmarrjes që do çojnë në miratimin përfundimtar të këtyre dokumenteve kanë ndryshuar. Në disa raste, procesi është tejzgjatur dhe komplikuar, si ngjarjet që çuan në implementimin e Konceptit të vitit 1957, MC 14/2, ndërsa në shembuj të tjerë - si në vitin 1952, kur MC 3/5 u aprovua - procesi ka qenë i shpejtë dhe i thjeshtë. Për më tepër, ndërsa të gjithë Konceptet Strategjike

¹ Gjashtë Konceptet Strategjike janë DC 6/1 (1949), MC 14/2 (1957), MC 14/3 (1968), Koncepti Strategjik i ri (1991), dhe Koncepti Strategjik i Aleancës 1999.

janë aprovuar nga Këshilli i Atlantikut të Veriut, nuk ekziston një model i pranuar ose autoritativ i cili përcakton se cili mban iniciativën dhe se cilët aktorë dhe trupa duhet të përfshihen në proces. Disa herë - si në vitin 1968 - ndryshimi në strategjinë e përgjithshme të NATO-s ka qenë produkt i presionit amerikan; në raste të tjera nuk ka qenë e lehtë për të përcaktuar shtetin anëtar ose trupin që ndërmerrete iniciativën.² Me pak fjalë, nuk ekziston një metodë e vetme e NATO-s për të prodhuar një Koncept Strategjik.

Koncepti i parë Strategjik i NATO-s “Koncepti Strategjik për Mbrojtjen e Zonës së Atlantikut të Veriut” daton në tetor 1949. Koncepti Strategjik synonte të siguronte “bashkim mendimesh dhe qëllimesh deri në atë pikë ku objektivat e mbrojtjes së zonës së Traktatit të Atlantikut të Veriut janë përcaktuar”.³

Ndërsa ky “bashkim mendimesh dhe qëllimesh” mbetet ambicia vazhduese nga 1949 deri në 2009 dhe më tej, duhet të bëjmë dallimin midis Konceptit Strategjik të Luftës së Ftohtë dhe kohërave pas Luftës së Ftohtë. Konceptet Strategjike të Luftës së Ftohtë ishin të qarta në gati të gjitha mënyrat, gjë që Konceptet Strategjike të pasLuftës së Ftohtë nuk janë. Konceptet Strategjike të Luftës së Ftohtë i adresoheshin kundërshtarit të përcaktuar, Bashkimit Sovietik, dhe kishin udhërrëfyes për përgatitjen e mbrojtjes ushtarake në zona gjeografike të dhëna. Autoritetet ushtarake të NATO-s - struktura e komandës - gjente këto krahina, dhe kështu makineria shkonte në punë. Midis Koncepteve Strategjike që përcaktuan debatet e mëdha të Luftës së Ftohtë janë MC 14/2 e majit 1957 (strategjia e hakmarrjes masive) dhe MC 14/3 e janarit 1968 (strategjia e përgjigjes fleksibël, e cila zgjati deri

² Gregory W. Pedlow (ed.), Dokumentet Strategjike të NATO-s 1949-1969, <http://www.nato.int/docu/stratdoc/eng/intro.pdf>

³ MC3, tetor 19, 1949, <http://www.nato.int/docu/stratdoc/eng/a491019a.pdf> i aksesuar më 30 nëntor 2008. Dokumenti mori aprovim ministerial në Komitetin e Mbrojtjes në NATO dhe në Këshillin e Atlantikut të Veriut më 6 janar 1950. Gregory W. Pedlow (ed.), Dokumentet Strategjike të NATO-s 1949-1969, <http://www.nato.int/docu/stratdoc/eng/intro.pdf>

në fund të Luftës së Ftohtë). Këto dokumente të Luftës së Ftohtë ishin sigurisht, të gjitha sekrete, gjë që i lejoi ato të ishin mjaft specifike.⁴ Strategjia MC 14/1 e dhjetorit 1952 është ilustrative: në të gjejmë jo vetëm një numërim të vendeve që i përkasin bllokut sovjetik dhe NATO-s respektivisht, por gjithashtu edhe vendet që supozohet që sigurojnë të drejtat bazë të të dyja anëve, ashtu si partnerëve që janë gati të asistojnë NATO-n; reagimet e vendeve neutrale shqyrtohen gjithashtu.

Koncepti Strategjik i parë i NATO-s i vitit 1949 ka shërbyer gjithmonë, më shumë se një qëllimi. Sot, mund të thuhet se dokumenti ka të paktën tre funksione kryesore: dy të brendshme dhe një të jashtme. Një nga funksionet e tij të brendshme është të kodifikojë vendimet dhe praktikatat e së kaluarës, pra të fortifikojë themelet e Aleancës. Kodifikimi është i ngjashëm me fshirje, ndërsa një zyrtar i lartë i NATO-s e propozon: një Koncept të ri Strategjik që përmbledh dhe formalizon serinë e komunikatave ministeriale dhe vendimeve të vogla që janë shfaqur që nga Koncepti Strategjik i fundit.⁵ Çdo komunikatë ministeriale është në fakt një Koncept Strategjik në miniaturë, ai zyrtari, dhe nga koha në kohë ngjarjet e botës reale do e kishin çuar NATO-n drejt shtigjeve të reja aq sa është e nevojshme të mblidhen të gjitha miniaturat dhe t'i kombinosh ato në një dokument të zgjatur. Ky ushtrim ka si qëllim t'i sigurojë koherencë një grup vendimesh dhe takimesh pune që mund të mos jenë gjithmonë koherente më shikim të parë. Kjo na çon te një tjetër funksion i brendshëm, ai i sigurimit të drejtimit të ri strategjik - në shtrimin e themeleve për koherencë të ardhshme.

Drejtimi strategjik ishte një qëllim kryesor i koncepteve të Luftës së Ftohtë, sigurisht, dhe mbetet thelbësor, edhe pse në një kontekst të ri të diplomacisë publike (shih më poshtë) dhe kodifikimit. Është në fakt e vështirë për të ndarë këto funksione. Drejtimi strategjik ka të bëjë me vlerat thelbësore

⁴ Ishte vetëm në vitin 1995 që Këshilli i Atlantikut të Veriut vendosi të deklasifikojë dokumentet strategjike të NATO-s si një paketë që është tani i disponueshëm: <http://www.nato.int/archives/strategy.htm>, aksesuar më 30 nëntor 2008.

⁵ Intervistë në Shtabin e Përgjithshëm të NATO-s, 31 tetor 2008.

dhe më fundamentale të Traktatit të Uashingtonit dhe mbrojtjes së tyre në një kontekst global dhe rajonal, që është gjithashtu aty ku ky seksion fillon. Aleatët duhet që të sigurojnë drejtim strategjik duke përcaktuar balancën midis përfshirjes globale dhe rajonale, llojin e kërcënimeve që Aleanca mund të gjejë, dhe çfarë mund të bëjë për ato. Duke siguruar përgjigje për këto pyetje, dhe pra duke siguruar drejtim strategjik, Aleanca në mënyrë të paevitueshme kryen diplomaci publike. Për më tepër, për të lëvizur botën, Aleanca nevojit një vend për të qëndruar, dhe kështu drejtimi strategjik fillon atje ku kodifikimi përfundon.

Ashtu siç është përmendur më sipër, Koncepti Strategjik ka marrë një funksion të ri dhe të jashtëorientuar që nga përfundimi i Luftës së Ftohtë - atë të diplomacisë publike. Me sa duket, Konceptet e NATO-s të post-Luftës së Ftohtë kanë qenë më të dykuptimshme se sa paraardhësit e tyre, dhe sigurisht pjesë e arsyes së saj ka të bëjë me mjedisin e ri të sigurisë, i cili është shënuar nga rreziqe të vështira për t'u parashikuar: është thjesht e pamundur të planifikosh për një kërcënim të vetëm në një teatër të vetëm. Një arsye tjetër, megjithatë, është vendimmarrja për të publikuar këto koncepte si një element në përpjekjet e NATO-s për të komunikuar historinë e një Aleance të fokusuar dhe të nevojshme për të rritur audiencën kombëtare, p.sh. NATO duke shitur produktin e saj. Konceptet Strategjike të post-Luftës së Ftohtë duhet të informojnë botën që kundërshtari i NATO-s i Luftës së Ftohtë ka ikur, dhe duhet të mobilizojnë mbështetje në shtëpi dhe të përgatisin Aleancën për përfshirje që nuk mund të parashikohen, por që me siguri do të kërkojnë impenjim. Së shpejti, Koncepti Strategjik duhet të tregojë qëllimin e tij.

Ndërlidhja midis këtyre funksioneve shpjegon se përse kombet e NATO-s nuk ia kanë deleguar detyrën e përgatitjes së Koncepteve Strategjike divizionit të saj të diplomacisë publike ose Sekretarit të Përgjithshëm. Kontrolli qeveritar mbizotëron strikt. Kjo nuk është BE-ja ku Përfaqësuesi i Lartë i Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë, Javier Solana, drafton strategjinë e sigurisë dhe mban takime publike për të diskutuar dokumentin në dalje. Strategjia e Sigurisë së BE-së është kryesisht mbi

diplomacinë publike; Koncepti Strategjik i NATO-s mban një dimension strategjik. Ndaj, një herë që kryetarët e shteteve dhe qeverive kanë përfunduar vlerësimin strategjik (kjo detyrë bëhet edhe në BE), ambasadorët e NATO-s dhe deputetët e tyre kryesisht drejtojnë situatën. Qeveritë e dinë që distanca midis Konceptit Strategjik dhe vendimeve që kanë të bëjnë me luftën dhe paqen është e shkurtër, kështu që ato grinden për të kontrolluar dhe formuar Konceptin.

Koncepti Strategjik që NATO do të bjerë dakord në vitin 2010 ose 2011 do të jetë Koncepti Strategjik i tretë i NATO-s së pas Luftës së Ftohtë, edhe pse në disa mënyra është numri 3.5. Një koncept i tillë i parë i NATO-s u publikua në samitin e Romës në Nëntor 1991; ky u azhornua dhe përmirësua në kohë për samitin e Romës - dhe përvjetorin e pesëdhjetë të Aleancës - në prill 1999. Ky Koncepti i dytë qëndron akoma, megjithatë, nga vitet 2004-2005, pas sulmeve terroriste të 11 Shtatorit dhe përfshirjes së NATO-s në Afganistan, u ngrit çështja që diskutonte faktin nëqoftëse Koncepti i dytë kishte nevojë për modifik ose edhe ndërrim. Pas mungesës së një marrëveshjeje politike, të simbolizuar, sigurisht, nga debatet mbi luftën e Irakut, një vendim u mor për të përmisuar pjesën e Konceptit Strategjik që merret me implikimet ushtarake, pra të siguronte një guidë më të mirë për autoritetet ushtarake aleate. Rezultati ishte aprovimi i të ashtuquajturës Guida Politike e Kuptueshme (GPK) në samitin e Rigës në nëntor 2006. Arritja çoi në dy Koncepte të reja Strategjike dhe një Guide Politike e Kuptueshme (GPK). Një pamje e përgjithshme vazhdon më poshtë.

“Koncepti i ri Strategjik i Aleancës’ i nëntorit 1991 u bazua te percaktimi i zgjeruar i sigurisë dhe nga tranzicioni prej kërcënimeve në rreziqe: “Në kontrast me kërcënimin dominues të së kaluarës, rreziqet që mbetën për sigurinë e Aleancës janë shumëfaqëshe në natyrë dhe shumëdrejtimëshe, gjë që i bën ato të vështira për tu parashikuar dhe vlerësuar.”⁶ Nuk kishte shumë për të kodifikuar pas Luftës së Ftohtë, si

⁶ Paragrafi 8, <http://www.nato.int/docu/comm/49-95/c911107a.htm>, i aksesuar më 1 dhjetor 2008.

rezultat i shpjëtësisë së ngjarjeve dhe periudhës së shkurtër që kishte kaluar që nga rënia e Murit të Berlinit (Bashkimi Sovjetik ekzistonte akoma në nëntor 1991), por Koncepti Strategjik në mënyrë eksplicite i referohet Deklaratës së Londrës në 1990-n mbi një Aleancë të Transformuar që premtoi një sërë ndryshimesh për të siguruar vazhdimësinë e Aleancës.⁷ Koncepti Strategjik pastaj hyri në sferën e influencës të drejtimit strategjik dhe diplomacisë publike duke krijuar katër “detyra themelore të sigurisë”:⁸

- Të sigurojë një nga themelime të nevojshme për një mjedis stabil sigurie në Europë, gjë që ishte një mënyrë tjetër për të mbajtur Shtetet e Bashkuara të përfshira ose “në” Europë;
- Të shërbejë, si sigurohet në Nenin 4 të Traktatit të Atlantikut të Veriut, si një forum transatlantik për konsultime të Aleancës në çdo çështje që afekton interesat e tyre vitale;
- Të ndalojë dhe mbrohet kundrejt çdo kërcënimi për agresion kundrejt territorit të cilitdo shteti anëtar të NATO-s, kjo lidhet me Nenin 5 dhe 6;
- Të ruajë balancën strategjike brenda Europës - një referencë për pushtetin sovjetik të mbetur në Europë.

Udhëzimet e mbrojtjes në këtë Koncept Strategjik fillimisht panë një ndryshim nga një posturë e kuptueshme, e përgatitur, me mbrojtje lineare të një posturë e zvogëluar dhe më fleksible që përbëhej nga një grup forcash i përgatitur për reagime të shpejta dhe të menjëhershme, forca kryesore mbrojtëse, dhe forca ekspansioni.

“Koncepti Strategjik i Aleancës” i prillit 1999 ishte një version i rishqyrtuar i Konceptit të vitit 1991, arsye se përse fjala “i ri” u hoq nga titulli. Natyra e alteracionit mund të vlerësohet më mirë nga “detyrat themelore të sigurisë”: tre detyrat e para nuk u ndryshuan, edhe pse u riemërtuan

⁷ Shiko paragrafin 15 të Konceptit Strategjik. Për Deklaratën e Londrës, shiko <http://www.nato.int/docu/comm/49-95/c900706a.htm>, i aksesuar më 1 dhjetor 2008.

⁸ Shiko paragrafin 20.

Sigurimi, Konsultimi, Parandalimi dhe Mbrojtja, respektivisht - ndërsa detyra e katërt u ndryshua. Ndoshta nuk është për t'u çuditur që në vitet 1998-1999 NATO nuk e ndjeu të nevojshme të shqetësohej për “balancën strategjike” të Europës, por pyetja ishte se çfarë të vendoste në vend të saj. NATO ishte e ndarë midis perspektivës globale dhe rajonale dhe të përfundojë në një pozicion kompromentues, që është i dukshëm në dy aspekte: e para, rëndësi iu kushtua “zonës euroatlantike”, që është më shumë se territori i NATO-s; e dyta, detyra e katërt thelbësore e sigurisë nuk është një vazhdim i tre detyrave të para por u prezantua me një vijë efektive që e ndante atë:⁹

- Sigurimi
- Konsultimi
- Parandalimi dhe Mbrojtja
- Dhe për të rritur sigurinë dhe stabilitetin e zonës euroatlantike:
 - Menaxhim krize në baza të ndryshme dhe me konsensus
 - Partneritet, bashkëpunim, dhe dialog me zonën euroatlantike

Kjo hierarki e mprehtë e detyrave thelbësore kishte të bënte me faktin që menaxhimi i krizave lidhej me Nenin 7 të Traktatit të Uashingtonit dhe me rolin e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (KSKB) në sigurimin e përgjithshëm të paqes dhe stabilitetit. Ashtu si në vitet 1948-1949, në vitet 1998-1999 NATO nuk ishte dakord të depozitonte vendimmarrjen e saj te KSKB-ja; megjithatë, citimi i saj ishte një diplomaci e mirë publike - dhe një përgjigje e përshtatshme për krizën në të cilën gjendej NATO, meqenëse samiti u zhvillua midis fushatës bombarduese në Kosovë.

Udhëzimet ushtarake të vitit 1999 treguan që operacionet ndërhyrëse në kriza mund të kërkojnë ndërhyrje të shpejta larg vendit të tyre, por megjithatë politika e përgjithshme

⁹ Paragrafi 10, <http://www.nato.int/docu/pr/1999/p99-065e.htm>, i aksesuar më 1 dhjetor 2008.

vazhdoi ndryshe nga parimi i mbajtjes së forcave në “nivele më të ulët konsistent me kërkesat e sigurisë kolektive”.¹⁰ Gadishmëria e diplomuar u krijua pas kësaj, gjë që tregoi se operacionet në përgjigje të krizave do të drejtoheshin nga forcat ndërtuese, duke i dislokuar ato, dhe vizatuar ato ashtu si nevojitej. Të drejtuara nga kryetarët e shteteve dhe qeverive në qershor 2004, GPK-ja e 2006-s u krijua për të korigjuar këtë. Ajo instruktonte autoritetet ushtarake për të theksuar më shumë në “aftësinë për të përballuar sfidat, nga kudo që mund të vinin” dhe të ishin të aftë për t’iu “përgjigjur shpejt rrethanave të papritura” dhe të krijonin një sërë teknikash të gjera të menaxhimit të krizave ushtarake dhe civile.¹¹ GPK-ja përgatiti gadishmërinë e diplomuar në favor të betejës dhe qëndrueshmërisë, duke i kërkuar shteteve anëtare të mendojnë më gjerë mbi menaxhimin e krizave. E gjitha kjo ishte një kodifikim mbi debatet mbi mësimet të mësuara nga luftrat në Afganistan por edhe në Irak: ashtu si mund të shohim, polemika e lindur në këto luftra kërcënoi për të prishur GPK-në, por në fund GPK-ja u finalizua dhe aprovua në Riga.

Si u vu në dukje, GPK-ja ishte kryesisht një përditësim ushtarak, por kishte dy fotografi të vogla të “kontekstit strategjik”.¹² Nuk na duhet të shikojmë më tepër në qoftë se duam të kuptojmë polemikat që shoqëruan bërjen e një Koncepti Strategjik në këtë kohë. Paragrafi i parë përshkruan “kërcënimin kryesor” të mundshëm të NATO-s për 10-15 vitet e ardhshme: “Terrorizmi në rritje, globale në qëllim dhe letal në rezultate, dhe përhapjen e armëve të shkatërrimit në masë”. Paragrafi tjetër merret me zgjidhjet dhe vëren se “Paqja, sigurimi dhe zhvillimi janë më të ndërlydhura se kurrë”: Ndaj NATO-s do t’i duhet të punojë me OKB-në, BE-në dhe organizata të tjera në një rrjet marrëdhëniesh sigurie. Paragrafi i parë pra shpjegon kërcënimin që frymëzoi strategjinë e sigurisë kombëtare të George W. Bush, tek e cila disa aleatë

¹⁰ Paragrafi 53.

¹¹ Paragrafi 7 i GPK-së, <http://www.nato.int/docu/basic/txt/b061129e.htm>, i aksesuar më 3 dhjetor 2008.

¹² Paragrafi 2 dhe 3.

europianë u regjistruan; paragrafi i dytë, nga ana tjetër paraqet zgjidhjet shumëpalëshe që aleatët e tjerë europianë promovuan si një mjet për të lidhur atë që ata perceptuan si unilateralizmin e shfrenuar të SHBA-së gjatë vitit të parë të Bushit në post.

Në qoftë se do të na duhej të gjenim origjinën e Konceptit Strategjik që është tani në axhendë, duhet të kthehemi mbrapsht në vitet pas sulmeve terroriste të 11 Shtatorit dhe të ekzaminojmë procesin që çoi në adaptimin e GPK-së. GPK-ja simbolizon lëvizjen e irrituar por gjithsesi pjesërisht të suksesshme për të riorientuar strategjinë e Aleancës. Si e përmendëm më parë, GPK-ja ishte propozuar në qershor 2004, në samitin e Stambollit. Si e dimë, viti para kësaj detyre u shënuar nga një ndarje diplomatike, dhe Shtetet e Bashkuara kërkuar në një fazë për t'iu kundërvënë asaj që perceptohej të ishte një lëvizje e balancuar brenda BE-së, ku Franca, Gjermania, Belgjika, dhe Luksemburgu po nxiteshin për të krijuar një shtab të përgjithshëm ushtarak autonom të BE-së. Ambasadori i SHBA-së në NATO, Nicolas Burns, e quajti këtë “një nga rreziqet më të mëdha të marrëdhënies transatlantike”¹³ dhe thirri një samit të jashtëzakonshëm NATO-BE. Më vonë, në tetor 2003, Shtetet e Bashkuara kërkuar adaptimin e një “vizioni të përbashkët strategjik” midis NATO-s dhe BE-së që mund të përgatitej për miratim në samitin e Stambollit.¹⁴ Sidoqoftë, ndarjet diplomatike ishin kaq të thella sa që një marrëveshje e tillë ishte e pamundur; çfarë ishte e mundur ishte një pamje e re në kërkesat ushtarake, dhe kjo u bë GPK-ja.¹⁵

Vështirësitë e të shkruarit GPK-në kishin të bënin me mosmarrveshjet e vazhdueshme diplomatike. Në veçanti, ne

¹³ Judy Dempsey, “NATO Kërkon të Sfidojë Planin e Mbrojtjes Europian“, *Financial Times*, 17 tetor 2003.

¹⁴ Chris Lindborg, Takimet Ministeriale të NATO-s në Bruksel: Duke Pritur për Samitin e Stambollit të 2004-ës, *Basic Briefings*, 3 dhjetor 2003, <http://www.basicint.org/pubs/NATObref.htm>; Michael Evans, “SHBA ofron vision për NATO-n”, *London Times*, 22 tetor 2003.

¹⁵ Rebecca More (ed.), Duke Transformuar NATO-n (...përsëri): Një Tekst Hyrës për Samitin e NATO-s në Riga 2006, Qendra për Studime Strategjike dhe Ndërkombëtare, nëntor 2006, fq. 15-17.

Konferencën e 41-të të Munihut mbi Politiken e Sigurisë, kancelari Schroeder kritikoi faktin që NATO nuk ishte më një sfond ku aleatët kujdeseshin për të “konsultuar dhe koordinuar” strategjitë e tyre, një kritikë që është interpretuar gjerësisht si një hap tjetër në dyluftimin e vazhdueshëm midis NATO-s dhe BE-së.¹⁶ Çështja e vjeshtës 2005 mbi rishqyrtimin e NATO-s solli së bashku vëzhgues të ndryshëm mbi çështjen e reformës së Konceptit Strategjik: disa menduan që NATO ishte në nevojë urgjente të një koncepti të ri;¹⁷ disa menduan që problemi qëndronte te mungesa e realitetit politik e europianëve dhe kanadezëve;¹⁸ dhe njëri më në fund argumentoi që Koncepti Strategjik i 1999-s mund ta bënte punën, vetëm sepse ushtrimi i rishikimit të Konceptit në kohë turbulente do të krijonte copëtim, dhe jo bashkim.¹⁹ Në këtë pikë, në vitin 2005, asgjë nuk tregonte që një Koncept i ri Strategjik do të dilte në krye të axhendës; në të kundërt, e shumta që Aleanca mund të dëshironte ishte përfundimi i suksesshëm i GPK-së.

Si arriti që t’ia dalë GPK-ja kësaj turbulence, dhe si mundet që reforma e Konceptit Strategjik mbizotëroi në fund? Nuk ka një përgjigje të saktë për këto pyetje, por thjesht disa të mundshme. Një ka të bëjë me fatet elektorale në Gjermani, ku Angela Merkel u bë kancelare në nëntor 2005. Në Konferencën e 42-të të Munihut mbi Politikën e Sigurisë, në

¹⁶ Gerhard Schroeder, 2005,

(http://www.securityconference.de/konferenzen/rede.php?menu_2005=&menu_konferenzen_archiv=&menu_2009=&menu_konferenzen=&sprache=en&id=143&).

Për debatin, shiko Richard Norton-Taylor, “Schroeder thërret për rishikim të NATO-s”, *The Guardian*, 14 shkurt 2005; Judy Dempsey, “SHBA-ja refuzon planin e Gjermanisë për NATO-n”, *International Herald Tribune*, 15 shkurt 2005.

¹⁷ Peter Van Ham, 2005, (<http://www.nato.int/docu/revicë/2005/issue3/english/analysis.html>) , Lionel Posnard 2005 (<http://ëëë.nato.int/docu/revicë/2005/issue3/english/debate.html>).

¹⁸ Julian Lindley-French, 2005, “Botë e madhe, pasuri e madhe, NATO e madhe”, *Revista e NATO-s*, pranverë.

¹⁹ David Yost, 2005, (<http://www.nato.int/docu/revicë/2005/issue3/english/debate.html>)

shkurt 2006, përdori një fjalor tjetër nga ai i paraardhësve të saj, ku midis të tjerave shprehu që NATO duhet të kuptojë që bota ka ndryshuar përsëri në mënyrë të konsiderueshme që nga 1999-a. Për këtë arsye unë propozoj që ne të diskutojmë në qoftë se duam të shikojmë përsëri në vitin 1998 apo 2009 - dhjetë vjet pas Konceptit Strategjik të fundit - se si duhet ta zhvillojmë atë më shumë; kujtoni, 1999-a ishte para 11 Shtatorit 2001 [dhe] para ciklit të madh të zgjerimit. Që nga kjo pikë, gjërat filluan të ndryshonin brenda Aleancës: GPK-ja u shkrua kryesisht midis shkurtit dhe nëntorit 2006. Lidhshipi nga Sekretari i Përgjithshëm është një faktor tjetër që duhet të përmëndim. Duke filluar nga samitin e nëntorit 2006, Sekretari i Përgjithshëm Hoop de Scheffer filloi të përdorë pushtetin e tij më pushtetshëm për të përcaktuar një axhendë të re: duke shënuar momentin e ri politik, ai tha: “Pra duke parë te 2008-a - por edhe më tej gjashtëdhjetëvjetorit tonë në 2009 - unë parashikoj që ideja do të marrë vrull për të draftuar një dokument të ri, themelor që do skicojë strategjinë madhore të NATO-s”.²⁰ Në fund, intervista sfondi të ndryshme tregojnë që një faktor final në lëvizjen e axhendës përpara ishte një koalicion i lirshëm i kombeve mendje-ndryshuese - ato që kanë më shumë dëshirë për të investuar në forcat e transformuara dhe reformat e NATO-s.²¹ Njerëzit janë të kujdesshëm të mos drejtojnë gishtin te kombet jo entuziaste, por ndoshta nuk është një zgjatje e imagjinatës të argumentosh që pjesa më e madhe e kombeve mendje-ndryshuese janë ato që kanë qenë më të përfshira në terren në Afganistanin jugor dhe lindor.

Një tentativë marrëveshjeje kishte dalë nga koha e saminit të Bukureshtit në prill 2008. Kryetarët e shteteve dhe qeverisë më vonë deklaruan:

Ne po presim me padurim për Samitin e 60-vjetorit në 2009, i cili do të nënvizojë rëndësinë e vazhdueshme të lidhjes së transatlantikut. [...] Samiti do të sigurojë një mundësi për të artikuluar dhe përforcuar më vonë vizionin e Aleancës mbi

²⁰ <http://www.nato.int/docu/speech/2006/s061128a.htm>. Sekretari i Përgjithshëm përsëriti thirrjen e tij për një Koncept Strategjik të ri në Konferencën e ardhshme mbi Politikën e Sigurisë në shkurt 2007.

²¹ Intervista në Shtabin e Përgjithshëm të NATO-s, 30-31 tetor 2008.

rolin e saj duke arritur sfidat e shekullit XXI dhe duke mbajtur aftësinë për të performuar gamën e plotë të misionëve të saj, duke përcaktuar kolektivisht sigurinë tonë në vend dhe duke kontribuar për stabilitet jashtë. Në përputhje me rrethanat, ne thërrasim Këshillin në Seanca Permanente për të përgatitur një Deklaratë mbi Sigurinë e Aleancës për adaptim në Samit për të krijuar më tej skenën për këtë detyrë të rëndësishme.

Kjo thërret për një vizion të përforcuar dhe në këtë masë një Deklaratë mbi Sigurinë e Aleancës (DSA) të re është një shenjë e sigurt që një rishikim strategjik po merr rrugë. DSA-ja do të jetë gati nga prilli i 2009-s, e cila nga fjalët e Sekretarit të Përgjithshëm Hoop de Scheffer, “me shumë shpresë do të fillojë procesin e projektimit të një Koncepti Strategjik të ri për të përcaktuar rolin e NATO-s në plotësimin e këtij qëllimi”.²² Zyrtarë të rangut të lartë të NATO-s treguan që DSA-ja do të jetë një “pararendëse” për Konceptin Strategjik, edhe pse zyrtarë kombëtarë të ndryshëm ishin ngurrues për të bërë një lidhje kaq të fortë midis dy dokumenteve. Ambasadori aktual i SHBA-së në NATO, Kurt Volker, ka lënë të kuptohet për DSA-në që do të jetë më shumë se një “kartolinë ditëlindjeje” por më pak se “një përmbledhje e përgjithshme e një Koncepti Strategjik” e cila do të jetë kompletuar më vonë me punë të tjera. Sipas Volker, administrata e re do të nevojitet me kohë për të krijuar një politikë koherente në NATO.²³

Konceptet Strategjike të 1991 dhe 1992 u shoqëruan të dy nga deklaratat solemne. Megjithatë, të dyja deklaratat u nxorën njëkohësisht me Konceptet. “Deklarata e Romës mbi Paqen dhe Sigurinë” e vitit 1991 është fjalëshumë, ndoshta duke reflektuar mbi mjedisin e trazuar gjeopolitik. “Deklarata e

²² <http://www.nato.int/docu/speech/2008/s081110a.html>, aksesuar më 5 janar 2009.

²³ Ambasadori i SHBA-së në NATO Kurt Volker, “Duke Lançar 60 vitet e ardhshme të NATO-s: Ku jemi dhe Ku na duhet të shkojmë? Fjalim i mbajtur në Qendrën për Studime Ndërkombëtare Strategjike, 9 dhjetor 2008, http://www.nato.usmission.gov/ambassador/2008/Amb_Volker_120908.htm, i aksesuar më 5 janar 2009.

Uashingtonit” e vitit 1999, në të kundërt, është e shkurtër dhe e thatë, por u prodhua si një shtesë e minutës së fundit e dokumenteve të tjera të samitit (të njohura si komunikata e Uashingtonit dhe Koncepti Strategjik) kryesisht për arsye të diplomacisë publike. Qasja e 2009-s është e ndryshme. DSA-ja do të jetë e shkurtër dhe e thatë si ajo e vitit 1999, por do të bëjë më tepër se të nxjerrë jashtë shqyrtimin strategjik. Kjo na kthen prapa te funksionet e ndryshme të Konceptit Strategjik: kodifikim, diplomaci publike dhe drejtim strategjik. Është sikur aleatët të kuptonin që funksioni i fundit - drejtimi strategjik - është më i rëndësishëm se sa ky cikël kohe, që do të shpjegojë qasjen e DSA-së fillimisht, pastaj atë të KS-së. Një zyrtar i lartë i NATO-s e shprehu hapur: “Deklarata mbi Sigurinë e Aleancës është me rëndësi supreme”. Ai vazhdoi duke argumentuar që DSA do të marrë esencën e NATO-s dhe do përgatiti detyrën më urgjente të Aleancës, identifikimin dhe kuptimin e përbashkët të qëllimit që ka munguar këto vitet e kaluara. Një zyrtar tjetër i lartë i NATO-s që punon afër me Sekretarin e Përgjithshëm krahasoi të kaluarën dhe të tashmen dhe u shpreh që “Kjo kohë është ndryshe - njerëzit janë seriozë”.

2. Kundërshtitë: NATO e vjetër apo NATO e re?

Çfarë do të përmbajë Koncepti i ri Strategjik, dhe me çfarë tipologjie të NATO-s do të përballemi? Në këtë seksion adresojmë këto pyetjeve, duke theksuar në mënyrë të veçantë dy vizionet konkurruese të NATO-s: njëra është “Kthim në shtëpi, NATO?”, e cila bën thirrje për një ankorim rajonal të Nenit V të aleancës; dhe tjetra është “Të globalizosh, budallallëk”, i cili nënkupton se NATO do të injorojë globalizimin nëse rrezikohet vetë. Pozicioni i parë thekson vazhdueshmërinë midis aleancës të së shkuarës dhe së ardhmes; ai i mëvonshmi thekson transformimin e NATO-s nga një aleancë tradicionale në një “qendër të marrëdhënieve të sigurisë” që është e destinuar të menaxhojë probleme globale,

si u shpreh një titullar.²⁴ Sigurisht që midis këtyre dy pozicioneve ka mbivendosje: Neni V mbetet kryesor për ithtarët e globalizimit, ashtu si çështjet globale figurojnë në axhendën rajonale të NATO-s. Kjo është një çështje që duhet theksuar. Akoma theksimi në këto çështje është i rëndësishëm, dhe ne i adresohemi kundërshtive themelore për sa i përket, së pari çështjeve politike dhe ushtarake.

2.1 NATO politike: Kërcënimet dhe Detyrat Themelore të Sigurisë

Polemikat që lidhen me pjesën politike të Konceptit të Strategjisë, duket të jenë më seriozet. Veçanërisht, formulimi mbi Detyrat Themelore të Sigurisë që përmbledhin thelbin e përparësive, si është artikuluar në dokumentin e analizës strategjike, është e destinuar të shkaktojë kundërshti. Ndërsa disa shtete anëtare do t'i japin shtysë vazhdimësisë së veprimeve transformuese të Aleancës nga një ofrues i mbrojtjes kolektive drejt një projektuesi të stabilitetit të përgatitur nga partnerë dhe aleatë globalë, të tjerë do të kërkojnë për atë që një diplomat i NATO-s i një ish-vendi të Traktatit të Varshavës e quajti “rebalancim” të qëllimeve të organizatës dhe të përgjegjësive të Konceptit Strategjik.²⁵ Sipas pozicionit më të fundit, aleatët duhet të rikonsiderojnë kërcënimet për aleancën e sigurisë dhe të nënvizojnë rëndësinë e lartë të Nenit V.

Në qendër të çështjes është fakti që NATO është bërë një gjë e ndryshme për shtete të ndryshme. Në të vërtetë, NATO aktualisht është ndëshkuar nga një skizofreni e një strategjie të pashëndetshme. Ndonëse të gjithë anëtarët e NATO-s ranë dakord për prioritetet e qëllimeve të Aleancës që nga rënia e Murit të Berlinit, sot ata vënë theksin në risqet e ndryshme në

²⁴ Intervistë në Shtabin e Përgjithshëm të NATO-s, 30 tetor, 2008. Shiko edhe Jaap de Hoop Scheffer, *Duke Menaxhuar Sigurinë Globale dhe Rreziqet*, fjalim në Konferencën Vjetore IISS, 7 shtator 2007, <http://www.nato.int/docu/speech/2007/s070907a.html>, i aksesuar më 13 janar 2009.

²⁵ Intervistë në Shtabin e Përgjithshëm të NATO-s, 30 tetor 2008.

rajone të ndryshme, dhe në pasojat e debatuar.²⁶ Pikëpamjet divergjente në *raison d'être* të NATO-s janë të reflektuara në dy çështje ngushtësisht të ndërlidhura të një rëndësie kyçe të hartimit të Konceptit Strategjik të ri: natyra e mjedisit të sigurisë në ndryshim, dhe të përgjigjeve të përshtatshme të sfidave dhe oportuniteteve të tashme të këtij mjedisi.

Në mendjet e atyre shteteve anëtare që i drejtohen NATO-s për të riorganizuar fokusin e saj strategjik në zonën euroatlantike, pesha e mëparshme që i ishte dhënë rolit të Aleancës si “ruajtësja e balancës strategjike brenda Europës” duhet riparë në Konceptin e ri Strategjik: NATO në disa zgjatime të saj duhet të kthehet në bazë. Shumica e shteteve në këtë grup, duke përfshirë Norvegjinë, shtetet baltike si Estonia, Letonia dhe Lituania, ashtu sikundër edhe shumica e anëtarëve të Aleancës nga Europa Lindore, shohin një Rusi të rigjallëruar si një nga kërcënimet kryesore për sigurinë e tyre.²⁷ Në gusht të 2008-s lufta ndërmjet Ruisë dhe Gjeorgjisë është marrë “si një dëshmi e hapur e kolapsit të ëndrrës së një sistemi të sigurise post-moderne në Europë ku shtetet refuzojnë të përdorin forcën për të zgjidhur mosmarrëveshjet e tyre”.²⁸ Sipas kësaj analize, Realpolitika tradicionale ka bërë rihyrjen e saj në skenën europiane, dhe Aleanca duhet t’i përshtatet. Disa nga aleatët e rinj të NATO-s, ata që janë pranuar mbas përfundimit të Luftës së Ftohtë, janë duke bërë thirrje për një rimendim të politikës së parandalimit të Aleancës. Minimalisht, këto shtete insistojnë për një riformulim të Konceptit Strategjik të tanishëm më tepër se sa përshkrimi rozë i marrëdhënieve të NATO-s me Rusinë (paragrafi 36). Fakti se NATO ka

²⁶ Dhoma e Ulët, Komiteti i Mbrojtjes, E ardhmja e NATO-s dhe mbrojtja europiane, Raporti i Nëntë i Seksionit 2007-2008, fq. 11-23.

²⁷ Zgjedhja e Norvegjisë për të blinduarën në mënyrë sekrete

“Goditje e Përbashkët Luftëtare“ e Lockheed Martin si një zëvendësuese për F-16-at e vjetra duket se vërteton pikëpamjen që lidhshipi politik norvegjez konsideron Rusinë si kërcënimin kryesor për sigurinë e vendit, shiko Brigitte Marfelt, “Stealth-engenskaber til at vaelge kampflyet JSF“, Ingenioren, 21 nëntor 2008.

²⁸ Maria Malkso, “Koncepti Strategjik i Ri i NATO-s, cili është basti për Estoninë?” *Policy Paper*, Qendra Ndërkombëtare e Studimeve të Mbrojtjes, fq. 1.

theksuar në mënyrë retorike vazhdimësinë e lidhjes të ashtuquajtur “Klauzola Mosketiere” e Aleancës (si p.sh. në GPK, paragrafi 4) ka bërë pak për t’i komfortuar ata.²⁹

Ndërsa ato shtete anëtare në këtë kategori me shumë gjasa do të frenohen nga kërkesa për një përmendje të qartë të Ruisë në analizën e Konceptit të ri për sfidat e tashme dhe të ardhme të sigurisë, ato do të insistojnë në një ritheksim të mundësisë për një krizë rajonale dhe konflikteve konvencionale në zonën euroatlantike. Për më tepër, duke ditur se shumë nga këto shtete varen nga furnizimet e qëndrueshme me naftë nga Rusia dhe - në veçanti - me gaz, ato janë duke kërkuar gjithashtu për një formulë në çështjen e sigurisë energjitike.³⁰ Në fakt ato argumentuan se, NATO do të ketë nevojë të rrenjosë një balancë të re midis risqeve të sigurisë të prejardhura nga paqëndrueshmëritë globale dhe kërcënimeve politiko-ushtarake që mund të jenë si shkak i aktorëve shtetërorë “afër, jashtë” NATO-s.

Për këta aleatë, duke përfshirë edhe SHBA-në, Mbretërinë e Bashkuar, Danimarkën dhe Holandën³¹, të cilat - ndonëse në nivele të ndryshme - pajtohen për vizionin e një Aleance Atlantike që ndërhyt dhe integrohet globalisht, përgatitja e një “Koncepti Strategjik të nivelit të 1991-shit” do të ishte një gabim i madh. Ky grup shtetesh është pa dyshim i shqetësuar për zhvillimet e fundit në Rusi, por ato pohojnë se NATO duhet t’i mbajë sytë në ballë, domethënë t’u tregojë rreziqet globale anëtarëve të saj. Në fjalët e ambasadorit të SHBA të NATO-s Kurt Volker:

²⁹ Në fillim të luftës Ruso-Gjeorgjiane, Polonia pyeti - dhe siguroi-garancinë e sigurisë bilaterale me Amerikën si pjesë e marrëveshjes rreth parapritës së mbrojtjes së raketave të vendosura në vend: “Polonia firmosi marrëveshjen e mbrojtjes nga raketat me SHBA-në”, <http://edition.cnn.com/2008/WORLD/europe/08/02/poland.us.missile/index.html>, e aksesuar më 6 janar 2009. Shiko gjithashtu Karl-Heinz Kamp, “Mbas Samitit: Pasjoa Afat-Gjata për NATO-n”, *Research Paper*, Kolegji i Mbrojtjes së NATO-s, fq. 4.

³⁰ Intervistë në Shtabin e Përgjithshëm të NATO-s, 30 tetor 2008; Intervistë në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Danimarkës, 28 tetor 2008.

³¹ Dhoma e Ulët, Komiteti Mbrojtjes, op.cit., fq.16

Po ndodhin dhumë gjëra në Lindje. Jo gjithçka ka të bëjë me Gjeorgjinë, edhe pse ajo është një pjesë e saj. Kjo i kthen këto axhendat në përgjegjësi të NATO-s. Unë shpresoj që ne nuk do ta teprojmë. Unë shpresoj që ne nuk do të mendojmë se kjo është e gjithë axhenda e NATO-s. Edhe pse kur e shoh tani, mendoj për të si më e mira ndoshta 40 për qind e asaj që ne duhet të mendojmë sepse ka shumë gjëra të tjera që janë më të rëndësishme dhe më imediate, veçanërisht operacionet në Afganistan dhe kërcenimet e reja të sigurisë me të cilat ne po meremi, si terrorizmi dhe proliferimi, shtetet e dështuara, dhe pasojat e gjithë kësaj.³²

Megjithëse Koncepti Strategjik i vitit 1999, në mënyrë të qartë i kushtoi më shumë rëndësi rrezikut dhe kërcënimit që vinte nga jashtë zonës euroatlantike se sa paraardhësit e tij të 1991-shit,³³ “globalizuesit” stimuluan Aleancën të hiqte dorë tërësisht nga vetimponimi i kufizimit gjeografik. Këto shtete do të bëjnë presion për një vërtetim më të qartë të kërcënimeve globale – p.sh. terrorizmi transnacional, pirateria, terrorizmi virtual, shtetet e dështuara dhe proliferimi i materialeve dhe teknologjisë bërthamore - në një seksion të rëndësishëm të Konceptit të ri atë të “Sfidat dhe Rreziqet e Sigurisë”.

Atëherë si duhet skicuar Koncepti i ri Strategjik i NATO-s që t’i përgjigjet një mjedisi të sigurisë në zhvillim dhe të dykuptimtë? Jo çuditërisht, ata që pajtohen me vizionin “kthim në shtëpi, NATO” kanë qenë përgjithësisht skeptik për përfshirjen e Aleancës në shumë aktivitete larg periferisë së zonës euroatlantike, dhe më tepër të ngurruar për të përqaftuar

³² Ambasadori i SHBA-së në NATO Kurt Volker, “Duke lancuar vitin e ardhshëm të NATO-s: Ku jemi dhe ku duhet të shkojmë?”, Fjalimi i mbajtur në Qendrën për Studime Strategjike dhe Ndërkombëtare, 9 dhjetor 2008, http://nato.usmission.gov/ambassador/2008/Amb_Vokler_120908.htm, I aksesuar më 17 dhjetor 2008.

³³ Krahaso për shembull paragrafin 6 në Konceptin e 1999-s me paragrafin 15 të Konceptit të vitit 1991. Të dy paragrafët theksojnë qëllimin rrënjësor të NATO-s, por në Konceptin e 1999-s janë shtuar fjalitë e mëposhtme: “Arritjet e këtij qëllimi mund të vendosen në risk nga krizat dhe konfliktet duke prekur edhe sigurinë e zonës euroatlantike. Prandaj Aleanca jo vetëm që siguron mbrojtjen e anëtarëve të saj por kontribuon për paqen dhe stabilitetin në rajon”.

idenë e një organizate me një anëtarësim global.³⁴ Megjithatë, skepticizmi ka forma të ndryshme. Për disa aleatë, një NATO globale duhet penguar sepse ajo do të përbëjë së pakti një instrument amerikan për të arritur rendin botëror unipolar dhe një ndjekje të interesave strategjike të SHBA-së. Për të tjerë, NATO duhet të tërhiqet nga veprimi dhe integrimi global, pasi ashtu si u supozua një transformim i mëtejshëm do të dëmtojë vlefshmërinë e Nenit V. Në mënyrë paradoksale disa nga aleatët në kategorinë e fundit - si për shembull, Polonia, Estonia, dhe Lituania - kanë çuar relativisht një numër të madh të forcave të armatosura në zonën e jashtme të operacioneve në Afganistan dhe Irak. Kjo, sigurisht reflekton perceptimin e këtyre shteteve që siguria kundër kërcënimeve konvencionale vjen në formën e Aleancës, dhe në veçanti garancitë e sigurisë amerikane. Kështu që, përdorimi i forcave në Afganistan është një çmim i sigurisë dhe përgjigjja më e mirë për perceptimin ndaj kërcënimeve rajonale të integritetit territorial dhe politik. Intervistat e zhvilluara në Shtabin e Përgjithshëm të NATO-s, në Bruksel, treguan se kjo është në të vërtetë logjika që përdorin shumica e shteteve anëtare në vendimin për të shpërndarë forcat në Afganistan dhe Irak.³⁵

Për “globalizuesit”, misioni i tanishëm në Afganistan është një precedent për gjërat që do të vijnë. Ashtu si u tha nga Komiteti Britanik i Mbrojtjes: “Për shkak të natyrës globale të kërcënimeve me të cilat ne përballemi, ne besojmë se nuk ka alternativë për Aleancën veçse të përmbushë një rol global. Gadishmëria dhe aftësia për të vepruar në një nivel global për të marrë përsipër problemet që ngrihen është fundamentale për vazhdimësinë e NATO-s”.³⁶ Kjo është gjithashtu pikëpamja që ka Qeveria Britanike. Në Kapitullin e ri të Revistës së

³⁴ Për një investigim të këtyre dy interpretimeve të ndryshme të “NATO globale” - NATO duke vepruar në mënyrë globale dhe NATO “duke qenë globale” - shiko Flockhart dhe Kristensen, “NATO and Partneriteti Global”: të jesh global apo të veprësh globalisht., *DIIS Report 2008:7*, Instituti Danez për Studime Ndërkombëtare.

³⁵ Intervistë në Shtabin e Përgjithshëm të NATO-s, 30 dhe 31 tetor 2008.

³⁶ Dhoma e Ulët, Komiteti Mbrojtjes, op cit., fq.16

Mbrojtjes Strategjike më 2002, qeveria nënvizoi faktin se “është më mirë, aty ku është e mundur, të merremi me një armik në një zonë më të gjerë, përpara se ata të kenë mundësinë të arrijnë në një mësymje në Mbretërinë e Bashkuar”.³⁷ Në këtë konceptim të qëllimeve kryesore të NATO-s, përmbajtja reduktuese e GPK-së përbën një lëvizje më të vogël në drejtimin e duhur, ashtu si kjo përshkruan evoluimin e mjedisit të sigurisë si “kompleks dhe global”. Përveç kësaj, GPK-ja theksoi kërcënimet që vijnë nga “Terrorizmi në rritje, global në qëllim dhe letal në rezultate” shpërhapja e armëve të shkatërrimit në masë dhe forcimi i “aftësisë së Aleancës për të përballuar sfidat kudo ku ato shfaqen”.³⁸ Bazuar në intervistat tona në Bruksel dhe Kopenhagen, ne kemi arsye të besojmë se grupi i shteteve që po promovon vizionin e NATO-s si një eksportues i sigurisë globale - të përhapur nga SHBA-ja³⁹- do të punojë të zëvendësojë luftën kundër terrorizmit dhe kundërzbulimit të proliferimit të armëve të shkatërrimit në masë përgjatë Detyrave Themelore të Sigurisë të Konceptit Strategjik të Ri.

Veç kësaj, disa nga përkrahësit e vizionit “Të Globalizosh, budallallëk” do të përpiqen të ndërtojnë në Konceptin Strategjik në të ardhmen perspektivën ku NATO mund të përfshihet në një partneritet global të institucionalizuar, dhe ndoshta t’i hapë derën një anëtarësimi global në Aleancë. Çështja u ngrit fillimisht nga kryetari i Uashingtonit në Samitin e Rigës më 2006, ku SHBA-ja kërkoi forma më të formalizuara bashkëpunimi me disa shtete jo anëtare të NATO-s dhe jo europiane, si Australia dhe Japonia. Duke iu referuar propozimit, funksionaliteti dhe jo vendndodhja gjeografike, duhet të jetë principi organizativ i politikave të partneritetit dhe anëtarësimit në Aleancë.⁴⁰ Propozimi pati lëkundje sepse

³⁷ Ministria e Mbrojtjes, Revista Strategjia e Mbrojtjes: Një Kapitull i Ri, http://www.mod.uk/NR/rdonlyres/79542E9C-11044AFa-9A4D-8520F35C5C93/0/sdr_a_new_chapter_cm5566_vol1.pdf, aksesuar më 29 janar 2009.

³⁸ Guida Politike e Kuptueshme, 2006, paragrafi 2.

³⁹ Renee de Nevers, “Roli Ndërkombëtar i NATO-s në Epokën terroriste”, *International Security*, Vol.31, Nr.4 (pranverë).

⁴⁰ Flockhart dhe Kristensen, op.cit., fq.12

shumë shtete vazhdojnë ta konsiderojnë NATO-n si një aleancë e mbrojtjes euroatlantike. Idenë nuk e braktisën as SHBA dhe as Mbretëria e Bashkuar, e cila ka gjasa të luajë përsëri një rol në garën e vazhdueshme për të përkufizuar qëllimet e NATO-s.

Në mënyrë interesante, ashtu si vendet baltike edhe vendet e Europës Lindore, të paktën disa nga europianët globalizues mbështesin një koncept strategjie largpamëse, duket se janë të frikësuar nga një shpëputje të SHBA-së nga Europa, p.sh. NATO do të bëhet global jo sepse është gjëja e duhur për t'u bërë, por sepse amerikanët janë duke e kërkuar këtë gjë. Londra e sheh në këtë mënyrë:

Nëse NATO e kufizon veten në një rol rajonal, ajo rrezikon të marxhinalizohet. Gadishmëria e NATO-s për të përmbushur një rol global varet nga mbështetja e vazhdueshme e SHBA-së. Pa ndihmën e SHBA-së, NATO nuk ka të ardhme. Por mbështetja e SHBA-së varet nëse NATO bëhet më tepër e aftë, shpërndan trupat dhe fleksibël, dhe nëse aleatët europianë kontribuojnë më shumë.⁴¹

Me pak fjalë, mosmarrëveshjet rreth pjesës politike të Konceptit Strategjik ka gjasa të bllokohen. Ndërsa mbështetësit e NATO-s global do të bëjnë presion për Detyrat Themelore të Sigurisë që theksojnë kërcënimet globale, risqet dhe partneritetin, ithtarët e një Aleance të ankoruar me një spirancë rajonale do të dëshirojnë të theksojnë soliditetin e mbrojtjes kolektive në kontekstin europian.

2.2 NATO Ushtarake: Përgatitjet për t'u përballur me kërcënimet dhe sfidat e së ardhmes

Pjesa ushtarake e Konceptit Strategjik është duke ecur krahasimisht mirë, dhe arsyeja është e thjeshtë: ndërsa koncepti i Strategjisë në vetvete daton më 1999, udhëheqja ushtarake është freskuar më 2006 me GPK-në. Intervistat në të kalurën treguan se GPK-ja vazhdon të komandojë aleancën brenda

⁴¹ Dhoma e Ulët, Komiteti Mbrojtjes, op.cit., fq.3

organizatës. Si pasojë do të ishte e qartë për NATO-n të përfshijë pjesët rrënjësore të GPK - “implikimet” dhe “direktivat” në Konceptin Strategjik.⁴²

“Implikimet” (e kontekstit strategjik) përbëjnë pjesën e dytë të GPK-së dhe janë fleksible nga një perspektivë politike, por mjaft të rrepta nëse flasim ushtarakisht, e cila është arsyeja përse pjesa e dytë është problematike. Fleksibiliteti politik është i dukshëm në Nenet 5 dhe 6 të GPK-së: Neni i pestë thekson që “mbrojtja kolektive do të jetë qëllimi kryesor i Aleancës”, por më pas shton se sfidat e mbrojtjes kolektive mund të jenë të dyja kontroversiale (të cilat kënaqin kampin rajonal) dhe në mënyrë asimetrike globale (të cilat kënaqin kampin globalist); më vonë shtron thjesht mundësinë që NATO mund të ndërmarrë operacione jo të Nenit V. Rreptësia ushtarake shfaqet në Artikullin e shtatë, ku theksi vihet në ekspeditën e luftimit - si e kundërta e forcave të diplomura që kërkojnë përgatitje më të mëdha përpara shpërndarjes - dhe një qasje civilo-ushtarake gjithëpërfshirëse për menaxhimin e krizave. Ky kombinim i fleksibilitetit politik dhe rreptësisë ushtarake është ai që fiton.

Pjesa e tretë e GPK-së, “Udhërrëfyese për Kapacitetet e Aleancës”, mund të jetë më shumë problematike në dy aspekte. E para shqetëson “nivelin e ambicies së Aleancës” (NeA), e cila është përkufizuar tipikisht si një numër i operacioneve të njëkohëshme (Neni V dhe jo-Neni V) që Alenaca të jetë e aftë të ndërmarrë veprime në rastet më të këqija. Neni 11 i GPK-së përmbledh tërthorazi NeA-t e NATO-s: “Aleanca duhet të ketë aftësinë të lëshojë dhe të mbështesë operacionet madhore të njëkohshme dhe operacione të vogla për mbrojtjen kolektive dhe përgjigjen e krizave në dhe përtej territorit të Aleancës, në periferinë e saj, dhe në distancat strategjike”. E vendosur në mënyrë të ndryshme, GPK-ja na thotë se NATO duhet si minimum të jetë e aftë të mbledhë “2+2”⁴³ (realiteti është se

⁴² Të gjitha referencat në këtë seksion të CPG mund të gjenden në : <http://www.nato.int/docu/basicxt/b061129e.htm>

⁴³ Operacione shumë të vogla dhe shumë të mëdha, ku të mëdha i referohen normalisht Nenit V, edhe pse operacione më të vogla mund të ketë edhe në Nenin V.

që nga 2006-a NATO ka operuar me formulën “2+6”, ku “distanca strategjike” është përkufizuar si 15.000 km nga Brukseli⁴⁴). Ajo ç’ka është e re në këtë kontekst, është përmendja e qartë e NeA-s nga GPK për herë të parë në historinë e Aleancës (historikisht, ministrat e mbrojtjes e përkufizojnë NeA-n në Udhëzuesin Ministror dyvjeçar konfidencial). Një zyrtar kombëtar sugjeroi se NeA do të fitojë rëndësi më të madhe në Konceptin e ri Strategjik, pjesërisht sepse NATO do të imitojë BE-në, ku planifikimi është pothuajse tërësisht i drejtuar nga përcaktimi botërisht i BE-së për NeA (Qëllimi Parësor i Helsinkit i shpërndarjes së 50-60.000 trupave). Një përkushtim i tillë publik nga ana e krerëve të shteteve dhe qeverive do t’i lidhë hapur qeveritarët me ambiciet e tyre të niveleve të larta.

Këtu fillon problemi, sepse tani NATO është duke ndërmarrë operacione të ngjashme me “1+1” (Afganistan dhe Kosovë) dhe kjo është pika e dobësimit. E thënë ndryshe, “2+6” kërkon investime të mëdha në transformimin e forcave dhe një buxhet të madh për operacionet. Më së shumti aleatët europianë, sidomos Gjermania, nuk janë të gatshëm të përkushtohen në këtë axhendë. Një ngurrim i tillë në një çast kthese luan në dorë të ithtarëve të “NATO-s rajonale” sepse kapaciteti i NATO-s globale thjesht nuk mund të jetë aty. Është e mundur që krerët e shteteve dhe të qeverive të vendeve të NATO-s do t’i shmangen NeA-s duke mbajtur drejtimin ushtarak të mjegullt për sferën publike (si në GPK), dhe duke lënë vartësit e tyre - ministrat e mbrojtjes - të merren me specifikat e NeA. Megjithatë, kjo nuk do të fshijë problemin themelor të takimit në sfidën e NeA përtej “1+1”, e cila është një kërkesë për një NATO më globale.

Kjo na çon në çështjen e dytë, e cila shqetëson koherencën e organizimit ushtarak. GPK-ja i tregon organizatës se çfarë duhet të planifikojë. Neni 16 i GPK-së numëron disa kërkesa aftësie: nga ekspedita lufte shumëkombëshe deri në stabilitetin dhe rindërtimin: dhe nga mbrojtja e popullsisë dhe sistemit të informacionit të mbrojtja e forcave në mjedisin e armëve të

⁴⁴ Intervistë në Shtabin e Përgjithshëm të NATO-s, 30 tetor 2008.

shkatërrimit në masë (ASM). Pjesërisht problemi është për arsye se axhenda është shumë e gjerë, por në themel është se ai është i ankoruar vetëm në Bruksel (p.sh.: Stafi Ndërkombëtar dhe Komiteti Ushtarak dhe Stafi Ushtarak Ndërkombëtar i tyre). Pjesa e NATO-s në Bruksel tenton të ngec nga pikëpamjet konfliktuale të mundësive që natyrisht bashkekzistojnë brenda një axhende aq të gjerë si GPK-ja. Kjo situatë është një burim frustrimi për komandën operacionale në Mons, Operacionet e Komanduara të Aleatëve (OKA), e cila është në Afganistan. OKA-ja është natyrisht e përshtatur nga mësimet dhe nevojat operacionale, dhe kur Komandanti Suprem i Aleancës në Europë (KSAEUR) ndien se këto mësimet nuk janë mbajtur parasysht nga organizata në Bruksel, ai ka të drejtën të ndërhyjë direkt me Sekretarin e Përgjithshëm - dhe ai rregullisht e bën këtë gjë. Kështu që rrjedhin një shumësi këshillash ushtarake. Ndërkohë, ACT, komanda e transformimit në Norfolk, është duke planifikuar për forcat e së nesërme, mjetin kryesor të planifikimit që është një skemë e titulluar “E ardhmja e shumëfishtë”. Ne jemi përplasur plotësisht me pikëpamje të “së ardhmes së shumëfishtë” - disave u duket e dobishme, të tjerëve i pavend - por gjithashtu një vlerësim i hapur gjërësisht që ACT është varfërisht e integruar në të gjithë organizatën. Disa prisnin caktimin në fund të viti 2007 të Gjeneralit Xhejms N. Mattis si komandant i ACT që të prodhonte një ndryshim pozitiv në punën e transformimit të komandës. Mattis është gjërësisht i njohur si “njeri dinamik”, dhe pritshmëria në disa shtabe është se produkti i ACT do të jetë i lidhur me operacionet që do të vijnë në vitet në vazhdim. Përmbledhtasi organizimi ushtarak i NATO-s është i ngatërruar nga axhenda e shumëfishtë dhe koordinimi i varfër; OKA është e zënë me funksionimin e operacioneve dhe e paduruar me MC dhe ACT ka qëndruar pezull duke menduar për të ardhmen.

Politikëbërësit mund të bëjnë dy gjëra në këtë situatë: ata mund të shtrëngojnë direktivat që përforcojnë kërkesat ushtarake, të cilat lidhen me seksionin politik të Konceptit Strategjik, dhe ata mund të riformojnë organizatën. Asnjë nga opsionet nuk është i lehtë. Reformat organizative do ta sjellin

ACT-në jashtëzakonisht afër OKA-s dhe do t'i bëjnë këto të dyja forcat drejtuese në një organizatë ku mësimet operative të mësuara u është dhënë një peshë më e madhe dhe vizione informuese të së ardhmes. Në kohë lufte, mësimet nga poshtë-lart duhet t'i prevalojnë planifikimeve nga lart-poshtë. Siç u vu re tashmë, kjo nuk do të jetë e lehtë sepse planifikimi nga lart-poshtë është më mikpritës për politikën e kompromisit që karakterizon aleancat kolektive. Ende, nëse NATO nënkupton biznes sidomos në një botë të globalizuar, botë ku operacionet e sigurisë kërkojnë përdorimin e vërtetë të aftësive operative (si në kundërshti të aftësive operative të përmbajtjes në një kontekst rajonal), atëherë NATO mund të fillojë këtë lloj reforme.

Duke folur nga ana ushtarake, përgjegjësia për të çuar gjërat përpara është në kampin e globalistëve: përfshirja globale kërkon një NeA të përmirësuar *de facto* dhe një aftësi të përmirësuar për të siguruar forcat e duhura për operacione në largësi. Kjo nuk është e gjitha e çuditshme, pasi NATO e nisi si një aleancë për mbrojtje/parandaluese kolektive. Çfarë duhet të kërkojmë në këtë kontekst? NeA dhe mësimet operative të mësuara janë pa dyshim vendet nga ku mund të fillojmë. Debati mbi burimet dhe udhëzimet e burimeve mund të jetë një opsion. GPK-ja del nga rregulli praktik 40/8 - fokusuar në raportin e pozicionimit dhe mbështetjes së forcave në marrëdhënie me tërësinë e strukturës së forcave (të dhënat janë rishikuar nga 50/10 e lart).⁴⁵ Gjithashtu ka gjasa që buxhetet e mbrojtjes, edhe një herë, u bënë një çështje në diplomacinë e NATO-s.⁴⁶ Megjithatë, një udhëzim burimi i tillë në kontekstin tonë të vlerësimit të NATO-s rajonale dhe

⁴⁵ 40% e forcave tokësore duhet të “strukturohet, përgatitet, dhe pajiset për operacione dislokuese”, dhe 80% duhet të “planifikohet për operacione mbështetëse” (Neni 13 i GPK). Këto të ashtuquajtura “qëllime të përdorshmërisë” u krijuan në samitin e Stambollit në qershor 2004.

⁴⁶ Që nga shkurti 2007, sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jaap de Hoop Scheffer tha që “Koncepti i ri Strategjik duhet të konfirmojë një target informal për të gjithë kombet e NATO-s që të harxhojnë 2% të të ardhurave të tyre kombëtare në mbrojtje”; “Shefi i NATO-s thërret për një Koncept t ri Strategjik”, *International Herald Tribune*, 11 shkurt 2007.

globale është i dykuptimshëm; pozicionimi dhe mbështetja përputhen me “NATO-n globale”, por do të kërkohet gjithashtu për më shumë operacione rajonale të Nenit V, si thuhet në parimet e “përdorimit të dyfishtë” (p.sh. Turqi, shtetet baltike ose Norvegji); rritja e buxhetit të mbrojtjes mund të përdoret edhe për NATO-n rajonale edhe për atë globale dhe që ka të bëjë më shumë me ndarjen e përgjegjësive transatlantike. NeA dhe mësimet operacionale të mësuara janë gjithashtu dritarja me e mirë përmes së cilës mund të shikojmë.

Në fund, sigurisht, nëse kampi globalist mund t’i çojë gjërat përpara varet nga çështjet politike. Prandaj është koha për t’u kthyer në diskutimin përmbyllës, atë se ku është drejtuar Aleanca e Atlantikut.

Konkluzion: një NATO globale apo rajonale?

Cili vizion do të triumfojë në betejën diplomatike të muajve të ardhshëm, që do të përcaktojë qëllimin kryesor dhe thelbin e përmbajtjes së Konceptit Strategjik? A do të jetë Aleanca Atlantike duke u përballur me problemet e sigurimit në mbarë botën në vitin 2015, apo NATO do të rikufizohet brenda zonës euroatlantike? Ne parashikojmë se në të ardhmen e afërt dallimet rreth çështjes së detyrave kryesore të Aleancës nuk do të lejojnë një Koncept Strategjik shumë të ndryshëm nga ai aktual. Qëndrimi i paprekur do të jetë Koncepti Strategjik i vitit 1999.

Ndërsa me shumë mundësi, SHBA - e përkrahur, ndër të tjerë, nga Mbretëria e Bashkuar, Danimarka dhe Holanda - do të arrijë disa suksese në presionin për sa më pak përmendje të zonës euroatlantike në Konceptin Strategjik të ardhshëm, duke i dhënë një shtysë idesë së një veprimtarie në mbarë botën, ndryshimet rrënjësore nuk janë shumë të mundshme. Mund të pritët që Uashingtoni të ketë ndikim, për shkak të statusit të tij si garantuesi më i fuqishëm i sigurisë për anëtarët e rinj, por vetëm deri në njëfarë mase. Nëse kampi rajonalist i merr propozimet amerikane një shkelje të parimeve të Artikullit V, ata patjetër do të vendosin veton ndaj tyre.

Administrata Obama do ta ndikojë këtë debat fuqishëm, natyrisht. Presidenti i ri amerikan, jashtëzakonisht popullor në Europë, mund të japë shtysën e nevojshme për të arritur në konsensus për një Koncept Strategjik që sheh një NATO më aktive jashtë kufijve të saj tradicional. Gjithashtu, riafrimi i Francës me NATO-n - dhe shpallja shumë e mundshme e riintegritimit të saj në strukturat ushtarake të Aleancës në Samitin e prillit 2009 - mund të fuqizojë globalizuesit. Duhet shënuar se gjatë vitit të kaluar Franca ka qenë më pak e prirur të pengojë iniciativat e Aleancës që mund të shihen si një afrim me synimet e globalizuesve. Gjithsesi, ne dyshojmë se idetë bazë të Konceptit Strategjik do të ndryshojnë në mënyrë domethënëse.

Në qoftë se, si është parashikuar, aleatët dështojnë në përpjekjen për të kapërcyer distancat që i ndajnë rreth rolit dhe qëllimit të NATO-s, përmbajtjes së Konceptit Strategjik, mund t'i mungojë qartësia dhe vetëm të japë një drejtim strategjik të mjegullt. Ai do të përfshijë një numër kërcënimesh dhe përgjigjesh të mundshme që më së miri mund të përshkruhen si emëruesi më i vogël i përbashkët. “Një problem kyç i Konceptit Strategjik është se ai humbet qartësinë kur aleatet duhet të bien dakord për kaq shumë çështje. Si na tha dhe një zyrtar i NATO-s: “Shumë temave të rëndësishme duhet t’u zvogëlohet rëndësia. Në praktikë, Koncepti Strategjik bëhet një “pazar i gjërave të minimizuara””.

Gjithsesi, përsa i përket planeve afatgjata, NATO, me shumë mundësi, do të vazhdojë rrugën e angazhimeve të globalizuara. Ky parashikim bazohet kryesisht në idenë se një Aleancë Atlantike e kufizuar gjeografikisht në qëllimet e saj, do të ishte pa ndonjë interes të veçantë për Uashingtonin. Kërcënimet e ardhshme për interesat amerikane, mendohet se do ta kenë origjinën jashtë Europës - sidomos në Lindjen e Mesme dhe në Azinë Qendrore - SHBA nuk do të ketë nevojë për aleatë të paaftë ose pa vullnetin për të projektuar një fuqi ushtarake jashtë Europës. Pra, nëse NATO nuk do t’u shërbente më interesave jo europiane të Uashingtonit, megjithëse SHBA mund të qëndrojë në NATO, do ta bëjë këtë pa entuziazëm dhe pa dhënë mbështetjen kyçe që jep tani, pa të cilën aleanca do të dilte e tepërt. Meqenëse frika më e madhe e shumicës së

vendeve të rajonit është mosangazhimi amerikan në Europë, transformimi pritet të vazhdojë.

Ky nuk është një proces i ri. NATO po globalizohet që nga fillimvitet '90 dhe në proces e sipër ka fituar përkushtimin e rinovuar amerikan. Karl-Heinz Kamp vëren se:

Pikëpamja popullore me rënien e Bashkimit Sovjetik Uashingtoni nuk do të kishte më nevojë për Europën si një “aeroplanmbajtëse e pafundosshme” shërbeu për shumë njerëz si një argument për ngritjen e një mbrojtjeje të pavarur europiane. Koha ka treguar se ky vlerësim ka qenë i gabuar. Amerika nuk do të zvogëlojë angazhimin e saj në NATO thjesht sepse Aleanca ndryshon në mënyrë konstante dhe tani ka mbërritur në një formë që Amerika gjithmonë e ka dëshiruar: e përdorshme ushtarakisht në të gjithë botën. Në këtë funksion, NATO shërben si një element kyç në strategjinë globale amerikane: një organizatë e vendeve me qëllime të ngjashme, bazuar në vlera, e aftë për të vepruar politikisht dhe ushtarakisht kur është e nevojshme.

Kampi globalist mund të ankohet se NATO nuk po bën sa duhet për sa i përket operacioneve në shkallë botërore, ose se nuk është shumë i aftë edhe kur ndërmerret të tilla, si projektimi i forcave shpejt dhe larg, ose bashkëpunimi me organizata jo ushtarake për të ndërtuar kombet si Afganistani, por fakti është se kjo NATO - si e përshkroi edhe ish-Sekretari i Përgjithsëm, Lordi Robertson - “nuk është më ajo e para”. NATO po globalizohet, dhe operacionet në Afganistan, Kosovë, në bregun e Somalisë dhe në Mesdhe do ta shtyjnë përpara procesin e transformimit.

Ideja për një NATO rajonale është akoma aty, dhe Rusia ushqen disi idenë se kërcënimet rajonale të stilit të vjetër janë më të rëndësishme se ç'kuptojnë globalizuesit. Më tej, një NATO rajonale mund të marrë një shtysë edhe nga operacioni i parë i NATO-s jashtë teatrit europian, në Afganistan. Vdekja e afërt e NATO-s është një histori e treguar në një numër të pafund versionesh, dhe është sigurisht e mundshme që NATO të mbijetojë edhe në mungesë të një suksesi të plotë: varet nga shkalla e dështimit. Ajo që duket e sigurtë është se dështimi në Hindu-Kush do të përbëjë një goditje serioze për NATO-n.

ANTONIO MISSIROLI

RISHIKIMI I STRATEGJISË EUROPIANE TË SIGURISË: PËRTEJ 2008-s DHE PËRTEJ POLITIKËS SË JASHTME DHE TË SIGURISË SË PËRBASHKËT (PJSP)

Nga lançimi i Strategjisë Europiane të sigurisë në 2003 shumë ndryshime kanë ndërhyrë duke ndërlikuar skenaret europiane. Brishtësia në periferinë më të gjerë të BE-së, politika e forcës në Lindje, paqëndrueshmëria në Jug dhe kompeticioni në rritje për burime në nivel ndërkombëtar, kjo është në linja të përgjithshme kuadri në fillimet e 2008-ës. Duke pasur parasysh ngjarjet që kanë ndodhur në vitet e fundit dhe sfidave të reja që Bashkimi European ka përballë, për çfarë mund dhe duhet të shërbejë rishikimi i Strategjisë Europiane të Sigurisë?

Këshilli European i dhjetorit të 2007-ës edhe pse në mënyrë të papritur “ftoi Përfaqësuesin e lartë për Politikë të Jashtme dhe Sigurisë së Përbashkët (PJSP), në harmoni të plotë me Komisionin dhe në bashkëpunim të ngushtë me vendet anëtare, të analizojë nivelin e realizimit” të strategjisë europiane të sigurisë të adoptuar në 2003, “me objektivin për t’i propozuar Këshillit European të dhjetorit 2008 elementë të dobishëm për përmirësimin e zbatimit, dhe kur është e nevojshme, për plotësimin” (paragrafi 90 i konkluzioneve të Presidencës).

Me fjalë të tjera, pas 4 vjetësh, që prej dhjetorit 2003, tani i kërkohet Javier Solanës të rishikojë Strategjinë Europiane të Sigurisë me qëllim vlerësimin kompleksiv të saj. Konkluzionet e Presidencës nuk përmendin nevojën për një freskim dhe aq më pak të një rishikimi të Strategjisë, theksi vihet i gjithi te realizimi “duke pasur parasysh të gjithë zhvillimet që prej asaj kohe dhe në mënyrë të veçantë eksperiencat e nxjerra nga operacionet”. I gjithë ky veprim ka si qëllim të evidentojë “elementet e përmirësuara” dhe mundësisht “plotësuese” për përmbushjen e plotë të Strategjisë, duke përbërë në këtë mënyrë një mundësi të

shkëlqyer për të bërë një bilanc të një dhjetëvjeçari të Politikës së Sigurisë dhe Mbrojtjes Europiane (PSME).

Një punë e mbarë

Megjithatë, do të jetë e vështirë të evitohet plotësisht rishikimi i kuadrit analitik dhe nenet që përfshihen në të. Madje nuk do të ishte korrekte të bëhej, edhe pse SES-i është një dokument politik që u ka rezistuar në mënyrë të pazakontë provave të kohës. Lançuar në fillim të majit 2003, në ditët e fundit të luftës në Irak, si një përpjekje për të kapërcyer hendeqet e krijuara si brenda Bashkimit Europian ashtu dhe në anën tjetër të Atlantikut, pas ndarjeve të ashpra të muajve të mëparshëm, Strategjia u transformua në një bazë për të ndërtuar konsensusin në Unionin e zgjeruar.

Hartimi u përfundua në dy faza: një draft i parë u propozua nga Solana në qershor 2003 në Këshillin Europian, i cili e mori parasysh dhe i kërkoi Përfaqësuesit të Lartë, së pari për të zgjeruar debatin, nëpërmjet një numër debatesh të organizuara nga Instituti për Studime të Sigurisë të BE-së (një agjenci e pavarur me qendër në Paris) dhe për të arritur në një tekst final. Ky i fundit, i adoptuar dhe përmirësuar në versionin fillestar, u aprovua në dhjetor 2003 me titullin “Një Europë e sigurt në një botë më të mirë”.

Mund të pohohet se SES-i është një nga dokumentet politike të BE-së më të mira që janë redaktuar (ndoshta përkrah Deklaratës së Laeken të dhjetorit 2001): i përmbledhur, por i plotë, konciz, por jo sipërfaqësor, jo tepër mbivlerësues dhe jo i mbështetur mbi një minimum emërtimi të përbashkët. Ky dokument u përgatit nga një grup ekspertësh pranë Solanës, duke marrë në konsideratë vërejtjet e bëra nga Ministritë e Punëve të Jashtme të njëzet e pesë vendeve anëtare të atëhershme, si dhe të ekspertëve të përfshirë në debat, por nuk iu nënshtrua asnjëherë Komitetit të Përfaqësuesve Permanentë (Coreper), ose Komitetit Politik dhe të Sigurisë (KPS)Ë me fjalë të tjera, SES nuk është “negociuar asnjëherë” nëpërmjet kanaleve diplomatike ndërqeveritare.

Përveç kësaj, pas aprovimit të Strategjisë, Solana ka paraqitur rezistencë të vendosur ndaj thirrjeve për ta përkthyer në një sërë veprimesh për t'i vënë në veprim për të ardhmen: në vizionin e tij SES-i duhej të mbetej një bashkësi udhëzimesh për veprime të mundshme, por jo një dokument operativ i llojit normativ/urdhërues. Për njëfarë periudhe, sidomos me firmën e Traktatit të Kushtetutës në tetor 2004, Strategjia u përmend me raste dhe në Veprimet e përbashkëta të PJSP-së si një lloj baze ligjore “soft” për lançimin e operacioneve të PJSP-së, qëllimi i të cilit shkonte përtej misionit fillestar të Petersburg të përfshira në nenin 18 të Traktatit.

Megjithatë, SES-i nuk ka të bëjë vetëm me politikën e Sigurisë dhe Mbrojtjes. Në njëfarë kuptimi, nuk është as një strategji – term që shpeshherë abuzohet në praktikë dhe në fjalorin e BE-së – pasi është bërë një gjë shumë e afërt me doktrinën europiane për politikën e jashtme dhe të sigurisë, që jo vetëm i jep formën qasjes së Unionit rreth një sërë ngjarjesh të ndryshme, por është edhe një instrument efikas i diplomacisë publike. Si doktrinë, përveç kësaj, ka ruajtur pothuajse të gjithë aktualitetin e saj.

Pesë vite më pas

Në fakt, nëse sot përfshirja e SES mund të tingëllojë e tejkaluar, “kërcënimet kryesore” dhe “sfidat globale” të identifikuara në 2003 nuk kanë pësuar ndryshime të rëndësishme, por vetëm një zhvendosje ku vihet theksi. Për sa i përket terrorizmit global, për shembull SES-i ka qenë parashikues duke afirmuar që kërcënimi ishte prezent në territorin europian (Europa është një objektiv dhe një bazë, njëkohësisht). Që prej asaj kohe, sidomos pas atentateve të Madridit (2004) dhe Londrës (2007), jemi të gjithë më të ndërgjegjshëm se terrorizmi i rritur në shtëpitë tona është një fenomen europian, që kërkon përgjigje specifike, përfshirë këtu dhe kërkimi për një ekuilibër të pranueshëm dhe të qëndrueshëm midis sigurisë dhe lirisë, si në nivel personal ashtu dhe kolektiv.

Lufta kundër përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë është më pak e përqendruar te Koreja e Veriut (dhe akoma më pak tek Iraku) dhe më tepër mbi programin nuklear iranian dhe efektin domino që kjo mund të shkaktojë në nivel rajonal. Dhe ndërkohë që rreziku i *armëve bërthamore jashtë kontrollit* duket më pak prezent, mundësia e një bombe “shkatërruese” e ngarkuar me armë të shkatërrimit në masë më të lehta dhe “të lëvizshme” nuk është zhdukur plotësisht.

Konflikte të reja e të vjetra rajonale janë shumë të dukshme në ekranet e radarëve që nga Ballkani deri në Lindjen e Mesme, dhe po aq janë ata të ngrirë në brendësi të Europës dhe në kufijtë e saj. Madje dhe konflikte që më parë kishin karakter të brendshëm tani rrezikojnë të zgjerohen në zonat përreth, që nga Afganistani deri në Darfur, në Afrikë.

Sot ka një tendencë për të folur më tepër për dështime të shteteve dhe të brishtësisë së tyre, një kusht pak a shumë i përbashkët në skenën ndërkombëtare dhe që përsëritet, i cili lejon, madje kërkon – ndryshe nga falimentimi që është i rrallë për dhe shpesh i pakthyer – “një impenjim parandalues” korrekt dhe konstruktiv, ashtu si urohet dhe nga SES-i. Në fakt identifikohen lehtësisht shtetet e brishta, si brenda kontinentit tonë ashtu dhe në zona të ndjeshme ku vihen në lojë interesat europiane dhe globale.

Sipas të dhënave të Eurobarometrit, krimi i organizuar sot indikohet nga një e treta e qytetarëve europianë si prioriteti numër një politik dhe i sigurisë dhe prezenca e tij perceptohet si në një sërë aktivitete të lidhura me funksionimin normal të shoqërive tona, nga ato bankare dhe financiare në shërbim të publikut.

Gjithashtu, vartësia e plotë energjetike e Europës është rritur shumë si në terma të perceptimit ashtu dhe në terma realë, gjë që vihet më në dukje dhe për shkak të krizave rajonale në të njëjtin kontinent dhe nga rritja dramatike e çmimit të gazit në nivel botëror. Siguria energjetike, me fjalë të tjera është kthyer në një nga problemet kryesore që do të kushtëzojë në mënyrë të rëndësishme politikën tona të jashtme dhe në vitet që do të vijnë.

Në një botë gjithmonë e më të globalizuar, sfida europiane demografike po bëhet çdo ditë e më serioze dhe perceptohet

gjithmonë e më shumë, duke stimuluar në këtë mënyrë kërkesën për një menaxhim të përbashkët të flukseve migratore dhe të një integrimi më të mirë të emigrantëve.

Edhe frika e lidhur me klimën është materializuar me shpeshtësi më të madhe, për shkak të fenomeneve të ndryshme si përmbytjet, thatësira, zjarret. Në perspektivë ndryshimet klimatike dhe ngrohja globale mund të ashpërsojnë konkurrencën për burimet natyrore dhe energjetike (përfshirë rezervat e pakta akoma të pashfrytëzuara), varfërim të rezervave të peshkut dhe të ushqimit, e mbi të gjitha destabilizojnë rajone të brishta dhe vende kurrë të qeverisura, duke prodhuar konflikte dhe tensione të reja, duke forcuar fluksin migrator dhe duke kushtëzuar në përgjithësi marrëdhëniet ndërkombëtare. Kohët e fundit kanë lindur dhe motive të tjera alarmi, si SARS dhe gripi i pulave, Tsunami i dhjetorit 2004 në Azi, sulmet telepatike të Hacker dhe kriza financiare e provokuar nga spekulatorët. Me fjalë të tjera, në horizont po shfaqen gjithmonë e më shumë kriza, të shkaktuara nga natyra ose nga njeriu, shpesh të provokuara dhe të përhapura përtej kufijve kombëtarë dhe europianë.

Vështirësi të vjetra dhe të reja

Objektivat strategjike të përcaktuar në 2003-in mbeten të vlefshme, por sot jemi më të ndërgjegjshëm për vështirësitë që duhen përballur dhe kapërcyer për t'i arritur. Edhe pse nuk është një sfidë për Unionin formalisht ose në radhë të parë, Afganistani po tregohet gjithmonë e më i vështirë për t'u menaxhuar, jo vetëm në terma ushtarake. Ta përcaktosh si sukses çfarë është arritur në Kabul është detyrë e vështirë. Përjasja *quick in quick out* që ka karakterizuar fillimisht operacionet ushtarake në vend, është më e vlefshme; duhet të përgatitemi të gjithë në terma afatgjatë, por është një qasje që nuk gëzon popullaritet të madh në opinion publik dhe që nuk është i qëndrueshëm pasi ka burime të kufizuara. Një *exit strategy* është më e vështirë për t'u imagjinuar, nga momenti që "gjendja finale" që është si objektiv, është gjithmonë e më i shpejtë.

“Ndërtimi i sigurisë në vendet e afërta” është një objektivi akoma për t’u arritur. Në Ballkan, për shembull, prania soft (ose transformuese) e Unionit nuk po tregohet aq efektive si po tregohet në kontekste të tjera. Kjo i detyrohet pjesërisht dyshimeve të ngritura nga vetë Unioni mbi procesin e zgjerimit, që ka dobësuar dorën europiane në menaxhimin e marrëdhënieve me vendet e rajonit. Politika e “kushtëzimit” përkundrejt tyre nuk funksionon nëse nuk i shoqërohet një impenjim i besueshëm për një integrim të shpejtë në BE. Në të njëjtën kohë, politika e kushtëzimit, si e kemi njohur, duhet rishikuar duke pasur parasysh dhe sfidat e veçanta që duhen përballur herë pas here – nëse bëhet fjalë si për Ballkanin ashtu dhe për Turqinë.

Përveç kësaj, nënshtrimi ndaj Rusisë e ka bërë akoma më problematike përballjen e konflikteve “të ngrira”, ndërkohë që konfliktet e Mesdheut të Unionit – në kuadrin e Procesit të Barcelonës ose të politikës europiane të fqinjësisë – duket kanë ardhur në një pikë kritike ose zhvillohen shumë ngadalë.

Brishtësia në periferinë më të gjerë të BE-së, politikat e forcës në Lindje, paqëndrueshmëria në Jug dhe konkurrenca në rritje për burime në nivel botëror, ky është kuadri kryesor europian i sigurisë në fillimet e 2008-ës, të cilës i duhet shtuar ndërlidhshmëria në rritje midis dimensionit ndërkombëtar dhe atij të brendshëm të sigurisë, që e bën këtë sferë intermestike.

Së fundmi, por sigurisht jo për shkak të rëndësisë, “multilateralizmi efikas” i propozuar nga SES-i po tregohet gjithmonë e më shumë një sfidë e vërtetë, pjesërisht sepse shihet në të njëjtën kohë si parim, si mjet dhe si qëllim në vetvete. Unioni ka dhënë një provë të mirë për veten me rastin e krizës në Libanin e Jugut, në verën e 2006-ës, por rasti i Kosovës duket i vështirë në kontekstin aktual, pasi efikasiteti dhe multilateralizmi duken të vështirë për t’u përputhur midis tyre (edhe pse për arsye që nuk varen nga BE-ja). Dilema të ngjashme përfaqëson edhe aksioni në Darfur. Gjithashtu, edhe pse në fusha të ndryshme, negociatat e Dohas u bllokuan dhe rrjeti i tregtisë multilaterale duket gjithmonë e më i tensionuar.

Kjo nuk do të thotë që një multilateralizëm efikas është i pazbatueshëm ose më keq, që është i gabuar në vetvete. Në të

kundërt, për BE-në, në fakt përfaqëson sa një nevojë aq dhe një zgjidhje. Megjithatë, pas 2003, ambienti ndërkombëtar, është më kompleks, me një numër superior aktorësh kyç (të vjetër dhe të rinj), të cilët duhen mbajtur parasysh, dhe të gjithë të orientuar në mbrojtje të sovranitetit dhe të përqendruar në objektiva në terma afatshkurtër. Ndërvarësia-konkurrenca që rezulton, e lë BE-në në një pozicion delikat, përmbushja e rezultateve bëhet gjithmonë e më e vështirë, edhe kur objektivat janë absolutisht të arsyeshëm dhe realistë, edhe kur Unioni dhe SHBA janë dakord mes tyre, gjë që nuk ishte aspak e sigurt në 2003.

Kjo i jep shpjegim faktit se pse është e nevojshme të artikulohet mirë lidhja midis kërkimit të një multilateralizmi efikas dhe bashkëpunimit me partnerë të mundshëm strategjikë. SES-i në pjesën e saj që mund ta quajmë më pak solide, përmendte Japoninë, Kinën, Kanadanë dhe Indinë, një listë që edhe pse e nevojshme kërkon disa rregullime.

Në realitet Unioni dhe/ose vendet e tij kryesore marrin pjesë aktivisht në forume të ndryshme “mini-laterale” të lidhur me situata të caktuara krize, që prej G8 deri te Grupi i kontaktit për Ballkanin, që nga kuarteti për Lindjen e Mesme te 5+1 për Iranin. Disa prej këtyre partnerëve strategjikë kanë më tepër rëndësi në disa kriza, ndërkohë që shtimi eventual i aktorëve të tjerë varet nga fusha ose problemi në diskutim. Ndoshta, duhet të kuptohet si mund të përkthehet në mënyrë më të qartë dhe koherente “puna me partnerë” si është përcaktuar nga SES-i, në një instrument për të pasur zgjidhje multilaterale efikase dhe për t’i dhënë Unionit si i tillë vizibilitet dhe peshën e nevojshme.

Mundësi dhe Sfida

Ndërlikimet politike të SES mbeten të vlefshme mbi të gjitha sepse janë parë në terma kualitativë, pa afate apo parametra vlerësimi tepër të ngushtë.

Bashkimi Europian është bërë pa dyshim shumë aktiv në skenën ndërkombëtare në përgjithësi dhe në veçanti në

menaxhimin e krizave: ajo që në fund të vitit 2003 ishte vetëm një fillim premtues, u konkretizua në iniciativa diplomatike të çdo lloji e sidomos në misione jashtë gjithmonë më të shpeshta dhe të shumta në numër. Nëse disa prej tyre kanë pasur një karakter simbolik dhe kanë qenë (në mënyrë të kuptueshme) një mjet për të ngulur flamurin e BE-së dhe për të ndërtuar një acquis të parë operativ, më të fundit – si misioni civil në Kosovë, në masë më të vogël ajo ushtarake në Chad – duken që i përkasin një kategorie tjetër.

Disa vite më parë Lawrence Freedman deklaroi një ndryshim të njohur midis “luftërave për nevojë” tipike të Perëndimit të shekullit të njëzetë dhe “luftërave për zgjedhje” që duket që karakterizojnë epokën e mëpasshme të Luftës së Ftohtë dhe revolucionit në çështjet strategjike, atëherë në fillime. Politika e Sigurisë dhe Mbrojtjes së BE-së dhe në përgjithësi forcat europiane duket që largohen nga karakteri fillestar i operacioneve për nevojë, në teatro të ndryshëm dhe në forma të ndryshme. Por kjo ngre dhe pikëpyetje për sa përket qëndrueshmërisë në terma afatmesme dhe afatgjata.

BE-ja po bëhet dhe më koherente në drejtimin e politikës së saj të jashtme. Përveç ndonjë zënke të vogël (në fazën përgatitore të misionit në Aceh, në Indonezi në 2005 ose në konfliktin legal të armëve të lehta), Këshilli dhe Komisioni duket sikur kanë gjetur një *modus vivendi* (bashkëjetesë) dhe *operandi* (veprim) të pranueshme sidomos brenda Komitetit për Politikën dhe Sigurinë (KPS). Intuita themelore që ndodhet mbas SES d.m.th. ideja se menaxhimi i krizave duhet të jetë e integruar dhe globale dhe jo e bazuar ekskluzivisht ose përgjithësisht në dimensionin ushtarak dhe në përdorimin e forcës, është forcuar nga eksperiencia e viteve të fundit.

Nga ana tjetër Traktati i Lisbonës krijon një arkitekturë të re për hartimin e politikës së jashtme, nga ku pritej koherencë më e madhe dhe efikasitet më i madh si në Bruksel ashtu dhe jashtë Unionit, kryesisht me anë të krijimit të një “harku” midis shtyllave ekzistuese të BE-së – emërimin e një përfaqësuesi të lartë për çështjet e jashtme dhe politikën e sigurisë, që do të mbulonte rolin e përmbushur nga Solana deri më tani, si dhe të atij të një Zv. Presidenti të Komisionit

për marrëdhëniet me Jashtë dhe të mbështetur nga një shërbim i posaçëm european për veprim të jashtëm – dhe afirmimin e një qasje më të integruar të sigurisë. Implementimi i Traktatit, gjithsesi mund të kërkojë kohë dhe të ketë nevojë për një nivel të lartë bashkëpunimi ndërinstitucional për të pasur efektet e dëshiruara.

Megjithatë koherenca nuk varet dhe nuk do të varet nga Brukseli. Edhe sjellja e vendeve anëtare duhet të mbahet parasysh për shembull kur shesin pajisje ushtarake në disa vende. E njëjta gjë vlen edhe për aktorë të tjerë ndërkombëtarë – partnerë dhe organizata – të përfshirë përkrah Bashkimit European në menaxhimin e krizave.

Politika e Sigurisë dhe Mbrojtjes midis Thellimit dhe Zgjerimit

Nëse Bashkimi European është bërë edhe më i zoti – për të përmbyllur ekzaminimin e tre domosdoshmërive të vendosura nga SES-i – mbetet një çështje e hapur. Kapacitetet institucionale janë përmirësuar nëse krahasohen me 2003, e njëjta gjë mund të thuhet për ato operative; shumë mësimë janë nxjerrë dhe u janë aplikuar situatave të reja, një numër në rritje shtetesh anëtare duken më të disponueshëm sesa në të kaluarën, por dhe më të aftë për të përdorur aftësitë e veta në operacione të përbashkëta. Megjithatë, kapacitetet e BE-së janë rritur pak dhe disa vende po prekin pika kritike për sa i përket impenjimeve jashtë vendit dhe *overstretch* ushtarak.

Disponueshmëria për të përdorur forcën në operacione paqeruajtëse mbetet akoma e pabarabartë midis vendeve të Unionit. Kjo mund të sjellë një sistem me dy nivele dhe me shpejtësi që në vetvete mund të ngrejë pikëpyetje për sa i përket solidaritetit të brendshëm dhe ndarjes së detyrave. Në vetvete, kjo ka gjasa që të mos i minojë në bazë politikat e përbashkëta (NATO ka bashkëjetuar mirë në kushte të tilla për disa vjet) nëse merren masat e nevojshme në aspektin e vendimmarrjes dhe për sa i përket financimeve. Brenda Unionit, me fjalë të tjera, një solidaritet më i madh, dhe jo vetëm sepse është e parashikuar nga një nen i Traktatit të Lisbonës.

Në përgjithësi, mund të afirmohet se që nga 2003 PESM është zgjeruar, për sa i përket anëtarëve (çdo zgjerim sjell me vete interesa të reja dhe pozicione), funksioneve (përtej misionëve të Petersburg) dhe me rreze gjeografike (përtej zonës europiane). Gjithashtu është thelluar dhe e ka bërë si nga ana e doktrinave (SES-i) ashtu dhe institucionale (Traktati i Lisbonës). Nga ana tjetër është “ashpërsuar” duke filluar që nga menaxhimi i çështjeve në lidhje me mos përhapjen e terrorizmit.

Vlerësimi i kapaciteteve europiane do të thotë të përballësh mbi cilat dhe sa janë të nevojshme dhe për çfarë qëllimesh, mbi këtë pikë opinionet ndryshojnë në mënyrë të ndjeshme. Pritshmëritë dhe ambiciet tentojnë të jenë ose tepër të larta ose thjesht të ndryshme, duke e bërë thjesht të pamundur për t’i mbajtur të gjitha dhe më të vështirë planifikimin e forcave.

PESM është dhe do të mbetet vetëm njëra prej opsioneve të mundshme në dispozicion të vendeve europiane për menaxhimin e krizave ndërkombëtare. Për disa lloj operacionesh, NATO do të luajë me shumë gjasa një rol qendror, për të tjera mund të jetë e nevojshme autorizimi nga Kombet e Bashkuara (si në rastin e Libanit). Edhe operacione të përziera të përkohshme janë të konceptueshme si në rastin e Bosnjës, Kosovës dhe Republikës Demokratike të Kongos, ndërkohë që “koalicionet e vullnetarëve” do të vazhdojnë të përfaqësojnë një zgjedhje tjetër nga menyuja. PESM vetëm duket e pamjaftueshme për të përballur kërcënimet si terrorizmi dhe krimi i organizuar. Për këtë qëllim një burim themelor mund të jetë përdorimi i burimeve instrumenteve të reja në fushën e drejtësisë dhe çështjeve të brendshme, por që do të sjellë një koherencë më të madhe midis të tre shtyllave dhe politikave të BE-së.

Nga ana ngushtësisht ushtarake, dispozitat e traktatit mbi bashkëpunimin struktural permanent ofrojnë mundësi për të mos u humbur për të kapërcyer diferencat e sapopërmendura dhe për të vënë objektiva të përbashkëta dhe të arritshme. Ajo që mbetet akoma për t’u përcaktuar është se deri në çfarë pike pjesëmarrja në këtë skemë do të varet nga vullneti politik dhe/ose aftësitë operative. Kriteret e renditura në Protokollin në

lidhje me Traktatin e Lisbonës përfshijnë në fakt: a) arritjen e një kapaciteti të fortë mobilizimi dhe shpërndarje të trupave, nëpërmjet kontributit të forcave me karakter kombëtar ose cilët komponentë të forcave shumëkombëshe, dhe nëpërmjet bashkimit dhe/ose të mjeteve të strukturave të mbrojtjes; b) pjesëmarrjen “në programet kryesore të përbashkëta europiane në lidhje me aparatura” dhe të atyre të menaxhuara nga Agjencia Europiane e mbrojtjes; c) një bashkëpunim më i madh në përputhje me objektivat për të cilët është rënë dakord “niveli i shpenzimeve për investime në lidhje me pajisje/aparatura”.

Të paraqitura në këtë mënyrë, nenet lënë shumë hapësirë për interpretim, nuk ka as shifra, as afate dhe as një hierarki pak a shumë të qartë. Prandaj shumë gjëra do të varen nga mënyra se si do të formulohen dhe zhvillohen. Niveli i përfshirjes – i bazuar në një kombinim vlerësimesh funksionale të qarta (por jo të shprehura në mënyrë sasiore) dhe nxitës politikë të qartë – që do të përcaktojë edhe artikulumin efektiv dhe qëllimin final të të gjithë projektit. Do të jetë thelbësore identifikimi i kriterëve më të përshtatshme për të arritur qëllimet e dëshiruara dhe nga kjo pikëpamje, thjesht përcaktimi i një target-i të përgjithshëm të shpenzimeve publike për mbrojtjen (2% e GDP, për shembull) duket në të njëjtën kohë pak e nevojshme dhe jo realiste. Shpenzimet për investime dhe për operacione paqeje – mbi të gjitha nëse janë të përbashkëta – duken më me vend mundësisht të shoqëruara me mekanizma të mundshëm kompensimi në ndarjen e përgjegjësiave.

Në planin civil dhe diplomatik, për momentin gjërat janë shumë më pak të qarta. Edhe pse për BE-në dedikimi në mënyrë të përbashkët më tepër burime (politike, njerëzore dhe financiare) marrëdhëniet me botën e jashtme duhet të bëhet një prioritet absolut, duke parë rëndësinë gjithmonë e më të pakët që kontinenti ynë rrezikon të ketë pas dhjetë ose njëzet vjetësh. Atëherë, BE-ja nuk do të jetë në gjendje t'i lejojë vetes të bëjë një analizë të vetvetes dhe/ose të shpenzojë 2/3 e buxhetit të përbashkët për politika të posaçërisht të brendshme (duke filluar që nga agrikultura), meqë pesha e tij përkundrejt botës – në lidhje me popullsinë, kuotat tregtare dhe prodhimin

e brendshëm bruto – do të jetë një fraksion i atij aktual. Për Europën, mundësia e vetme strategjike mbështetet në prezencën më të gjerë dhe efikase globale. Edhe elementët e mundshëm plotësues të PESM që Solana u thirr për të propozuar duhet të kenë parasysh një perspektivë të tillë.

Dhjetor 2008 e në vazhdim

Nën dritën e këtyre refleksioneve, për çfarë mund dhe duhet të shërbejë rishikimi i SES-it i parashikuar në fund të 2008-ës?

Raporti i Solanës do të konsistojë thellësisht me dhjetëvjetorin e Deklaratës së Saint-Malo (3-4 dhjetor 1998), me të cilën Franca dhe Mbretëria e Bashkuar lançuan atë që më pas u quajt PESM. Në atë datë, urohet që Nicolas Sarkozy dhe Gordon Brown do të ndihen të gatshëm për të ndjekur gjurmët e paraardhësve dhe për t'i dhënë një lançim të ri ambicieve europiane në lidhje me menaxhimin e krizave.

Nëse ka pak dyshime mbi vullnetin e Parisit – Franca mund të përdor këtë rast për të shpallur riintegrimin në strukturat ushtarake të Aleancës Atlantike, duke sheshuar një herë e përgjithmonë frikën dhe dyshimet e kujt (nga brenda ashtu si dhe nga jashtë BE-së) sheh te PESM një faktor të fuqishëm destabiliteti dhe për NATO-n – qëndrimi i Londrës duket akoma i paqartë. Vështirësitë aktuale të Ministrisë të Parë dhe të Partisë Laburiste, nga ana tjetër mund të luajnë nga të dyja kuptimet, në një drejtim të një tjetër ndryshimi politik të periudhës së Blair ose më qartë (me përmbushjen e ratifikimit parlamentar të Traktatit të Lisbonës) në një lançim të pjesshëm të mbrojtjes europiane në kontekstin transatlantik dhe ndoshta global, që do të lejonte Mbretërinë e Bashkuar të prezantohej përsëri me një rol lidhës në të paktën një prej politikave të përbashkëta europiane. Sidoqoftë është e parashikueshme që e ardhmja e PESM do të përcaktohet në të ardhmen nga evolucioni i qëndrimit të Londrës, parë dhe nga perspektiva gjithmonë e më realiste në një kthim të afërt të konservatorëve në pushtet.

Përveç kësaj, dhjetëvjetori i Saint-Malo dhe Raporti i Solanës koincidojnë pikërisht midis zgjedhjeve presidenciale amerikane dhe inaugurimit të administratës së re amerikane. Nuk mund të ketë moment më të mirë për të dërguar përtej Atlantikut disa mesazhe politike të qarta, me qëllim formësimin e ri të marrëdhënieve Europë dhe Shtete të Bashkuara mbi baza të reja mbas periudhës së vështirë të Bushit. Në këtë moment është e vështirë të cilat orientime do të mbizotërojnë me përballjen në Uashington, por nuk ka dyshim që amerikanët tani e dinë që mund t'ia dalin vetëm, por dhe që nuk janë në gjendje të veprojnë vetëm.

Rishikimi i SES-it mund të zhvillohet paralelisht ose gjithsesi të paraprijë rishikimin e Konceptit Strategjik të NATO-s. Ajo aktuale i referohet madje asaj të marsit 1999, d.m.th. para Irakut, para 11 Shtatorit dhe madje para luftës në Kosovë. Nëse Aleanca do të vendoste për një rishikim të Strategjisë së përgjithshme – ndoshta me rastin e gjashtëdhjetëvjetorit – do të ishte e dobishme që në njëfarë mënyre këtë veprim me atë të BE-së, me kusht ama që asnjëra prej organizatave të pretendojë primatin mbi tjetrën.

Së fundmi, por jo për nga rëndësia, Raporti i Solanës do të paraprijë me pak ditë hyrjen në fuqi të Traktatit të Lisbonës. Megjithatë mund të përfaqësojë fillimin sesa fundin e një rishikimi të objektivave dhe të mjeteve të politikës së jashtme në kompleksin e saj, duke u shtrirë në 2009 në nenet e Traktatit.

Në këtë rast, mund të përbëjë një bazë të mirë për udhëheqjen europiane që do të zgjidhet në 2009. Një raund i mundshëm i dytë për rishikimin e SES-it mund të përfshijë në mënyrë më të drejtpërdrejtë shërbimet e Komisionit që kanë rëndësi thelbësore si për politikën e jashtme në përgjithësi – përfshirë degëzimet e ndryshme të jashtme të politikave të përbashkëta – si për një politikë të sigurisë më të integruar, përfshirë dhe dimensionin e brendshëm. Raporti final me shumë gjasa i tetorit 2009, mund të bëhet një detyrë e rregullt e fundit të mandatit për përfaqësuesin e Lartë dhe për Zv. Presidentin e Komisionit, për t'u përsëritur edhe në 2014.

Në përfundim, rishikimi i SES-it mund të çojë në një freskim të analizës dhe një përshtatje të objektivave, të cilëve

mund t'i shtohen elementë plotësues për implementimin ardhshëm të PESM (që Traktati i Lisbonës e riemërton PPSM, Politika e Përbashkët e Sigurisë dhe Mbrojtjes, duke nënvizuar dimensionin e përbashkët). Titulli mund të korrigjohet në mënyrë të dobishme në “Një Europë më e fortë në një botë më të mirë”, duke theksuar nevojën për një qasje më pak në mbrojtje dhe të bëjë analizë të vetvetes. Si kanë nënkuptuar edhe në vitet e fundit edhe ato vende anëtare më shumë të lidhura me “sovrانيتetin” duke filluar që nga Franca dhe Mbretëria e Bashkuar. Jemi të gjithë më të dobët kur veprojmë vetëm dhe akoma më të dobët kur veprojmë të ndarë. Pra, *Bashkimi bën fuqinë*.

Thënë kjo, lidhjes midis vlera dhe interesave të përbashkëta duhet t'i dedikohet një vëmendje më e madhe. Shumë shpesh paraqiten dhe artikulojnë në mënyrë jo koherente, dhe jo vetëm midis nivelit evropian dhe atij kombëtar. Vlerat tona të përbashkëta duhet të ndërthuren me interesat e përbashkëta, vlerat duhet të jenë udhëheqëse për përndjekjen e interesave, por pa i zëvendësuar, ndërkohë që interesat duhet të kontribuojnë për afirmimin e këtyre vlerave.

Për të njëjtën arsye duhen adaptuar më mirë proceset e arritjes së rezultateve, sesa të shihen si qëllim në vetvete që kanë të bëjnë me nivelin evropian, transatlantik, multilateral ose minilateral, duhet të sjellin në rezultate të prekshme dhe të matshme brenda një kufiri kohor të arsyeshëm.

Më në fund, rritja e prezencës së BE-së në botë duhet të përkthehet në mënyrë më të dukshme në po aq pushtet, gjë që jo gjithmonë ka ndodhur. Kjo gjë kërkohet nga bota e nesërme, por dhe nga Europa e sotme.

Antonio Missiroli është Drejtor i Qendrës Europiane të Politikave në Bruksel

ELIRA HRONI

KARTA E ADRIATIKUT -
NJË MODEL ZHVILLUES DHE NDIKUES NË
BALLKANIN PERËNDIMOR

Background-i i Kartës së Adriatikut dhe
domethënia e tij ndër iniciativa të tjera të
bashkëpunimit rajonal

Qysh nga përfundimi i Luftës së Ftohtë dhe sidomos që pas përfundimit të konflikteve të dekadës së kaluar, vendet e Ballkanit Perëndimor në disa iniciativa tematike, sektoriale ose territoriale rajonale si CEI-Central European Initiative, CEFTA - Central European Free Trade Area, BSEC - Organization for Black Sea Economic Cooperation, SEECP - Cooperation process in South Eastern Europe, SAP - Stabilization and Association Process, SECI - South East Europe Cooperative Initiative, SP - Stability Pact in South Eastern Europe. AII-Adriatic-Ionian Initiative, DCP - Danube Cooperation Process etc¹.

Përpyjekja e parë serioze e komunitetit transatlantik për promovimin e një strategjie afatgjatë të rindërtimit dhe parandalimit të konflikteve ishte iniciativa e Paktit të Stabilitetit. Në dokumentin themelues, më shumë se 40 shtete dhe organizata morën përsipër të ndihmojnë vendet e Europës Juglindore të “sigurojnë paqe, demokraci, respektimin e të drejtave të njeriut dhe prosperitet ekonomik në mënyrë që të arrijnë stabilitet në të gjithë rajonin”². Më 30 korrik 1999, në

¹ Regional Initiatives in South Eastern Europe 2002

<http://www.emins.org/english/public/books/reg-init-see.htm#toc>,

² Stability Pact for South Eastern Europe <http://www.stabilitypact.org/about/default.asp>

takimin e samitit, i cili lançoi këtë iniciativë, të gjitha vendeve të rajonit iu premtua integrimi Euro-Atlantik. Që prej asaj periudhe, Pakti i Stabilitetit ka qenë një strehë që përfshinte çdo përpjekje për të ndihmuar rajonin në stabilizimin demokratik, bashkëpunimin dhe integrimin rajonal dhe ka shërbyer si një platformë inkurajuese për çdo lloj tjetër iniciative. Shndërrimi i tij në Këshillin e Bashkëpunimit Rajonal në 2008 ishte në thelb i motivuar nga nevoja e dukshme dhe mësimet e nxjerra me qëllim rritjen e pronësisë rajonale të bashkëpunimit mes vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Karta e Adriatikut³, ose ndryshe A3, ishte një iniciativë në shpirtin e Paktit Amerikano- Baltik të vitit 1998, i cili iu propozua Presidentit të Shteteve të Bashkuara gjatë punimeve të samitit të NATO-s në Pragë në nëntor të vitit 2002, nga Presidentët e Shqipërisë, Kroacisë dhe Maqedonisë njëherësh. Më 2 maj 2003, Sekretari Amerikan i Shtetit, Colin Powell dhe kolegët e tij nga Shqipëria, Kroacia dhe Maqedonia nënshkruan në Tiranë Memorandumin e Kartës së Adriatikut,⁴ i cili e projektonte qartësisht rrugën që këto vende kanë përpara për të arritur të anëtarësohen në NATO.

Ndër të tjera, Karta shpreh:

- Përkushtimin e këtyre vendeve në performancën e përbashkët ose individuale për të intensifikuar reformat që rrisin sigurinë, prosperitetin dhe stabilitetin e rajonit.
- Synimin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës për të ndihmuar shtetet në zbatimin e reformave të nevojshme, duke theksuar që çdo shtet aspirues do të gjykohej individualisht në progresin e tij drejt arritjes së standardeve për anëtarësimin në NATO.
- Përkushtimin e palëve nënshkruese: përkushtim i përbashkët politik për forcimin e institucioneve demokratike, shoqërisë civile, sundimit të ligjit, ekonomisë së tregut dhe luftës kundër korrupsionit dhe krimit.

³ Sekretari i shtetit Amerikan Colin Powell, bashkë me kolegët e tij nga Shqipëria, Kroacia dhe Maqedonia nënshkruan Kartën e Adriatikut në Tiranë, Albania, May 2, 2003. <http://www.state.gov/p/eur/rls/fs/112766.htm>

⁴ <http://www.state.gov/p/eur/rls/fs/112766.htm>

- Nevojën për t'i dhënë një shtysë të fuqishme bashkëpunimit politik, ushtarak dhe ekonomik ndërmjet partnerëve dhe fqinjëve të tyre.

Si e tillë, Karta, si një iniciativë e sponsorizuar nga SHBA, është një hap i rëndësishëm për Shqipërinë, Kroacinë dhe Maqedoninë që megjithëse thekson se vlerësimi i reformave dhe arritjeve do të kryhet individualisht, ka përmbajtur gjithmonë një dimension lehtësisht të identifikueshëm grupi për anëtarësim. Kështu, samitet pasuese të NATO-s në Stamboll 2004, Bruksel 2005, Riga 2006, Bukuresht 2008, dhe Strasburg-Kehl 2009 kanë afirmuar gjithmonë qasjen e Aleancës në nivel grupi për këto tri shtete. Gjatë samitit të NATO-s në Bukuresht 2008, Aleatët ranë dakord se të tria vendet i kishin plotësuar kriteret e nevojshme për anëtarësim. Shqipëria dhe Kroacia morën ftesa për fillimin e procesit të anëtarësimit, ndërsa Maqedonia do të marrë ftesën sapo të gjendet një zgjidhje në mirëkuptim të dyanshëm për çështjen e emrit të saj.

Një element tjetër i rëndësishëm që e bën partneritetin e Kartës së Adriatikut, krahasuar me iniciativa të tjera rajonale, shumë më të efektshme dhe më të përvetësuar nga shtetet, qoftë individualisht qoftë nga të tria së bashku në nivel rajonal, është fakti se iniciativa u udhëhoq nga qëllimi dhe prioriteti kombëtar i këtyre vendeve për t'u anëtarësuar në NATO. Një karakteristikë e rëndësishme e partneritetit të A3 ishte integrimi në NATO si një realitet dhe objektiv i prekshëm. Kjo rezultoi në orientimin dhe motivimin e institucioneve të çdo shteti që të bëhen pjesë dhe të udhëheqin procesin e reformave dhe të forcimit të bashkëpunimit dhe partneriteteve. Bashkëpunimi institucional në kuadër të A3 përfshinte jo vetëm Forcat e Armatosura, qeveritë dhe krerët e shteteve, por edhe shoqëritë civile dhe komunitetet e biznesit. Mbështetja popullore për integrimin në NATO sidomos në Shqipëri⁵, por edhe në Maqedoni shërbeu si një nxitje për reforma të rëndësishme dhe bashkëpunim intensiv.

⁵ Shih sondazhin e IDM 2007 <http://idmalbania.org/en/publications.php>

Si shprehet ministri i Jashtëm i Shqipërisë⁶ “Të gjitha partitë politike shqiptare mbështesin integrimin dhe i janë përkushtuar reformave dhe transformimeve të nevojshme për ta arritur. Krijimi i një komisioni parlamentar bipartizan për integrimin e Shqipërisë në NATO do të lehtësojë arritjen e marrëveshjes për ligjet që lidhen me këtë proces, do të sigurojë përkushtimin financiar dhe do të japë mbështetjen popullore dhe drejtimin e nevojshëm politik për të arritur këtë objektiv jetik”.

Republika e Shqipërisë mund të konsiderohet si aktori më aktiv në këtë partneritet për disa arsye⁷. Kjo ishte një iniciativë e sponsorizuar nga NATO, mbështetja e publikut ishte shumë tunduese për politikanët dhe institucionet, gjithashtu Shqipëria ishte demokracia më pak e konsoliduar dhe standardet ekonomike ishin më poshtë se ato të vendeve të tjera, gjë që Shqipëria e kompensoi nga mbështetja e padiskutueshme dhe nganjëherë tej kapaciteteve të saj NATO-s dhe operacioneve të SHBA jashtë vendit⁸. Gjithashtu, megjithëse reformat vazhduan për të arritur standarde të rëndësishme, analistët në vend e shikonin A3 si një mundësi për Shqipërinë për t’u konsideruar nga Aleanca si një anëtare në një grup anëtarësimi.

Rruga e Kartës së Adriatikut për në NATO, aktivitetet dhe aksionet e përbashkëta brenda Planit Veprimit për Anëtarësim

Në mënyrë që të forcojë akoma më tej marrëdhëniet me Kartën SHBA-Adriatik një Komision Partneriteti u krijua me përfaqësues të nivelit të lartë përkatës (ministra, deputetë dhe ministër i Punëve të Jashtme). U ra dakord që Komisioni të mbledhet dy herë në vit ose më shpesh, si të jetë nevoja, në një

⁶ “The Albanian Perspective of the A3 Approach to NATO” by Lulzim Basha Foreign Minister of Albania. COSSROADS The Macedonian Foreign Policy Journal), issue: 03 / 2007, pages: 2741, on www.cceol.com

⁷ <http://idmalbania.org/publications/en/AlbPerceptionOnNATOintegrations.pdf>

⁸ Ibid

nga qytetet e shteteve nënshkruese të Kartës, me një qëllim themelor të marrjes parasysh të aktiviteteve të kryera dhe të parashikuara për të ardhmen. Duke synuar zbatimin cilësor të detyrimeve dhe aktiviteteve që rrjedhin nga Karta SHBA-Adriatik, u vendos rotacioni gjashtëmujor i kryesisë së Kartës SHBA-Adriatik. Një karakteristikë e këtij partneriteti që e çoi atë drejt suksesit ishte niveli i përvetësimit të saj nga shtetet e veçanta.

Bashkëpunimi brenda Kartës zhvillohet në nivele dhe fusha të ndryshme bashkëpunimi. Shumë institucione janë përfshirë në këtë proces. Krerët e shteteve dhe qeverive, ministrat e Mbrojtjes, ministrat e Jashtëm, shefat e mbrojtjes, komandantët e shërbimeve dhe shtabeve etj. Përveç institucioneve, OJQ-të ishin gjithashtu të përfshira, me detyrën për të siguruar mbështetje nga populli për integrimin e rajonit në Aleancë, por edhe për të plotësuar institucionet publike në iniciativën e tyre për bashkëpunim rajonal në sfidat dhe reformat rreth sigurisë. “Aleanca qytetare 08” ishte një rrjet shoqërie civile e tre organizatave si Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim nga Tirana, Forum nga Shkupi dhe Instituti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare në Zagreb⁹.

Megjithëse si u përmend më sipër, reformat kishin në shumicën e rasteve objektiva të bazuara në standardet e veçanta të shteteve, A3 arriti me mjaft sukses të institucionalizojë bashkëpunimin në nivele të ndryshme.

Takimi i parë trepalësh i ministrave të Mbrojtjes së A3 u mbajt në qershor 2003 në Bruksel dhe diskutimet u përqendruan në fushat e mundshme të bashkëpunimit, të cilat përfshinin: këshillime rreth politikave të mbrojtjes dhe sigurisë, bashkëpunimi në kontrollin e armëve, shkëmbimi i eksperiencës në edukimin ushtarak, bashkëpunim tekniko-ushtarak, pjesëmarrja në operacionet e udhëhequra nga PSO dhe NATO, forcim të përbashkët të OCC bazuar në standardet e NATO-s.

Në shtator 2003, në Tiranë u organizua takimi i parë i ministrave të Mbrojtjes së A3-shit në një nga vendet e A3-

⁹ Institute for Democracy and Mediation, <http://www.idmalbania.org/publications/alb/ceshtjetesigurise.pdf>

shit. Takimi u fokusua në procesin e institucionalizimit të drejtimeve të bashkëpunimit në zbatimin e iniciativës të Kartës së Adriatikut në sektorin e mbrojtjes, duke forcuar dhe zhvilluar më tej marrëdhëniet dy dhe trepalëshe.

Takimi i parë i Komisionit të Partneritetit të A3-shit ndodhi në nëntor 2003 në Uashington DC¹⁰. Ky takim theksonte rezultatet e aktiviteteve të deriatëhershme. Ai veçanërisht vlerësoi bashkëpunimin rajonal të vendeve të A3-shit për të arritur një objektiv të përbashkët: ftesën për anëtarësim në NATO. Në takim u ra dakord që kontributet në operacionet ndërkombëtare të paqes janë të rëndësishme për të forcuar ndëroperimin me NATO-n. Performanca e nivelit të lartë nga Ekipi Mjekësor i Bashkuar i Kartës së Adriatikut në operacionin Forca e Mbështetjes së Sigurisë ndërkombëtare ISAF, udhëhequr nga NATO në Afganistan, është një përpjekje për t'u lavdëruar në këtë kontekst. Aftësia për operacione të përbashkëta do të zhvillohet më tej nga pjesëmarrja në operacionet e NATO-s.

Në qershor 2004, Mbledhja e ministrave të Mbrojtjes së A3-shit u mbajt në Shkup, në prag të samitit të NATO-s në Stamboll. Ky takim kishte për qëllim të dëshmojë përpjekjet e përbashkëta të vendeve të A3-shit drejt integritimit në strukturat Euro-Atlantik. Ai theksonte progresin e bërë në procesin e transformimit të mbrojtjes, rezultatet e arritura në nivel të bashkëpunimit rajonal. Në përpjekjet e tyre për të përmbushur standardet e NATO-s, vendet e Kartës së Adriatikut, shprehen mirënjohjen e tyre për mbështetjen e dhënë nga SHBA për suksesin e kësaj iniciative. Ministrat ranë dakord që të zgjasin partneritetin tanimë të suksesshëm duke e lidhur ngushtë me formatin e vendeve Baltike: Estoni, Lituani dhe Letoni.

Në janar të 2005, takimi i ministrave të Mbrojtjes u zhvillua në Zagreb, ndërsa në maj 2005 në Bruksel. Në këtë takim ishte gjithashtu i pranishëm Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jaap de Hoop Scheffer, i cili qartësisht inkurajoi partneritetin

¹⁰ Adriatic Charter Group Issues Joint Statement, <http://www.america.gov/st/washfile-english/2003/November/20031114154145osnhoc0.5843164.html>

dhe progresin e bërë në zbatimin e MAP. Ndërsa takimi i fundit për atë vit u mbajt në Maqedoni në nëntor 2005. Ngjarja kulmore ishte Ekipi i Bashkuar Mjekësor i vendeve të A3 në ISAF. Në këto takime, u vendos që shtetet duhet të dërgonin dy rotacione në vit. Atë vit rotacioni i parë u dërgua me 10 gusht 2005.

Tirana ishte vendi i takimit të ministrave të Mbrojtjes së Shqipërisë, Kroacisë dhe Maqedonisë, si dhe përfaqësuesit të Sekretarit Amerikan të Mbrojtjes në dhjetor 2006, fill pas samitit të NATO-s në Rigë¹¹. Shqipëria rikonfirmoi përkushtimin e saj për të forcuar bashkëpunimin në kuadër të iniciativës SHBA-Karta e Adriatikut. Takimi i dha mirëseardhjen përfaqësuesve nga Bosnja-Hercegovina, Mali i Zi dhe Serbia. Ministrat e vlerësuan lart mesazhin e qartë të samitit të Rigës, i cili konfirmoi qëllimin e Aleancës për të dhënë ftesa gjatë samitit të ardhshëm në 2008, për vendet, të cilat kanë arritur standardet e NATO-s. Ky ishte edhe takimi i parë ku morën pjesë edhe vende të tjera të rajonit. Në këtë event u ritheksua nevoja për një bashkëpunim më të ngushtë për të përmbushur standardet e caktuara nga NATO dhe u ra dakord për më shumë aktivitete të përbashkëta, si stërvitje ushtarake, trajnim të përbashkët të Forcave Speciale dhe të pilotëve të helikopterëve, të zhytësve, të mediave, dhe pjesëmarrje reciproke në procesin e vlerësimit të njëjësive të paracaktuara për operacione të NATO-s. Në këtë takim të ministrave të Mbrojtjes u ritheksua edhe nevoja për më shumë përpjekje për projekte të përbashkëta nga vendet e A3-shit, të cilat mirëpritën shtetet anëtare të NATO-s, organizatat apo institucionet që do të jepnin mbështetjen dhe ekspertizën e tyre. Kjo asistencë u paraqit si fitimprurëse jo vetëm për vendet e A3-shit, por edhe për vendet e tjera të rajonit. Takimi gjithashtu e konsideroi rolin e SHBA-së si jetik për suksesin e një bashkëpunimi më të fortë të iniciativës A3.

Partnerët e Kartës së Adriatikut vendosën në shtator të 2008-ës të ftojnë shtetet e Malit të Zi dhe Bosnjë-Hercegovinës

¹¹Astrit Gjunkshi KARTA E ADRIATIKUT Angazhim i përbashkët për integrim në NATO. <http://www.mod.gov.al/botime/html/revista/2007/1/faqe1.htm>

t'i bashkohen Kartës. Në një shkëmbim shkresash, konfirmuan dhe iu bashkëngjiten parimeve të përvijuara në Kartën e Adriatikut¹². Më 4 dhjetor 2008¹³ të gjashtë partnerët (Shqipëria, Kroacia, Maqedonia dhe SHBA, bashkë me Bosnjë-Hercegovinën dhe Malin e Zi) nënshkruan një shtojcë ndaj Kartës për të mirëpritur zyrtarisht Malin e Zi dhe Bosnjë-Hercegovinën.

Një tjetër nivel i rëndësishëm i kontakteve të institucionalizuara me partneritetin e A3-shit ishte bashkëpunimi ndërmjet Shefave të Ushtrive ose Shefave të Mbrojtjes. Duke filluar nga tetori 2004, kur takimi i parë i Shefave të Mbrojtjes së shteteve të A3-shit u mbajt në Ishujt Brijuni, Kroaci, takime të nivelit të tillë u mbajtën e pakta dy herë në vit. Temat e takimeve janë të lidhura me proceset e rëndësishme nga liria e Forcave të Armatosura dhe shërbejnë për shkëmbimin e përvojës në transformimin e sistemit të mbrojtjes dhe përmirësimin e bashkëpunimit. Përveç delegacioneve të vendeve të A3-shit, u ftuan edhe Shefat e Mbrojtjes së shteteve të tjera, të cilat akoma nuk janë pjesë e MAP, si Bosnjë-Hercegovina, Mali i Zi dhe Serbia. Po kështu ftesa u dërguan edhe në drejtim të anëtarëve të rinj të NATO-s (Hungaria, Bullgaria etj.) dhe anëtarëve tashmë me përvojë (Italia, Greqia, Turqia etj.) nga rajoni, për të ndarë eksperiencat mes tyre.

Takimet në nivelin e Shefave të Mbrojtjes të grupit A3 bëjnë të mundur që eksperiencia nga reformat e mbrojtjes në tërësi të shkëmbehen në nivelet më të larta të Forcave të Armatosura, por edhe për të zhvilluar bashkëpunim dhe mirëbesim rajonal në mënyrë kompetitive.

Sidomos prej vitit 2006 takimet e rregullta të Shefave të Mbrojtjes së A3-shit ishin kryesisht të organizuara në formate të zgjeruara. Në takimin e zhvilluar në Tiranë në prill 2007, përveç Shefave të Mbrojtjes së tre vendeve, u ftuan edhe delegacione të udhëhequra nga vendet rishtazi të pranuar të Pfp si Bosnjë-Hercegovina, Mali i Zi dhe Serbia. Delegacionet Amerikane dhe Italiane ishin gjithashtu pjesë e diskutimeve.

¹² <http://www.state.gov/p/eur/rls/fs/112766.htm>

¹³ <http://www.mvpei.hr/MVP.asp?>

pcpid=1486&mjese=12&Godina=2008

Në takimin e nëntorit 2007 në Shkup, ishin të pranishëm pak a shumë të njëjtët pjesëmarrës, përveç, delegacionit Italian që u zëvendësua me një delegacion bullgar.

Përveç takimeve të rregullta të bashkëpunimit të institucionalizuar, sipërmarrjet e përbashkëta të formave të ndryshme ishin më të efektshmet në nxitjen e bashkëpunimit rajonal.

Projekti më domethënës brenda kuadrit të Kartës së SHBA-Adriatikut është Ekipi i Bashkuar Mjekësor¹⁴. Ekipi i Bashkuar Mjekësor i Kartës së Adriatikut ishte një ekip mjekësor trepalësh i përcaktuar për të mbështetur Forcën Ndërkombëtare të Asistencës për Sigurinë në Afganistan. Memorandumi u firmos me konsensus trepalësh në takimin e ministrave të Mbrojtjes dhe Shfave të Mbrojtjes të vendeve të Kartës së SHBA-Adriatikut me 4 maj 2005. Kreu i Ekipit është një doktor i shkencës së mjekësisë nga shteti që kryeson Kartën në periudhën e Misionit. Ekipet i nënshtrohen një rotacioni 6-mujor.

Më të rëndësishëm në trajnim, ndërtim kapacitetesh dhe partneritetesh për Forcat e Armatosura të vendeve të A3-shit ishin numri i paprecedent i aktiviteteve të përbashkëta të zhvilluara në nivel të stërvitjeve të përbashkëta, trajnimit të përbashkët dhe edukimin dhe takimeve të përbashkëta.

Që nga 2004, pjesëtare të Forcave të Armatosura të tre shteteve kanë marrë pjesë në zhvillimin e stërvitjeve në kuadër të Kartës së Adriatikut. Dy stërvitje u zhvilluan në vitin 2004: “ADRIATIC PHIBLEX 04 – ENGEENEREX”, në Kroaci dhe “EAGLE SAR 04” në Shqipëri që u ndoqën nga “EAGLE SAR 05” në Shqipëri në vitin 2005. Stërvitjet e poshtëshënuara u zhvilluan në 2006: “ARIEX 06”, në Kroaci, ku morën pjesë rreth 200 pjesëmarrës ndërsa “ADRIATIC EAGLE 06” dhe “EAGLE SAR 06”, u zhvilluan të dyja në Shqipëri. Stërvitjet “ADRIATIC EAGLE 07” and “LOGEX-07” u zhvilluan në Kroaci në vitin 2007.

¹⁴ Adriatic Charter States Agree to Send Joint Medical Unit to Afghanistan
<http://www.setimes.com/cocoon/setimes/mobile/bs/features/setimes/newsbriefs/2005/05/05/nb-05>

“LOGEX 07” ishte një përpjekje trajnuese njëvjeçare për të rritur përputhshmërinë e logjistikës së NATO-s me vendet e Kartës së Adriatikut, e sponsorizuar nga Fondi i Iniciativës së Varshavës, e cila kulmoi në Stërviçjen Logjistike në Kroaci në nëntor 2007. Stërviçjet “Macedoni Flash-2” and “Bovila 07” u zhvilluan respektivisht në Maqedoni dhe Shqipëri në 2007. Këto dy stërviçje ushtarake kishin si qëllim trajnimin e batalioneve të trupave speciale në tokë dhe terrene malore. “Bovila 07” zhvillohet në Shqipëri që nga 2005, me bashkëpunimin e trajnuesve zviceranë.

“Adriatic Aurora 08” ishte njëherësh një stërviçje e Kartës së Adriatikut dhe Partneritetit të Shtetit, i cili ka bashkuar batalione nga Minesota, Nju-Xhersi dhe Vermonti, si dhe njësi nga Kroacia, Maqedonia dhe Shqipëria.

Përveç këtij niveli të bashkëpunimit, që nga viti i parë i Kartës SHBA-Adriatik është ndjekur Plani Vjetor i Bashkëpunimit¹⁵. Në këtë plan për vitin e parë (2005) ishte planifikuar zbatimi i 9 aktiviteteve të përbashkëta të formave të ndryshme, ndërsa ky numër u rrit në 38 për vitin 2007. Plani përfshin bashkëpunim në nivele të ndryshme drejtimi dhe administrimi, përgatitje të përbashkët të Ekipit të Bashkuar Mjekësor, pjesëmarrje në stërviçjet e përbashkëta ose ftuarjen e përfaqësuesve, të cilët do të merrnin pjesë si vëzhgues. Aktivitetet e përshkruara më sipër u përkrahën dhe u inkurajuan edhe nga kryesia e çdo gjashtëmujori, nga të tre shtetet nënshkruese.

Ja vlejnë të përmenden edhe takimet e rregullta të Krerëve të Shtetit, Qeverive dhe ministrave të Punëve të Jashtme që kanë vendosur tashmë një përvojë të paprecedentë kontaktesh dy dhe trepalëshe, të cilat që nga 2003-shi kanë shtuar numrin e takimeve zyrtare dhe jozyrtare, duke kontribuar kështu në ndërtimin e besimit rajonal mes palëve.

¹⁵ <http://www.mod.gov.al/botime/html/ushtria/29072005/faqe4.htm>

Perspektiva e A3-shit si një iniciativë rajonale që ndërton besim dhe bashkëpunim

Gjatë këtyre viteve Shqipëria, Kroacia dhe Maqedonia kanë vënë në skenë një duzinë aktivitete të përbashkëta ushtarake dhe politike në kuadër të A3-shit, dhe në të njëjtën kohë, ato edhe kanë mbështetur vendet e tjera të rajonit si Bosnje-Hercegovina, Mali i Zi dhe Serbia, dhe aspiratat e tyre për t'u bashkuar me Aleancën. Megjithatë, për të konsoliduar partneritetin e tyre dhe për të rritur shanset për një anëtarësim në NATO, tre vendet filluan një proces institucionalizimi dhe ndarjeje eksperience me tre Republikat Baltike¹⁶. Partneriteti i vendeve të A3-shit me Grupin Baltik B# (Lituania, Letonia dhe Estonia) do të shndërrohej me kohë në një frymëzim që jepte idenë se partneriteti rajonal do të ndikonte pozitivisht në anëtarësimin në grup në Aleancë. Në procesin e anëtarësimit në Aleancë të vendeve të A3-shit, SHBA, si një partner strategjik, dhe vendet e tjera të NATO-s si këshillues specifikë, kanë dhënë një mbështetje të rëndësishme për të nxitur këtë formë të re të bashkëpunimit rajonal.

Një karakteristikë e veçantë e bashkëpunimit të A3-shit qëndron edhe në disa institucione për edukim rajonal të zhvilluara dhe aktive në nivel rajonal, si dhe krijimi i kapaciteteve në çështjet e lidhura me sigurinë dhe mbrojtjen. Këto institucione gjithashtu ndoqën modele të ngjashme me iniciativën e bashkëpunimit të vendeve Baltike. Kështu, që në 2007, Ministria e Mbrojtjes dhe Qeveria e Shqipërisë ka mbështetur Kolegjin e Mbrojtjes Rajonale, ku janë të ftuar për të marrë pjesë zyrtarë nga mbrojtja dhe ushtria e vendeve të Ballkanit Perëndimor. Kroacia po mbështet si një iniciativë për bashkëpunim rajonal Qendrën për Siguri në Rakviak. Qendra Rajonale Trajnuese e Komunikimit filloi të vepronte që në nëntor 2005, në Republikën e Maqedonisë, si rezultat i një bashkëpunimi jashtëzakonisht pozitiv ndërmjet Konfederatës Zvicerane dhe Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Maqedonisë. Qendra u zhvillua nga aspiratat e

¹⁶ www.infoplease.com/country/profiles/macedonia.html

vendeve të rajonit të Europës Juglindore drejt arritjes së standardeve të shoqërive moderne në fushën e mbrojtjes dhe punëve të brendshme. Përveç kësaj ideja ishte të kontribuohet në zhvillimin e një besimi të ndërsjelltë të nivelit të lartë nëpërmjet trajnimit të punonjësve të Ministrive të Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura të vendeve të A3-shit. Që nga dhjetori i 2006-s kjo qendër ka qenë e hapur për tërë rajonin e Europës Juglindore dhe shtetet e Partneritetit për Paqe. Gjatë vitit 2007, brenda iniciativës **Trajno** Trajnuesin, trajnim iu mundësua edhe anëtarëve të Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Serbisë. Është e rëndësishme të nënvizohet fakti që miqtë, udhëzuesit nga vende të ndryshme të Europës dhe SHBA-së marrin pjesë në aktivitete të Qendrës.

Megjithëse, në të kaluarën takimet e përbashkëta të ministrave janë diskutuar për të përfshirë edhe vende të tjera ballkanike në Kartën e Adriatikut, Kroacia inicioi takimin e parë të ministrave të Jashtëm dhe të Mbrojtjes së vendeve të A3-shit me grupin Baltik, duke organizuar kështu *Konferencën Adriatike-Baltike-Atlantike* në ishujt Brijuni (morën pjesë dhe përfaqësues të lartë të Bosnjë-Hercegovinës, Malit të Zi dhe Serbisë). Kjo nisëm u vazhdua në takimin e dytë të të njëjtit format në shkurt 2007 në Tallin, Estoni, dhe në tetor 2007 në Split, Kroaci, me një takimin të tretë në po atë nivel. Kështu, mesazhi i bashkëpunimit rajonal si një parakusht për integrimin Euro-Atlantik për vendet më gjerë se vetëm të Gadishullit Ballkanik, dhe jo vetëm të A3-shit, filloi të bëhej më i qartë. Kjo u përshkrua shumë qartë nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura Kroate, Josip Lucic, (Prill 2006): *“qëllimi i takimit është që të tria vendet së bashku me vendet e tyre fqinje, të shkëmbejnë arritjet dhe sfidat që kanë hasur në fushën e mbrojtjes, pra zgjidhjet që ato ofruan në arritjen e objektivave”*. Ai vazhdoi më pas duke theksuar detyrën e vendeve të A3-shit për të ndihmuar Forcat e Armatosura të Bosnjë-Hercegovinës dhe Malit të Zi, ai tha se ishte e nevojshme të krijohen ekipe dhe njësi të përbashkëta që do të përfaqësojnë një kontribut të dukshëm në NATO dhe BE. Shfaqja dhe angazhimi në misione ndërkombëtare do të kontribuojë më tej në *“promovimin e paqes dhe sigurisë për të gjithë rajonin”*.

Për një dekadë Shqipëria ka shprehur besimin e saj se NATO dhe BE përfaqësojnë destinacionin e ardhshëm të të gjitha vendeve të rajonit, dhe si e tillë, Shqipëria i kushtoi një vëmendje të veçantë bashkëpunimit me Kroacinë dhe Maqedoninë, në kuadër të Kartës së Partneritetit, si tregues të një vizioni të përbashkët për paqen dhe stabilitetin e Europës Juglindore.

Duke investiguar në mënyrë më specifike nivelin e marrëdhënieve dypalëshe ndërmjet Shqipërisë dhe Maqedonisë (të vetmet vende të A3-shit që ndajnë një kufi të përbashkët) para dhe pas krijimit të Kartës SHBA-Adriatike në maj 2003, duhet rënë dakord që të shkohet përtej zhvillimeve të rastësishme. Në një kërkim të përbashkët të dy shoqërive civile nga Tirana dhe Shkupi në vitet 2002-2003, një nivel i konsiderueshëm mosbesimi u vërejt në përgjigjet e marra nga të dy anët e kufirit, duke kulmuar me raportet që tregojnë për 2-3 viktima të incidenteve në kufi çdo vit. Raportet zyrtare tregojnë se që nga 2003-shi deri më sot asnjë incident kufitar nuk është raportuar ndonjëherë (as që bëhet fjalë për viktima). Një progres shumë më i madh raportohet nga të dyja palët në sferat politike, ekonomike, kulturore, lëvizjen e lirë të qytetarëve, mediave etj. Takime të rregullta zyrtare mbahen ndërmjet Krerëve të Shtetit, përfaqësuesve të qeverive dhe institucioneve të vënies në zbatim të ligjit, të cilat kanë shoqëruar të gjithë procesin. Takimet dypalëshe në periudhën 2003-2005 ishin kaq të shpeshta sa që ndryshuan rrënjësisht perceptimet tradicionale të mosbesimit dhe paragjykimet, duke kontribuar edhe në integrimin e mëtejshëm të Shqiptarëve që jetojnë në Maqedoni në shoqërinë multietnike të këtij shteti.

Praktikisht, mund të duket pak e vështirë që vëzhguesit të dalin në përfundimin se progresi në ndërtimin dypalësh dhe rajonal të mirëbesimit erdhi vetëm për shkak të obligimeve që vendet kishin nga bashkëpunimi i Kartës së Adriatikut, por fakti partneritetet e vërteta filluan me Planet Vjetore të Bashkëpunimit dhe veprimeve të përbashkëta është krejtësisht i qartë. Procesi lehtësisht i dallueshëm i ndërtimit të mirëbesimit rajonal i atribuohet më shumë meritës së partneritetit të A3-shit, sepse në këtë bashkëpunim ishin

Mbrojtja dhe Ushtria e vendeve të A3-shit (tradicionalisht sferat me konservatorë dhe nacionalistë) ato që organizuan stërvitje të përbashkëta në territoret e secilit shtet.

Partneriteti i Kartës së Adriatikut ka ndihmuar gjithashtu në tërheqjen e Kroacisë drejt zhvillimeve të Ballkanit Perëndimor duke e përfshirë në çështjet e bashkëpunimit dhe ndërtimit të besimit në rang rajonal. Ky proces pritet të intensifikohet me vendet e reja që do t'i bashkëngjiten modelit të partneritetit të Kartës së Adriatikut. Takimi i ministrave të Jashtëm të A3-shit dhe ndihmës Sekretarin e Shtetit të SHBA-së, Daniel Fried, me 4 dhjetor 2008 në Podgoricë shënoi përfshirjen e Bosnje-Hercegovinës dhe Malit të Zi në Kartën e zgjeruar të Adriatikut, A5. Në këtë ceremoni mori pjesë edhe Serbia, në rolin e një vëzhguesi, si dhe Estonia dhe Letonia. Bosnjë-Hercegovina dhe Mali i Zi, në një shkëmbim shkresash, konfirmuan qëndrimin e tyre për t'iu bashkuar parimeve të përpiluara në Kartën e Adriatikut. Si partnerë u zotuan në përkushtimin e tyre për përpjekjet për të intensifikuar reformat e brendshme, bashkëpunimin shumëfaqësh politik dhe të mbrojtjes, ekonomik, si dypalësh ashtu dhe rajonal. Partnerët themelues nga ana e tyre shprehën mbështetjen e tyre për Bosnje-Hercegovinën dhe Malin e Zi, dhe i dhanë atyre mirëseardhjen si partnerë, plotësisht të ndërgjegjshëm se pjesëmarrja e tyre do të ndihmojë në nxitjen e bashkëpunimit dhe sigurisë rajonale.

Gjatë fjalës së tij më 8 maj në Tiranë, ndërsa po drejtonte një takim me ministrat e Jashtëm të Shqipërisë, Maqedonisë, Kroacisë, Bosnje-Hercegovinës dhe Malit të Zi, Scheffer bëri të ditur se “Në shumë aspekte, origjinat e transformimit të NATO-s pas përfundimit të Luftës së Ftohtë, gjenden këtu, në Europën Juglindore”.

Deklarata e samitit të NATO-s në prill 2009 shprehte përkushtimin e NATO-s për Ballkanin, duke bërë të ditur rolin e rëndësishëm të luajtur nga Iniciativa e Europës Juglindore dhe Karta e Adriatikut në nxitjen e bashkëpunimit dhe ndërtimit të besimit në rang rajonal dhe lehtësimin të integritetit Euro-Atlantik të Ballkanit Perëndimor duke inkurajuar bashkëpunimin me Bosnje-Hercegovinën, Malin e Zi dhe Serbinë.

Vlerat e shtuara të avantazheve relative të A5-s krahasuar me skemat e tjera të bashkëpunimit rajonal

Zhvillimi i këtij shkrimi i kushtohet kryesisht përshkrimin të partneritetit të Kartës së Adriatikut, ndërmjet Shqipërisë, Maqedonisë dhe Kroacisë si një iniciativë e sponsorizuar nga SHBA, pas partneritetit të suksesshëm SHBA-vende Baltike për të përgatitur këto vende për anëtarësimin në NATO, por edhe për të forcuar bashkëpunimin rajonal dhe ndërtimin e besimit. Rezultatet kanë qenë mbresëlënëse, përderisa për 5-6 vjet ato vende morën një ftesë për anëtarësim në NATO. Reformat intensive individuale të Forcave të Armatosura dhe jo vetëm, bashkëpunimi intensiv dhe ndarja e eksperiencës ndërmjet tre partnerëve me Planin Veprimi për Anëtarësim, misionet e përbashkëta të tre partnerëve në arenën ndërkombëtare, mund të krahasohen me të gjitha iniciativat e tjera që janë zhvilluar në Ballkanin Perëndimor dhe Europën Juglindore në dy dekadat e fundit. Kjo iniciativë ndryshon rrënjësisht në sensin e përvetësimit dhe drejtimit lokal dhe rajonal të iniciativës. Megjithatë roli i SHBA-së ishte i rëndësishëm dhe jetik për arritjen e objektivave, vendet e rajonit shfaqën përkushtim individual dhe një shkallë të lartë përgjegjësie.

Suksesi i A3-shit, ishte bazuar edhe në modelin e bashkëpunimit Baltik dhe kjo forcoi shanset për efektivitetin e tij, për shkak se komuniteti Atlantik thjesht po përsëritnin këtë model të suksesshëm të bashkëpunimit rajonal. Çfarë i bëri B3 dhe A3 të suksesshëm. Ajo çfarë i bëri të suksesshme A3 dhe B3-shin, ishte rezultati i drejtpërdrejtë i përpjekjeve të vendeve të përfshira për të arritur anëtarësimin në NATO, për një kohë prej një gjysmë dekade për çdo grup.

Për sa i përket ndërtimit të besimit rajonal, perspektiva dypalëshe Shqiptaro-Maqedonase është një ndër faktorët më sinjifikativë duke qenë se ka ndikuar në zbutjen e shoqërisë Maqedonase ndaj kërcënimit që ajo perceptonte tradicionalisht nga fqinji i saj Perëndimor, Shqipëria. Gjithashtu, bashkëpunimi dhe procesi i integritimit Euro-Atlantik po sjellin

fundin e problemit të Maqedonisë, si dhe zgjidhjen e çështjes shqiptare në Ballkan.

Partneriteti i Kartës së Adriatikut u shndërrua në një histori sukcesi rajonal në radhë të parë sepse u udhëhoq nga dëshira e shoqërive kombëtare të rajonit për të arritur një objektiv shumë të rëndësishëm kombëtar: qenia pjesë e Zonës së Sigurisë Euro-Atlantike. Pikërisht ky ishte interesi thelbësor që bëri që edhe vendet e tjera të rajonit t'i bashkohen në rrugën e këtij bashkëpunimit. Bosnje-Hercegovina dhe Mali i Zi janë tashmë anëtarë të këtij modeli të bashkëpunimit rajonal, ndërsa Serbia dhe Kosova duhet të ndjekin procesin.

A5 do të vazhdojë të udhëheqë procesin e bashkëpunimit rajonal dhe ndarjes së eksperiencës sepse lidhen:

- Me prioritetin për të forcuar më tej këtë lidhje, dhe për të rritur efektivitetin e saj në arritjen e standardeve të NATO-s nga anëtarët e rinj.

- Me një ndërveprueshmëri të rritur të Forcave të Armatosura me NATO-n, Mbështetjen për Paqe dhe Operacionet e Përgjigjes ndaj Krizave.

- Me përpjekjet e grupit të A3-shit për forcimin e bashkëpunimit ushtarak me Forcat e Armatosura të vendeve të rajonit dhe anëtarët e rinj të PFP (Serbia, Bosnje-Hercegovina dhe Mali i Zi).

- Me esencën e Kartës së Adriatikut si një iniciativë dinamike sepse ka qenë gjithmonë një iniciativë në veprim, e lidhur ngushtë me veprimet e NATO-s.

- Me impaktin e dukshëm në bashkëpunimin rajonal dhe ndërtimin e besimit rajonal ndërsa vende të reja po aplikojnë për të futur në këtë skemë të partneritetit rajonal.

Ndërsa të gjitha iniciativat e tjera ekzistuese marrin merita për arritjen e atyre që kanë qenë qëllimet e tyre fillestare, A5 do të vazhdojë të zgjerohet dhe mundësisht të vetëreformohet në të ardhmen, duke reflektuar ambientin e ri rajonal pasi të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor të kenë hyrë në NATO në dekadën e ardhshme.

BIBLIOGRAFI**Regional Initiatives in South Eastern Europe 2002**

<http://www.emins.org/english/public/books/reg-init-see.htm#toc>

Stability pact for Eastern Europe <http://www.stabilitypact.org/about/default.asp>

“KARTA E ADRIATIKUT DHE INTEGRIMI” Dr. Astrit Gjunkshi

(Botim i Ministrisë së Mbrojtjes, Tiranë 2006)

“The Albanian Perspective of the A3 Approach to NATO” by Lulzim Basha, Foreign Minister of Albania. COSSRO-ADSTheMacedonian Foreign Policy Journal), issue: 03 / 2007, pages: 2741, on www.ceeol.com.

“Albanian Perceptions to NATO integration” Tirana April 2007.

<http://idmalbania.org/publications/en/AlbPerceptionOnNATOintegrations.pdf>

Survey: Cross –Border Confidence Building between Albania and Macedonia,

IDM & Euro-Balkan 2003-2004 Tirana

Albania and Macedonia towards sustainable cooperation in bilateral and regional confidence building, Toena publishing house Tirana 2005. page 61.

Adriatic Charter Group Issues Joint Statement, <http://www.america.gov/st/washfile-english/2003/November/20031114154145osnhoc0.5843164.html>

Astrit Gjunkshi KARTA E ADRIATIKUT Angazhim i përbashkët për integrim në NATO. <http://www.mod.gov.al/botime/html/revista/2007/1/faqe1.htm>

Adriatic Charter Expands to Include Montenegro

http://podgorica.usembassy.gov/adriatic_charter_expands_to_include_montenegro.html

Adriatic-Baltic– Atlantic meeting of Minister of Foreign Affairs and Defense October 2007 Croatia http://zagreb.usembassy.gov/press_releases/2007-press-releases

¹ www.mfa.gov.lv/en/news/press-releases/2009/march/24-3/

“Adriatic Charter And The Balkans: Smaller Nations, Larger NATO”

by Rick Roza <http://www.globalresearch.ca/index>

NATO’s Strasbourg / Kehl Summit Declaration

<http://www.america.gov/st/texttrans-english/2009/April/>

EVIS GJEBREA

KRIZA FINANCIARE BOTËRORE
DHE NDIKIMI I SAJ MBI SIGURINË

Çdokush që lexon këtë titull me të drejtë mund të mendojë se çfarë lidhje kanë këto dy koncepte së bashku. Shumica prej nesh është ekspozuar mjaftueshëm ndaj problemeve të krizës, por jo aq shumë ndaj sigurisë. Lind pyetja çfarë nënkupton në vetvete siguria ? Është siguri e brendshme e një vendi, apo ky koncept shkon përtej kësaj ? Këtyre pyetjeve do të përpiqet t'i përgjigjet ky artikull.

NATO është si një organizatë politike, ashtu dhe ushtarake dhe e tillë duhet të mbetet.

Mbas Luftës së Ftohtë Qeveria Amerikane hodhi konceptin e sigurisë njerëzore. Siguria nuk kufizohej më vetëm tek siguria e brendshme e një vendi, por ky koncept shtrihej më tej duke pasur ne fokus sigurinë individuale, e cila në vetvete përmban disa komponentë. Ndërsa marrim në shqyrtim dokumentet strategjike të Shqipërisë mund të arrijmë në përfundimin se aspekti i sigurisë njerëzore është pothuajse i panjohur dhe shumë pak i trajtuar. Siguria njerëzore përfshin komponentët si në vijim: siguria ekonomike, siguria ushqimore, siguria mjedisore, siguria personale, siguria shëndetësore, siguria politike dhe siguria e komunitetit¹.

Kriza financiare botërore, e cila nisi zyrtarisht në 14 shtator 2008 shkundi të gjithë sistemin financiar botëror, por kjo krizë shumë shpejt u kthye në krizë ekonomike botërore duke prekur ekonomitë reale të vendeve të ndryshme të botës. Si rrjedhim, nuk ka sesi efektet e saj të mos jenë ndjerë tek ne individët duke cenuar kështu sigurinë njerëzore.

¹ Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, Siguria Njerëzore në Shqipëri, 2009, f. 1

Hyrje

Përgjatë pjesës më të madhe të shekullit XX siguria konceptohej ekskluzivisht si siguri kombëtare dhe fokusohej në probleme që buronin prej kërcënimit, përdorimit dhe kontrollit të fuqisë ushtarake në kontekstin e konkurrencës ndërkombëtare shtetocentrike². Por, pas Luftës së Ftohtë koncepti i interesit kombëtar pësoi një transformim të dukshëm, duke u zhvendosur nga përsiatja e sigurisë drejt përsiatjes së mirëqenies së individit³. Shtrohet pyetja se përse i vihet theksi mirëqenies së individit në shekullin XX? A do të thotë kjo që njerëzit janë më pak të sigurt në ditët e sotme dhe më tepër të kërcënuar?

Të gjithë njerëzit dëshirojnë të jenë të sigurt në jetën e përditshme. Kjo ide është shfaqur që në mesin e viteve 1960-të kur një grup shtetesh të pazhvilluara e përdorën atë si argument në favor të përsiatjes së interesave të tyre ekonomike-sociale. Në fillim të viteve '90 siguria njerëzore si objekt analize mori trajtën e saj më të plotë, e pasqyruar në punimet e një grupi të gjerë studiuesish, të cilët nuk vinin tashmë vetëm nga fusha e marrëdhënieve ndërkombëtare, por edhe nga fusha të tjera, si ekonomia, mjedisi, shkencat ekzakte⁴ etj. Përkufizimi i parë i plotë i sigurisë njerëzore shfaqet në vitin 1994, kur programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në një deklaratë politike nën siglën e Kombeve të Bashkuara e përshkruan sigurinë njerëzore si *“një gjendje në të cilën individët lehtësohen nga traumat që rrethojnë zhvillimin njerëzor, ose ku këto trauma u mungojnë tërësisht”*.

Nga një studim i kryer nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim lidhur me Sigurinë Njerëzore në Shqipëri, arrihet në konkluzionin se koncepti i sigurisë njerëzore është pothuajse i panjohur nga Qeveria Shqiptare dhe si rrjedhim nuk trajtohet në politikat dhe dokumentet e saj strategjike.

² Dan Henk, “Human Security: Relevance and Implications”, Parameters, Summer 2005, p 91-106

³ Arnold Eöfers, “National Security as an Ambiguous Symbol”, Political Science Quarterly, Vol 67, No. 4 (Dec 1952) f. 482.

⁴ Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, Siguria Njerëzore në Shqipëri, f. 1

Për këtë qëllim, zgjedha të trajtoj këtë artikull për të ndërgjegjësuar lexuesit mbi rëndësinë që ka marrë sot siguria njerëzore dhe për më tepër të paraqes efektet që kriza aktuale botërore sjell mbi sigurinë njerëzore.

Në pjesën e parë të këtij artikulli vëmendje e veçantë do t'i kushtohet konceptit të sigurisë dhe gjendjes së sigurisë në Shqipëri. Në pjesën e dytë të artikullit do të trajtohet çështja e krizës financiare botërore, të krizave të tjera botërore dhe efektet e tyre në ekonominë e vendit dhe sigurinë njerëzore. Në pjesën e tretë jepet strategjia e ndjekur nga Qeveria Shqiptare për të përballuar krizën botërore. Në pjesën e katërt dhe të pestë jepen konkluzionet dhe rekomandimet.

I. Koncepti i Sigurisë

1.1 Përkufizimi dhe komponentët e sigurisë njerëzore

Sipas raportit të UNDP siguria njerëzore së pari nënkupton siguri nga kërcënime kronike si uria, sëmundjet dhe represioni. Së dyti, ajo nënkupton mbrojtje prej prishjeve të papritura e të dëmshme të modeleve të jetës së përditshme-si në shtëpi, punë ose në komunitete (UNDP 1994:23). Raporti vazhdon duke pohuar se garantimi i sigurisë njerëzore kërkon që të trajtohen dhe integrohen njëherazi siguria ekonomike, e ushqimit, shëndetësore, e mjedisit, individuale, komunitare dhe politike.

Koncepti i sigurisë njerëzore nxjerr në pah faktin se vetë shteti nuk përbën më një argument të mjaftueshëm sigurie, sepse ai nuk i adresohet në mënyrën e duhur sigurisë së njerëzve brenda shteteve nga dhuna politike. Kështu siguria lidhet tanimë më shumë me individin sesa shtetin.

Sipas një studimi të kryer nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim për sigurinë njerëzore në Shqipëri⁵ evidentohen komponentët e sigurisë si në vijim:

⁵ Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, Siguria Njerëzore në Shqipëri, 2009, f1-23

1) *Siguria ekonomike*, nënkupton kushtin e të pasurit të të ardhurave stabil si dhe burime të tjera për të mbështetur një standard të kënaqshëm të jetesës në të tashmen dhe të ardhmen. Një përkufizim i thjeshtë i sigurisë ekonomike do të citohej si : vazhdimësi e shpagimit, qëndrueshmëri e të ardhurave dhe sigurim i punësimit. Pavarësisht një rritje pozitive të GDP-së, Shqipëria mbetet një nga vendet më të varfra në Europë ku një pjesë e madhe e popullsisë është detyruar të emigrojë. Papunësia e lartë, të ardhura të ulëta janë këto që shqetësojnë akoma qytetarin shqiptar. Megjithëse ajo kategori e popullsisë që jeton nën minimumin jetik (4891 lekë) është ulur nga 25.4% në vitin 2005 në 12.4%, në vitin 2008 përsëri llogaritet që në Shqipëri janë rreth 370.000 njerëz të varfër. Situata e sigurisë ekonomike në Shqipëri do të trajtohet më gjerësisht në pjesët në vijim të këtij artikulli.

2) *Siguria ushqimore*, lidhet me një situatë në të cilën njerëzit në çdo periudhë duhet të kenë mundësinë dhe hapësirën e nevojshme fizike, sociale e ekonomike që të marrin ushqim të mjaftueshëm e të sigurt, në mënyrë që të plotësojnë nevojat e tyre dietike dhe parapëlqimet ushqimore për një jetë aktive dhe të shëndetshme. Ndërkohë kjo e drejtë përfshin edhe garantimin e nevojave bazë ushqimore për çdo njeri, përqindjen që zë në buxhetin familjar konsumi për ushqim, cilësinë e tij të ushqyerit, si edhe sigurinë e ushqimit gjatë katastrofave njerëzore dhe natyrore. Popullsia Shqiptare pas viteve 90 po përjeton një periudhë tranzicioni të të ushqyerit si rrjedhojë e cilësisë së dobët të ushqimeve dhe shtimit të atyre me prejardhje gjenetike të modifikuar (OMGJ). Në të njëjtën kohë rritja e çmimeve të produkteve bazë ushqimore ka ndikuar në rritjen e çmimeve edhe në Shqipëri, duke prekur të ardhurat e qytetarëve dhe sigurinë ushqimore.

3) *Siguria mjedisore*, ka të bëjë me sigurinë nga degradimi i ambientit që sa vjen dhe është në rritje. Një fakt të tillë e tregon edhe ngrohja globale, ose siç njihet ndryshe efekti serë që shkaktohet nga dërgimi i dioksidit të karbonit (CO₂) në atmosferë. Studimet kanë treguar se 56.000 ton pluhur gjenerohen çdo vit vetëm në kryeqytetin shqiptar, ose e thënë ndryshe 70 kg pluhur në vit për çdo qytetar. Sipas Ministrisë

së Shëndetësisë më shumë se 1,400 raste të ndryshme kanceri janë të lidhura me shkallën e lartë të ndotjes mjedisore në Shqipëri, shumica e të cilave në kryeqytet. Një studim i publikuar në Tetor 2007 nga Organizata Botërore e Shëndetësisë zbuloi se ndotja e ajrit është përgjegjëse direkt për 200 vdekje të shkaktuara çdo vit.

4) *Siguria shëndetësore*, synon të garantojë një minimum të domosdoshëm mbrojtjeje nga sëmundjet, veçanërisht infektive dhe ato epidemike apo dhe nga ato që shkaktohen nga kushtet e këqija të jetesës. Shkaqet mund të jenë natyrale, mjedisore ose të qëllimshme. Sektori i shëndetësisë vuan akoma nga infrastruktura jo e duhur. Sipas statistikave kostoja mesatare e shërbimeve shëndetësore për person në vendin tonë është 50 usd/vit, ndërkohë që në Europë është 1900 usd/vit.

5) *Siguria personale*, ka të bëjë me mbrojtjen e njerëzve nga dhuna fizike prej aktorëve individualë dhe shtetërore. Një studim i kryer në Shqipëri nga PNUD në vitin 2004 nxori konkluzionin se të paktën 14% e shqiptarëve nuk ndihen të sigurt në shtëpitë e tyre, ndërkohë që jo më pak se 20% e shqiptarëve në nivel kombëtar ndihen të pasigurt personalisht në rrugë.

6) *Siguria politike*, ka të bëjë me kushtet politike në të cilat jeton populli përkatës nëse ai jeton apo jo në një shoqëri që i respekton tërësisht liritë dhe të drejtat themelore njerëzore. Megjithëse legjislacioni i mbrojtjes së të drejtave të njeriut në Shqipëri është i plotë, problemi kryesor mbetet implementimi eficient dhe efektiv i këtij legjislacioni. Në drejtim të lirisë së shprehjes ndonëse është bërë progres, probleme të lirisë së mediave janë hasur vitet e fundit në Shqipëri.

7) *Siguria e komunitetit* lidhet më shumë me grupet pakicë (etnike, nacionale, fetare etj), që mund të diskriminohen nga grupe shumice.

Ndonëse komponentët e sigurisë njerëzore janë identifikuar ajo që ngelet sfidë është matja e saj. Deri tani nuk është identifikuar një indeks. Por në mungesë të tij mund të përdoren disa indikatorë të tjerë që përdoren nga organizatat ndërkombëtare të tilla si :

1. Indikator i zhvillimit njerëzor i matur nga PNUD;
2. Indikator i perceptimit të korrupsionit i përdorur nga Organizata “Transparency International”;
3. Indikator mbi Demokracinë i Freedom House;
4. Indikator i përdorur nga Banka Botërore për Vlerësimin Institucional dhe Politikës së Vendit etj.

1.2 Rëndësia e sigurisë individuale në kuadër të Iniciativave Ndërkombëtare

Po të analizojmë trajtimin që institucionet ndërkombëtare i bëjnë sigurisë, arrijmë në konkluzionin se deri diku trajtohen elementë të veçantë të sigurisë njerëzore dhe jo të gjithë komponentët. Konkretisht, ishte Organizata e Kombeve të Bashkuara ajo që parashtroi iniciativën e përgjysmimit të varfërisë në të gjithë vendet e pazhvilluara përfshi edhe Shqipërinë deri në vitin 2015 nëpërmjet miratimit të “Deklaratës mbi Sfidat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit”. Kjo iniciativë u përkrah nga i gjithë komuniteti ndërkombëtar dhe në veçanti nga donatorët, të cilët morën përsipër ofrimin e ndihmave të tyre financiare për të ndihmuar vendet në zhvillim të arrinin këto objektiva.

Kjo nënkupton arritjen e 8 objektivave si në vijim:

- Eliminimi i varfërisë ekstreme dhe urisë;
- Kryerja nga të gjithë e arsimit fillor;
- Nxitja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i rolit të gruas;
- Ulja e vdekësisë foshnjore;
- Përmirësimi i gjendjes shëndetësore;
- Luftimi i SIDA-s, malaries dhe sëmundjeve të tjera;
- Sigurimi i qëndrueshmërisë së mjedisit;
- Zhvillimi i partneritetit global për zhvillimin.

Për të bërë të mundur arritjen e këtyre objektivave në vitin 2005 Ministrat e Financave të vendeve të G-8-ës u mblodhën në Londër dhe arritën një marrëveshje me Bankën Botërore, FMN dhe Bankën Afrikane të Zhvillimit

për anulimin e borxhit në shumën 40-55 miliardë dollarë ndaj vendeve shumë të varfra.

Këto iniciativa dëshmojnë për rëndësinë e padiskutueshme që siguria njerëzore ka marrë në nivel botëror dhe se bota gjithnjë e më shumë po globalizohet dhe po ndërgjegjësohet që të vetëm nuk mund t'i përballojmë sfidat. Kriza aktuale botërore vë në pikëpyetje nëse objektivat mund të arrihen ose jo deri në vitin 2015. Sipas Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, Z. Ban Ki-Moon⁶, pavarësisht sukseseve të arritura në drejtim të arritjes së OZHM-ve, progresi i përgjithshëm është ngadalësuar për shumicën e objektivave dhe rrezikohet përmbushja e tyre deri në vitin 2015.

Sipas raportit vjetor të progresit 2006-2007 të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim⁷, progresi i kryer nga Qeveria Shqiptare në lidhje me përmbushjen e Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit gjatë vitit 2007 ka pasur në përgjithësi ecuri pozitive, ku është bërë përmirësim në mjaft tregues lidhur me objektivat e arsimit, barazisë gjinore, vdekshmërisë foshnjore, shëndetin e nënës dhe mjedisin. Por, sipas raportit varfëria veçanërisht në zonat rurale, niveli i papunësisë dhe një shpërndarje më e barabartë e të ardhurave mbeten sfida për tu adresuar.

II. Kriza Financiare Botërore dhe efektet e saj në ekonominë reale të vendeve të botës

Jemi dëshmitarë që bota sot është e globalizuar dhe nuk ka sesi të habitemi përse kriza financiare që filloi në SHBA “infektoi” sistemin bankar dhe ekonominë e vendeve të botës me një ritëm shumë të shpejtë. Sipas Stephen Roach, përfaqësues i Morgan Stanley në Azi kur ekonomia dhe konsumatori amerikan kanë probleme kjo nënkupton pasoja për gjithë ekonominë botërore⁸.

⁶ <http://www.un.org/millenniumgoals/>

⁷ SKZHI, Raporti Vjetor i Progresit 2006-2007, f. 99

⁸ Civici, Adrian, “Globalizimi”, UET Press, 2009, f. 109

Data 14 Shtator 2008 do të shënonte zyrtarisht datën e tërmetit të sistemit bankar në Amerikë kur Banka Lehman Brothers shpalli falimentimin dhe kërkoi mbrojtjen nga ligji amerikan, që ka të bëjë me shpalljen e falimentimit dhe vënien nën administrimin shtetëror. Pas këtij veprimi kompania vlerësuese e cilësisë së bankave Moody's njoftoi se vlerësimi i Bankës ulej nga niveli "A2" në nivelin shumë të ulët « B3 »⁹.

Origjina e kësaj krize që ndryshe quhet si "*subprime mortgage meltdown*", daton në vitin 2006 kur vlera e kredive hipotekare pësoi rënie si rezultat i politikës që u përdor për dhënien e kredive çdo personi pa marrë parasysh aftësinë e tyre garantuese të kthimit të kredisë. U bë tashmë i njohur fenomeni që kredi mund të merrte madje edhe një babysitter, pa pasur garanci dhe të ardhura të mjaftueshme për kthimin e kredisë.

Për ata lexues që nuk janë ekonomistë të mirëfilltë, dhënia e kredisë nga një bankë bëhet mbi bazën e analizës së riskut të kredisë, që do të thotë të analizimit të aftësisë kthyesë të shumës së gjithë kredisë plus pagesës së interesave që aplikohen mbi këtë shumë. Ajo që ndodhi në SHBA nuk mori parasysh rreziqet në kthimin e kredive të cilat ishin evidente. Pas kësaj banke do të shihnim edhe banka të tjera si Merrill Lynch, Bearn Steams etj që do të falimentonin zinxhir jo vetëm në Amerikë, por edhe në botë.

Vetëm gjatë 2 tremujorëve të fundit të 2007-ës Banka "Goldman Sachs" në SHBA humbi 1.5 miliardë USD, Merrill Lynch 8.4 miliardë USD, Citigroup 6 miliardë USD, UBS Zvicër 11 miliardë franga zvicerane, Deutsche Bank 2.2 miliardë Euro etj, ndërkohë sipas vlerësimit të "Royal Bank of Scotland", humbjet e bankave në këtë periudhë janë rreth 500 miliardë dollarë¹⁰.

Për të normalizuar këtë situatë hapi i parë që ndërmoren qeveritë e shumë vendeve në botë ishte injektimi i likuiditetit nga ana e Bankave Qendrore të shumë vendeve në tregjet ndërbankare. Konkretisht, në 7 gusht 2007 në ndërhyrjen e

⁹ Civici, Adrian, "Globalizimi", UET Press, 2009, f. 109

¹⁰ Civici, Adrian, "Globalizimi", UET Press, 2009 f. 108

parë që u bë për këtë qëllim, Banka Qendrore Europiane hodhi në tregun europian 95 miliardë Euro, ndërsa Fed Amerikan që është ekuivalenti i Bankës Qendrore po në të njëjtën ditë injektoi në tregun financiar amerikan 24 miliardë USA¹¹.

Shumë shpejt kjo krizë do të transformohej nga një krizë financiare në një krizë ekonomike botërore duke prekur ekonomitë reale të vendeve të ndryshme. Sipas një vështrimi mbi ekonominë botërore i kryer nga FMN është parashikuar që prodhimi botëror në vitin 2009 do të ulet me 1.3%, ndërsa në vitin 2010 do të rritet me 1.9%¹². Ritmet e rritjes së ekonomisë botërore u ulën nga 5% që ka qenë për 5 vitet e fundit për të arritur në 3.4%. Inflacioni mesatar në nivel global arriti në 3.5% në vitin 2008 nga 2.1% që ishte në vitin 2007¹³.

Tabela dhe grafikët e mëposhtëm tregojnë se çfarë ndodhi me ekonomitë e vendeve më të zhvilluara në botë.


Vendet	Rritja e PBB-së		Norma Vjetore e Papunësisë		Norma Vjetore e Inflacionit	
	2007	2008	2007	2008	2007	2008
SHBA	2	1.1	4.6	5.8	2.9	3.8
Eurozonë	2.7	0.9	7.5	7.5	2.1	3.3
Gjermani	2.5	1.3	8.4	7.3	2.3	2.8
Greqi	4	2.9	8.3	8.3	3	4.2
Itali	2.9	-0.6	6.1	6.7	2	3.5
Japoni	1.9	-0.6	3.9	4	0	1.4

Ashtu siç e tregojnë indikatorët makroekonomikë ekonomitë në botë janë tronditur nga kriza financiare. Artikulli në vijim sqaron efektet që kriza pati në ekonomitë reale të vendeve, qe duket si një poqes zinxhir duke prekur jo vetëm financat e qeverive, por edhe ato të individit.

¹¹ Civici, Adrian, "Globalizimi", UET Press, 2009 f. 108

¹² FMN, World Economic Outlook, prill 2009, f. 16, <http://www.imf.org/external/pubs/ft/ëeo/2009/01/pdf/text.pdf>

¹³ Banka e Shqipërisë, Raporti Vjetor, 2008, fq. 15



Si rezultat i falimentimit të shumë bankave në Amerikë dhe Europë u shkurtuan vende pune duke rritur nivelin e papunësisë së këtyre vendeve. Rritja e papunësisë për një individ do të thotë më pak të ardhura dhe ulje e konsumit personal, apo familjar. Ulja e konsumit bën që çmimet e mallrave të bien duke sjellë më pak të ardhura për bizneset, apo qeveritë e vendeve. Për ato vende, ekonomitë e të cilave varen nga eksportet, ulja e çmimeve në rang botëror keqëson bilancin tregtar, e cila është llogaria që pasqyron eksportet dhe importet e një vendi. Situata mund të jetë më me avantazh për vendet, ekonomitë e të cilave varen nga importet duke përfituar mallrat apo shërbimet me çmime më të lira.

Si ekonomia amerikane ashtu edhe ajo e Eurozonës kanë njohur ritme të ulëta të rritjes së PBB-së: në SHBA nga 2% që ishte në vitin 2007 u ul në 1.1 % në vitin 2008, apo në Eurozonë nga 2.7 % që ishte në vitin 2007 në 0.9% në vitin 2008, çka tregon për një ngadalësim të kërkesës së brendshme.

Megjithëse çmimet u ulën për shkak të uljes së kërkesës së brendshme, përsëri çmimi i energjisë si dhe ai i ushqimeve të përpunuara u rrit. Kjo ka ndikuar në rritjen e inflacionit në të gjitha vendet sipas tabelës së mësipërme. Ajo që është shqetësuese në veçanti për Eurozonën është se inflacioni arriti në 3.3%, duke tejkaluar kufirin e lejuar nga Banka Qendrore Europiane që është 2%.

Efkti primar që kriza financiare pati ishte humbja e besimit nga individët ndaj sistemit financiar. Kjo u reflektua në tërheqjen e depozitave nga llogaritë bankare, apo në mos investimin e parave nëpër banka. Si rrjedhim, shumë qeveri të botës përfshi edhe Shqipërinë bënë deklarata publike, apo edhe nxitën popullatën që të mos nxitonin të tërhiqnin paratë, duke i garantuar se ishte pikërisht shteti që tashmë po ndërhynte duke injektuar likuiditete për t'i shpëtuar bankat nga kriza.

Si rezultat i mos pasjes së likuiditetit të nevojshëm, kredia në ekonomi ulet për shkak se bëhet më e shtrenjtë dhe nuk është e disponueshme në mënyrë të lirë. Kjo frenon bizneset për rritjen e aktivitetit të tyre ekonomik, duke pasur efekt në uljen e ritmeve të zhvillimit ekonomik, ose e thënë ndryshe në uljen e rritjes ekonomike.

Kjo situatë shkakton vështirësi për qeverinë, e cila për të stimuluar rritjen ekonomike i duhet të marrë para borxh. Për shkak të krizës financiare botërore, kredia në tregjet ndërkombëtare u shtrenjtua dhe shumë qeveri u gjendën përballë zgjedhjes së financimit të borxhit të tyre nëpërmjet instrumenteve financiarë në tregun e brendshëm, siç janë bonot e thesarit. Rritja e kërkesës për këto instrumente shkaktoi rritjen e normave të interesit, duke çuar në rritjen e shpenzimeve nga ana e Qeverisë për kryerjen e shërbimit të borxhit, e cila është në rolin e huamarrësit. Rritja e shpenzimeve nga ana e qeverisë do të thotë përkeqësim i deficitit buxhetor.

Një tjetër efekt negativ i krizës ka të bëjë me tkurrjen e investimeve të huaja. Investitorët kudo në botë duke pasur problemet e tyre të likuiditetit nuk janë të gatshëm të investojnë në vende të tjera. Kjo është dhe një ndër arsyet përse

qeveritë rritën ritmet e tyre të marrjes së borxhit, për të financuar rritjen ekonomike të sqaruar më lart.

Në të njëjtën kohë pakësimi i investimeve do të thotë më pak valutë e huaj në vend. Duke qenë se valuta pakësohet ajo bëhet më e shtrenjtë duke vendosur presione ndaj monedhës vendase, e cila zhvlerësohet. Seksioni në vazhdim do të analizojë ndikimin që kriza botërore pati në sigurinë njerëzore në Shqipëri.

2.1 Ndikimi i Krizës Botërore në Sigurinë Njerëzore

Ekonomia Shqiptare që nga fillimi i viteve '90 u largua nga sistemi i mbyllur e i centralizuar për të kaluar në një ekonomi tregu liberale. Mund të argumentohet se Shqipëria, një ekonomi tregu relativisht e re, ndodhet pranë superfuqive ekonomike globale siç është BE-ja dhe si rrjedhojë ka avantazhe në drejtim të faktorëve gjeopolitikë, siç është afërsia me tregjet europiane të stabilizuar dhe të zhvilluar, vendndodhja potenciale e favorshme në korridoret tranzitë kryesorë dhe aksesit i mundshëm në koleksionin e rëndësishëm të praktikave më të mire të ekonomive të zhvilluara.

Megjithëse sistemi financiar shqiptar është i konsoliduar, ekonomia shqiptare duke qenë një ekonomi e hapur nuk kishte sesi të qëndronte e izoluar nga efektet negative të krizës financiare, e cila u kthye në një krizë ekonomike mbarëbotërore. Qeveria Shqiptare nuk pranoi se Shqipëria është prekur nga kriza dhe madje shpejtoi të konkludonte se ekonomia u zhvillua duke kapur shifrën e rritjes ekonomike në nivelin rreth 8%.

Banka e Shqipërisë në raportin e saj vjetor për vitin 2008 u shpreh se performanca e sistemit bankar për vitin 2008¹⁴, vlerësuar në këndvështrimin e rezultatit neto ka qenë dukshëm më e dobët sesa gjatë vitit 2007, për shkak të shpenzimeve që kryen bankat për provigjionet, veçanërisht në gjysmën e dytë të vitit. Deri në muajin Shtator 2008 gjendja e likuiditeteve paraqitej e kënaqshme, për tu përkeqësuar më pas si rezultat i tërheqjes së depozitave nga ana e individëve, duke krijuar vështirësi likuiditeti.


¹⁴ Banka e Shqipërisë, Raporti Vjetor, 2008, f. 107

Në të njëjtën kohë kredia për ekonominë gjatë vitit 2008 është zgjeruar me ritme vjetore më të ngadalta se një vit më parë ; vetëm në muajin Dhjetor 2008 kredia për ekonominë pasqyroi rritjen më të ulët gjatë pesë viteve të fundit duke shënuar një normë rritje vjetore në 35%¹⁵.

Ndonëse gjatë viteve të fundit ekonomia shqiptare është karakterizuar nga stabiliteti makroekonomik duke pasur rritje ekonomike rreth nivelit 6% në vit, normë inflacioni në kufijtë e lejuar 2-4%, normë papunësie që ka ardhur duke u ulur, përsëri problemet kanë qenë të shumta dhe vazhdojnë të jenë të cilat ndikojnë drejtpërdrejtë te individit duke rrezikuar sigurinë e tij.

Po të hedhim një vështrim tek treguesit makroekonomikë në vendet e rajonit konkludojmë se asnjë ekonomi nuk ka mbetur e paprekur.

Vendet	Rritja Vjetore e PBB-së	Inflacioni Vjetor	Norma e Papunësisë	Llogaria Korente	Deficiti Buxhetor
Itali	-0.6	3.5	6.7	-2.2	-2.8
Greqi	2.9	4.2	8.3	-13.4	-3.4
Maqedoni	5.8	8.3	33.9	-12.9	3
Serbi	6.1	13.6	14.2	-20.7	-0.3
Kroaci	3.1	6.1	13.3	-10.9	-2.1
Turqi	3.2	10.4	15.2	-6	-1.4



Burimi: Banka e Shqipërisë, Raporti Vjetor 2008, f. 19

¹⁵ Banka e Shqipërisë, Raporti Vjetor, 2008, f. 75

Për sa i përket ekonomisë shqiptare ndonëse nuk u prek nga kriza në ato nivele që u prekën ekonominë botërore, përsëri mund të thuhet se treguesit makroekonomikë pësuan luhatje. Konkretisht, sipas raportit vjetor për vitin 2008 të Bankës së Shqipërisë në gjashtë mujorin e parë inflacioni u rrit në 4.6% , duke e tejkaluar tolerancën e objektivit të Bankës së Shqipërisë. Arsye e kësaj rritje vjen si rezultat i rritjes së çmimeve të disa prej lëndëve të parë në tregjet botërore, si drithi dhe nafta, në prani të ofertës së pamjaftueshme vendase për prodhime bujqësore dhe të krizës energjetike.

Në gjashtë mujorin e dytë të vitit 2008, po sipas raportit të Bankës së Shqipërisë norma e inflacionit u karakterizua nga vlera të ulëta të inflacionit në nivelin 3.4%, e cila ishte afër kufirit të poshtëm të normës së lejuar nga Banka e Shqipërisë. Kjo shpjegohet me rënien e çmimeve të produkteve ushqimore, si dhe rënien e çmimit të karburanteve, si rezultat i uljes së kërkesës.

Problemi kryesor në ekonominë shqiptare është papunësia, e cila ka qenë në norma të larta edhe përpara krizës botërore. Gjatë 10 viteve të fundit papunësia në Shqipëri është ulur nga 18.4% në vitin 1999 në 12.7% në vitin 2008¹⁶ dhe kjo i atribuohet rritjes ekonomike, e cila ka qenë e qëndrueshme rreth 6% në vit. Megjithëse ecuria e papunësisë ka qenë pozitive, ajo mbetet e lartë krahasuar me normën e papunësisë së Europës Juglindore, e cila është 8.8%¹⁷, apo me normën e papunësisë botërore rreth 6% dhe sot për sot ka një debat ndërmjet shumë aktorëve (shoqëri civile, akademikë, forcave politike etj) se norma e papunësisë mund të jetë më e lartë, pasi jo çdo i papunë deklarohet si punëkërkues.

Ekonomia Shqiptare është një ekonomi ku një nga burimet e rritjes e përbëjnë remitancat, apo siç njihet ndryshe dërgesat e emigrantëve. Llogaritet që 27.5% e popullsisë jetojnë jashtë vendit duke siguruar më shumë se 15% të GDP-së së

¹⁶ Ministria e Financave, indikatorët makroekonomikë, www.minfin.gov.al

¹⁷ International Labor Organization (ILO), Global Employment Trends, January 2009, http://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/—dgreports/—dcomm/documents/publication/wcms_101461.pdf

Shqipërisë në 10 vitet e fundit¹⁸. Në raportin vjetor të Bankës Botërore të vitit 2006 deklarohet se pa këto të ardhura shqiptarët do të jetonin me më pak se 2 usd në ditë. Të jesh i papunë do të thotë që më shumë persona aksesojnë punësimin informal, apo mund të përfshihen në aktivitete kriminale të tilla si vjedhjet, droga, trafikimi ilegale etj, duke vënë në rrezik edhe sigurinë e brendshme të një vendi.

Megjithatë gjatë dy viteve të fundit, si pasojë e krizës ekonomike globale, dërgesat e parave nga emigracioni janë ulur duke shkaktuar probleme sidomos në zonat rurale ku këto të ardhura janë burimi kryesor me 40% të të ardhurave totale. Konkretisht, sipas raportit vjetor të Bankës së Shqipërisë për vitin 2008 dërgesat nga emigrantët ranë me 16%.

Gjithashtu, një tjetër tregues makroekonomik që tregoi preken e ekonomisë shqiptare nga kriza e dëshmon edhe deficitin tregtar, i cili në vitin 2008 arriti vlerën e 2.4 miliardë euro, duke qenë 14.8% më i lartë se në vitin 2007¹⁹. Raporti vijon se edhe deficitin buxhetor është përkeqësuar duke u rritur në 5.66 % ndaj PBB-së në vitin 2008 nga 3.49% ndaj PBB-së në vitin 2009.

2.2 Kriza Financiare Botërore dhe krizat e tjera globale

Bota sot po përballë me disa kriza njëherazi, veçanërisht në 10-vjeçarin e fundit. A është një rastësi ndodhja njëherazi e këtyre krizave, apo bota drejtohet nga një model i gabuar i zhvillimit, që konsiston në ndërhyrjen më pak nga ana e shtetit dhe lënies dorë të lirë të zhvillimit të tregut? Cilado të jenë shkaqet, një gjë është e sigurt se siguria njerëzore sa vjen dhe përkeqësohet.

Kriza financiare botërore jo vetëm që ju shtua listës së krizave globale, por i përkeqësoi edhe krizat e tjera. Sipas Zv/Presidentit të Bankës Botërore, Joy Phumaphi, vlerësohet se si rezultat i krizave që kanë prekur globin 100 milionë njerëz

¹⁸ Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, Siguria Ekonomike në Shqipëri, 2009, f. 5

¹⁹ Banka e Shqipërisë, Raporti Vjetor, 2008, f. 53

u varfëruan më shumë dhe 44 milionë të tjerë vuajtën nga të keqshqyerit. Po sipas Z. Phumaphi, vlerësohet se ulja me 1% e rritjes ekonomike mund të çojë në varfëri 20 milionë njerëz të tjerë. Konkretisht, sipas vlerësimit të Bankës Botërore thuhet se në vitin 2009 rritja ekonomike e vendeve në zhvillim do të ulet nga 6.4% në 4.5%²⁰.

Përpara se të ndodhte kriza financiare botërore, vëmendja e fuqive më të zhvilluara në botë ishte përqendruar te krizat e tjera globale të tilla, si kriza ushqimore, energjetike, ekologjike. Kombet e Bashkuara në bashkëpunim me Institucione Ndërkombëtare të tilla si Banka Botërore, FMN etj. apo dhe me qeveritë e vendeve, nxituan të ndërmarrin iniciativa në nivel botëror për të mos lejuar përhapjen e krizave dhe dominimin e tyre dhe si rrjedhim për t'i ofruar një siguri më të madhe individit.

Por duket se kriza financiare botërore fundosi edhe më keq krizat e tjera globale. Vëmendja tashmë u zhvendos nga prioritetet e vendosura në kuadër të iniciativave botërore për eliminimin e krizave globale tek kriza financiare, e cila shume shpejt u kthye në një krizë ekonomike botërore. Cilat janë këto kriza globale që po kërcënojnë globin tonë dhe sigurinë njerëzore?

2.2.1. Kriza ushqimore

Në këto dy vitet e fundit çmimet e produkteve bazë ushqimore si orizi, gruri, misri, mielli, vajrat e ndryshëm etj. pothuajse janë dyfishuar duke sjellë rrezikun e urisë për miliona njerëz në botë, veçanërisht për vendet e varfra. Çmimet e drithërave në tregjet globale në shkurt të vitit 2008 në krahasim me tre vjet më parë, u rrit me 181%, kurse çmimet e produkteve ushqimore me 83% për të njëjtën periudhë²¹.

²⁰ Phumaphi, Joy, "Impakti i Krizes Globale, përgjigja e Bankës Botërore dhe Nevoja për Vazhdimin e Investimeve në Zhvillimin Njerëzor", Banka Botërore, 2009

²¹ Angjeli, Anastas, Kriza e Ekonomisë Globale dhe Implikimet në Ekonominë Shqiptare

Një dukuri akoma më shqetësuese është përdorimi i produkteve ushqimore për prodhimin e bio-karburanteve, në kuadër të pakësimit të burimeve të energjisë në botë. Vetëm SHBA tërhoqi nga tregu ushqimor dhe përdori për bioetanol mbi 140 milionë ton misër, ndërkohë që dhe BE planifikon që mbi 10% të nevojave të tij energjetike t'i plotësojë në të njëjtën mënyrë²².

Banka Botërore njofton se përpara shfaqjes së krizës ushqimore në botë numëroheshin rreth 926 milionë veta të kequshqyer, ndërsa tani kjo shifër ka arritur në mbi 1 miliardë njerëz. Banka Botërore vazhdon më tej se megjithëse çmimet e ushqimeve ranë në vitin 2008 si pasojë e uljes së kërkesës, disa çmime vazhdojnë të jenë të larta si psh, gruri dhe kriza aktuale financiare kërcënon edhe më tej pamundësinë për të siguruar ushqim.

Rritja e çmimeve të ushqimeve pati efekte në inflacion. Sipas një studimi të Bankës Botërore, inflacioni në vendet jo anëtare të OECD u rrit nga 5% në 2006 në 8.1% në 2008²³.

Kriza ushqimore çon në varfërinë e individit, efektet e të cilit ndjehen në arsimimin e tij dhe situatën shëndetësore. Individët që bëhen pre e rritjes së çmimeve të ushqimeve detyrohen të mos furnizohen me ushqime cilësore, ulin sasinë e të ushqyerit, e cila çon në kequshqyrjen e tyre. Kjo shkakton probleme shëndetësore pasi shumë kalori që një person duhet të marrë në ditë nuk i merr dot më. Në të njëjtën kohë, kjo situatë çon dhe në përkeqësimin e arsimimit të individit pasi duke pasur një buxhet më të vogël nuk mund të përballojë kostot e shkollimit si taksa e shkollës, transporti etj.

Varfërimi i popullatës rrezikon që ta çojë vendin në luftë civile. Mbi 36 vende rrezikojnë të bien në luftë civile, si pasojë e krizës së ushqimeve²⁴. Banka Botërore i ka bërë apel shumë

²² Civici Adrian, Kriza Financiare apo Krizë Globale, Economicus 2, UET, 2008, fq. 6

²³ <http://siteresources.worldbank.org/DEVCOMMEXT/Resources/Food-Fuel.pdf?resourceurlname=Food-Fuel.pdf>

²⁴ Civici Adrian, Kriza Financiare apo Krizë Globale, Economicus 2, UET, 2008, f. 6

vendeve të botës që të marrin masa për të subvencionuar shtresat në nevojë për të përballuar rritjen e çmimeve të ushqimeve, skemë e cila deri diku është zbatuar edhe në Shqipëri.

Edhe Shqipëria nuk mund të ngelej e paprekur nga efektet e krizës ushqimore duke pasur parasysh varësinë e madhe të Shqipërisë nga produktet ushqimore të importuara, veçanërisht drithërat dhe ato të përpunuara, të cilat lidhen më pas me sigurinë dhe garancinë ushqimore që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në sigurinë njerëzore²⁵. Treguesit e bërë publik nga INSTAT dëshmojnë se rritja e çmimeve në tremujorin e parë të këtij viti shënoi një rritje të dukshme (indeksi i çmimeve të konsumit në muajin mars 2008 arriti 102.4% kundrejt muajit dhjetor 2007, duke bërë që inflacioni të tejkalonte objektivin e parashikuar dhe të arrinte shifrën 4.6%²⁶.

2.2.2 Kriza energjetike

Paralelisht me krizën ushqimore bota është lëkundur nga një tjetër krizë siç është ajo e rritjes së çmimit të naftës. Burimet për energji janë të kufizuara dhe rritja e çmimit të naftës vetëm sa e përkeqëson këtë sektor. Veçanërisht për ato vende që janë neto importuese të energjisë janë të parat që e ndjejnë këtë efekt ku futet edhe Shqipëria. Kur rritja e çmimit të naftës arriti shifrën 1 fuçi naftë = 100 \$ SHBA dhe vende të tjera të Europës u alarmuan dhe bënë thirrje për uljen e tij.

Ritmet e rritjes nuk u ndalën për të shënuar rritjen rekord atë të 134 US \$ fuçi në mes të muajit Qershor 2008²⁷. Kjo erdhi si pasojë e dobësimit të monedhës amerikane, të rritjes së çmimeve të lëndëve të para. Kjo situatë u përmirësua disi pasi në tremujorin e fundit të vitit 2008 çmimi i naftës ra me 50%, si rezultat i uljes së ritmeve të zhvillimit ekonomik në

²⁵ Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, Siguria Ekonomike në Shqipëri, 2009, f. 7

²⁶ Angjeli, Anastas: “Kriza e Ekonomisë Globale dhe Implikimet në Ekonominë Shqiptare”, Revista Economicus 2, UET, 2008, f. 27

²⁷ Banka e Shqipërisë, Raporti Vjetor, 2008, f. 22

vendet e OECD-së si dhe vlerësimit të monedhës amerikane.

Nuk ka sesi që këto efekte negative të mos ndihen në konsumatorin shqiptar. Rritja e çmimit të naftës dëmton në radhë të parë zhvillimin e biznesit privat për tu transferuar më pas tek konsumatori, i cili është ai që do të paguajë më shtrenjtë këto pasoja. Rritja e çmimit të naftës çon në rritjen e çmimit të energjisë dhe përveç kësaj në shtrenjtimin e mallrave dhe shërbimeve të prodhuara nga sektori privat. Çmim më i lartë do të thotë më shumë shpenzime për konsumatorin dhe pakësimin e të ardhurave të tij. Kjo është arsyeja ndoshta që shumë vende, përfshirë dhe Shqipërinë, po kërkojnë burime alternative për energjinë me kosto tepër të ulët dhe që nuk kushtëzohen nga importi (p.sh. përdorimi i erës për energji etj.).

2.2.3 Kriza ekologjike

Rritja e shpejtë në prodhimin e ndotësve ka çuar në rritjet e niveleve të gazrave që dërgohen në shtresën e ozonit. Përqendrimet e dioksidit të karbonit (CO₂) janë rritur me rreth 30% që nga fillimi i revolucionit industrial dhe më shumë se gjysma e kësaj rritje është shfaqur që prej vitit 1960²⁸. Për shkak të rritjes së të ardhurave (që ndikojnë konsumin) dhe rritjes rapide të popullsisë, rritja e këtyre ndotësve do të përshpejtohet në të ardhmen nëse nuk ndërmerren reforma në nivel ndërkombëtar.

Një studim i përbashkët i bërë nga Organizata Ndërkombëtare Meteorologjike dhe Programi i Mjedisit i Kombeve të Bashkuara parashikon se nëse tendencat aktuale të dërgimit të ndotësve vazhdon do të thotë që temperaturat globale do të rriten 0.35 grade celcius në çdo dhjetë vjet ose 3 gradë celcius në fund të këtij shekulli²⁹. Ky studim arriti në konkluzionin që për të stabilizuar përqendrimet e dioksidit të

²⁸ Todaro, Micheal P, Zhvillimi Ekonomik, Pearson Education, 2006, f. 790

²⁹ Todaro, Michael P, Zhvillimi Ekonomik, Pearson Education, 2006, f. 790

karbonit dhe ndotësve të tjerë në nivelet aktuale është e nevojshme ulja e menjëhershme në dërgimin e ndotësve nga aktivitetet njerëzore për më shumë se 60%.

Ngrohja globale nuk është një supozim, por një realitet. Ajo ndihet nga ne të gjithë. Është evidente se temperaturat sa vijnë dhe rriten çdo vit. Zjarret në pyje, përmbytje masive, sëmundje të reja të panjohura ku më e fundit është A H1N1, humbja e biodiversitetit e shkaktuar nga shkatërrimi i pyjeve tropikale, rritja e prodhimit industrial në vendet e zhvilluara janë faktorët që vërtetojnë se globi ynë ndihet çdo ditë dhe më i kërcënuar.

Megjithëse komuniteti ndërkombëtar u ndërgjegjësua për të marrë masa për minimizimin, siç ishte takimi i Samitit të Rio de Janeiro në vitin 1992 dhe më pas Samiti i Kyotos në Japoni ku u miratua traktati mbi uljen e gazrave ndotës nga vendet në zhvillim në nivelet e para viteve 1990 deri në vitin 2010, përsëri ajo që ngelet sfidë është zbatimi i angazhimeve të marra përsipër. Kriza aktuale botërore shtron disa pikëpyetje në drejtim të krizës ekologjike ? A do të vazhdojnë vendet të përmbushin detyrimet që rrjedhin nga samitet ndërkombëtare për përmirësimin e efekteve negative nga ngrohja globale së bashku me të gjitha sfidat e tjera që burojnë nga kriza aktuale botërore ? Gjithsesi, me trendet aktuale të ekonomisë botërore mund të ketë vonesa në përmbushjen e këtyre detyrimeve dhe përgjysmimi i varfërisë deri në vitin 2015 mund të vonohet edhe më tej.

III. Strategjia e ndjekur nga Qeveria Shqiptare në kuadër të krizës aktuale botërore

Ndërkohë që qeveritë e vendeve të ndryshme në botë filluan të hartojnë strategji anti-krizë për përballimin e situatës se krijuar, Qeveria Shqiptare nëpërmjet deklaratave të shumta mediatike nuk pranoi që vendi të jetë prekur nga kriza. E kundërta deklarohet nga forcat politike opozitare, akademike, Banka e Shqipërisë, analistë, të cilët dhanë alarmin se ekonomia shqiptare nuk kish sesi të shpëtonte nga efektet e

kësaj krize dhe se Qeveria duhet të mendonte seriozisht për hartimin e masave apo paketës anti-krizë.

Humbja e besimit në sistemin bankar që u transmetua në rënien e likuiditetit, rënia e remitancave, thellimi i deficitit tregtar, apo dhe indikatorë të tjerë janë fakte reale që tregojnë se edhe ekonomia shqiptare pësoi tkurrje. Në një ekonomi si kjo e jona, e cila 80% të shkëmbimeve të saj tregtare i kryen kryesisht me Italinë dhe Greqinë, nuk kishte sesi të mos prekej kur këto dy vende u prekën nga kriza.

Duke lënë mënjanë debatin jemi prekur apo jo nga kriza, pyetja që shtrohet është se cilat ishin masat që Qeveria Shqiptare ndërmori veçanërisht, në momentin e shfaqjes së krizës së besimit në sektorin bankar?

Ashtu siç deklaroi Banka e Shqipërisë në raportin e saj vjetor për vitin 2008 dinamika e zhvillimeve ndërkombëtare në tremujorin e fundit të vitit u reflektua në sistemin bankar në formën e krizës së besimit ndaj institucioneve bankare, gjë e cila shkaktoi një rënie të shpejtë të likuiditetit.

Masat që ndërmori Banka e Shqipërisë ishin injektimi i likuiditetit duke blerë bono thesari dhe obligacione, si dhe marrja e masave që bankat e nivelit të dytë të përmirësonin indikatorët e aktivitetit bankar (kredidhënia, menaxhimi i riskut, kreditë e këqija etj).

Banka e Shqipërisë organizoi një fushatë sensibilizuese kundrejt tërheqjes së depozitave nga ana e qytetarëve, duke i nxitur ata që të mos tërheqin depozitat pranë bankave mbi bazën e dhënies së garancisë se sistemi ynë bankar është solid dhe se nuk ekzistonte rreziku i falimentimit të bankave, siç ndodhi në mbarë botën. Ky qëndrim i Bankës së Shqipërisë duket se solli rezultat pasi shumë shpejt situata e likuiditetit në sistemin bankar u normalizua.

Nga ana tjetër Qeveria Shqiptare duket se iu përmbajt deklarave të saj zyrtare se nuk jemi të prekur nga kriza dhe nuk ndërmori ndonjë masë për të pakësuar shpenzimet e saj. Së fundmi, madje Qeveria po mburret se ka realizuar të ardhura nga privatizimet dhe se do të përdorë këto të ardhura për të ulur borxhin publik dhe për investime, duke garantuar shqiptarët se rritja ekonomike do vazhdojë të jetë e lartë.

IV. Konkluzione

Ashtu siç e tregoi dhe ky artikull koncepti i sigurisë nuk përmbledhet vetëm tek përkufizimi i tij si siguri e brendshme, por shtrihet edhe më tej. Mbas Luftës së Ftohtë Qeveria Amerikane hodhi konceptin e sigurisë njerëzore që përfshin një sërë komponentësh si : siguria ushqimore, siguria mjedisore, siguria shëndetësore, siguria njerëzore, siguria politike, siguria e komunitetit dhe siguria politike. Vëmendja nuk përqendrohet tek shteti, por tek individi.

Këtë e tregojnë më së miri edhe iniciativat ndërkombëtare që gjithnjë e më shume po i kushtojnë rëndësi mirëqenies së individit. Kështu p.sh., Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit, të iniciuara nga Kombet e Bashkuara, kanë në thelb përmirësimin e mirëqenies së individit. Termi i sigurisë njerëzore është pothuajse i panjohur në Shqipëri dhe këtë gjë e dëshmon mostrajtimi i tij në dokumentet e strategjive apo politikat e qeverisë.

Kriza botërore financiare, e cila e pati zanafillën në SHBA në fillim për tu përhapur më pas në të gjithë botën tregoi sesa e globalizuar është bota. Efekti më negativ ishte transformimi i kësaj krize në krizën ekonomike, duke prekur ekonomitë reale të vendeve. Edhe Shqipëria duke qenë një ekonomi e hapur nuk ka sesi të ngelej e paprekur nga kjo krizë, pavarësisht se Qeveria Shqiptare nuk pranoi se kishte hyrë në krizë dhe nuk ndërmori ndonjë strategji anti-krizë.

Ekonomia Shqiptare u godit fillimisht nga humbja e besimit të individëve, apo dhe institucioneve ndaj sistemit bankar duke tërhequr depozitat e tyre dhe duke krijuar vështirësi për gjendjen e likuiditetit. Por, ishte ndërhyrja e menjëhershme e Bankës së Shqipërisë, e cila në bashkëpunim me bankat e nivelit të dytë normalizoi situatën.

Ekonomia Shqiptare duke qenë një ekonomi, e cila mbështetet në dërgesat e emigrantëve u prek nga rënia e tyre si rezultat i krizës. Kjo ndikoi familjet shqiptare të cilët ndonëse ishin të papunë mbështeteshin tek këto remitanca dhe kjo situatë çon në varfërimin e mëtejshëm të tyre dhe në pakësimin e të ardhurave të tyre. Bilanci tregtar i Shqipërisë u

përkeqësua duke u thelluar me tej. Në kushtet e krizës eksportet kanë vështirësi të gjejnë treg, për shkak të rënies së kërkesës në vendet e botës dhe importet janë bërë më të shtrenjta. Kjo çoi në rritjen e huamarrjes së Qeverisë, e cila rriti edhe më shumë shpenzimet duke çuar në thellimin e deficitit buxhetor.

Kredia nga sektori bankar pësoi tkurrje duke vënë në vështirësi biznesin privat, individët dhe duke çuar në një rënie ekonomike.

Të gjitha këto efekte ndihen tek ne qytetarët duke vënë në rrezik sigurinë tonë ekonomike. Por historia nuk përfundon këtu; bota po përballët me kriza të tjera si kriza ushqimore, kriza energjetike, kriza ekologjike, të cilat po t'i mbledhim do t'i fusnim në një kuti me simbolikën "Rreziqet", të cila godasin drejtpërdrejtë individin.

Një gjë është e evidente se siguria njerëzore është e kërcënuar dhe bota është kaq e globalizuar sa një goditje që ndodh prek në mënyrë zinxhir elementë të tjerë.

V. Rekomandime

Ashtu siç u përmend disa herë në këtë artikull koncepti i sigurisë njerëzore sa i rëndësishëm po aq i panjohur dhe i patrajtuar është nga Qeveria Shqiptare. Qeveria Shqiptare ashtu si qeveritë e shumë vendeve të tjera e gjendur përballë krizave të ndryshme botërore që kanë prekur njëherazi gjithë globin tonë nuk mund t'i eliminojë ato, por mund të marrë masa minimizuese duke shfrytëzuar potencialet e saj. Në këtë kuadër ajo që rekomandohet *së pari* është që Qeveria të trajtojë me prioritet çështjen e sigurisë njerëzore dhe ta bëjë pjesë të politikave dhe strategjive të saj qoftë sektoriale apo kombëtare.

Së dyti, Qeveria Shqiptare duhet të rrisë aftësinë e saj prodhuese duke shfrytëzuar bujqësinë, e cila është lënë pas dore për vite të tëra. Në këtë mënyrë Qeveria mund të sigurojë një sasi të konsiderueshme të prodhimeve ushqimore brenda vendit, gjë e cila do të ndikojë në përmirësimin e sigurisë ushqimore jo vetëm nga ana cilësore, por edhe të kostos, duke

ndikuar në përmirësimin e të ardhurave të qytetarëve. Në të njëjtën kohë Qeveria Shqiptare duhet të zhvillojë edhe sektorë të tjerë që janë lënë pas dore si p.sh., minierat me qëllim përmirësimin e standardit të jetesës së qytetarëve.

Së treti, Qeveria Shqiptare pavarësisht krizës ekonomike botërore duhet të trajtojë me seriozitet sfidat që lindin në kuadër të komponentëve të tjerë të sigurisë si ajo mjedisore, politike, individuale apo edhe komunitare.

Duke qenë se të gjitha objektivat që Shqipëria aspiron të tilla si integrimi në BE, NATO, Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit janë të integruara në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, rekomandohet që siguria njerëzore të përfshihet brenda kësaj strategjie dhe komponentët e saj të veçantë të bëhen pjesë e strategjive sektoriale.

Bibliografia:

Angjeli, Anastas: “Krizja e Ekonomisë Globale dhe Implikimet në Ekonominë Shqiptare”, *Economicus* 2, UET, 2008, f. 24-29

Arnold Wofers, “National Security as an Ambiguous Symbol”, *Political Science Quarterly*, Vol 67, No. 4 (Dec 1952) f. 482.

Banka e Shqipërisë, Raporti Vjetor, 2008, f. 15, 19, 22, 53, 75, 107

Banka Botërore, “Rritja e çmimeve të ushqimeve dhe energjisë”, 2008, f. 2

<http://siteresources.worldbank.org/DEVCOMMEXT/Resources/Food-Fuel.pdf?resourceurlname=Food-Fuel.pdf>

Civici, Adrian, *Globalizimi*, 2009, f. 108-109

Civici, Adrian: “Krizë Financiare apo Krizë Globale”, *Economicus* 2, UET, 2008, f. 6

Dan, Henk, “Human Security: Relevance and Implications”, *Parameters*, Summer 2005, p 91-106

FMN, *World Economic Outlook*, prill 2009, f. 16.

<http://www.imf.org/external/pubs/ft/ëco/2009/01/pdf/text.pdf>

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, *Siguria Njerëzore në Shqipëri*, 2009, f. 1-23

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, Mbi Zhvillimin e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare, Toena, 2007, f. 7-10

International Labor Organization (ILO), Global Employment Trends, January 2009,

http://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/—dgreports/—dcomm/documents/publication/wcms_101461.pdf

Joy, Phumaphi: "Impakti i Krizës Globale, përgjigjja e Bankës Botërore dhe nevoja për vazhdimin e investimeve në zhvillimin njerëzor", Banka Botërore, 2009

<http://beta.worldbank.org/climatechange/node/3712>

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, Raporti vjetor i Progresit 2006-2007, 2008, f. 99

Todaro, Michael P, Zhvillimi Ekonomik, Pearson Education, 2006, f. 790

Evis Gjebrea është pedagoge pranë Universitetit European të Tiranës si dhe kërkuese e asociuar pranë Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim në kuadër të Rrjetit të Menaxhimit të Sigurimit

GJEN. PËLLUMB QAZIMI

KOMBI SHQIPTAR ASNJËHERË AGRESOR

Shqipëria - arenë luftërash

Gadishulli ku shtrihet Shqipëria në shekuj ka qenë arenë luftërash. I tillë mbeti edhe për dhjetë vitet e fundit të shekullit të kaluar. Sipas Piro Mishës ai përbën një tokë mes lindjes dhe perëndimit, mes Evropës dhe Azisë, apo mes të djeshmes dhe të sotmes, një urë që lidh këto dy botë.¹ Në këtë truall janë zhvilluar luftëra nga Fuqitë e Mëdha dhe mes vendeve ballkanike, por përherë raporti ka anuar te të parët. Në këtë kuadër vetë Shqipëria nuk kish si të shmangej. Përkundrazi, ka qenë arenë e truall i përshtatshëm ndeshjeje mes fuqish. Një gjë e tillë natyrshëm do të kishte edhe pasoja afatgjata në ecurinë e zhvillimin e vendit.

Në shekujt e dymbëdhjetë e të trembëdhjetë në tokat shqiptare ndeshen disa nga forcat më të mëdha të kohës, ndërkohë që arbitri nisin të shfaqen gjithnjë e më dendur nëpër kronika, ndonëse thuajse gjithnjë si protagonistë anësorë e dytësorë të ngjarjeve. Është një periudhë e ngjeshur, e turbullt, e ngatërruar, e mbushur me luftëra, por edhe me shkëmbime; me largime, por edhe me afrime e bashkime.² Romakët e pas tyre bizantinët dhe më tej bullgarët e serbët përdorën për kalim apo fushëbeteje territorin shqiptar. E njëjta pamje vazhdon edhe në shekujt në vijim nën Perandorinë Osmane. Në këtë të fundit trojet shqiptare emërtohen si tokë e zgjedhur për trazira dhe kryengritje.³ Këto

¹ Misha, Piro, Duke kërkuar Rrënjët ose..., Kthimi i Shqiptarëve në Histori, ese, TOENA, Tiranë, 1997, f. 14

² Misha, Piro, Duke kërkuar Rrënjët..., f. 15

³ “Ushtritë otomane hynin me kujdes të madh në ato vende fizikisht torturues, të krijuara për guerilas, të banuara nga popullsi gjysmë të egra, pjesëtarët e së cilës, që në fëmëni janë ushtruar në artin e luftës partizane e që jeta e vet iu dhimbset aq pak, sa edhe e të tjerëve. Shih: Remerand Gabriel, Pashai Janinës, GLOBUS R, Tiranë, 2004, f. 22

troje në historinë e tyre kanë ofruar vetëm një varg të gjatë rebelimesh kundër qeverisjes së sulltanëve. E veçantë për nga mënyra e organizimit, realizimit është periudha e Skënderbeut. Edith Durham pohon se në trojet e veta Skënderbeu nuk u thye kurrë. Dy sulltanë me radhë u betuan se do ta zhduknin rebelin shqiptar nga faqja e dheut.⁴ Ushtri të mëdha u angazhuan kundër tij, por pa sukses. Sa jetoi Skënderbeu, Shqipëria qe e lirë. Sipas autores, turqit u ndihmuan vetëm nga vdekja e Skënderbeut më 1468.⁵ Por me vlera jo të vogla paraqitet edhe periudha e Ali Pashë Tepelenës. Ai gjatë sundimit të tij më tepër ndeshej ushtarakisht dhe jo ushtarakisht me Portën e Lartë, sesa plotësonte detyrimet ndaj saj. Më tepër mashtronte se sa bashkëpunonte për paqe. Më tepër mendonte se si do të krijonte aleanca, por nuk harronte të vendoste se kur do t'i prishte ato, për të filluar të reja.

Trojet shqiptare vazhduan të ishin arenë betejash e përpjekjesh luftarake deri në fund të shekullit XIX e të fillimit të shekullit XX duke kulmuar me Lidhjen e Prizrenit dhe me kryengritjet shqiptare të asaj periudhe. Në vitin 1912 shpërtheu Lufta e Parë Ballkanike. Në këtë kohë Shqipëria shpalli pavarësinë. Prania osmane në territorin shqiptar shënoi fundin e ekzistencës pesëshekullore. Gjatë Luftës së Parë Botërore Shqipëria ishte përcaktuar neutrale, por territori i saj u shndërrua në fushëbetejë për vende e fuqi të tjera. Më parë ishte provuar prania ushtarake e fqinjëve. Me gjithë neutralitetin e Shqipërisë, pjesë të vendit u pushtuan nga trupa të huaja.⁶ Pas largimit të princ Vidit nga Shqipëria në shtator 1914, territori shqiptar u bë fushëbeteje për fqinjët dhe objekt këmbimi për Fuqitë e Mëdha. Greqia u lejua të pushtonte Korçën dhe Gjirokastrën, Italia do të merrte portin e Vlorës dhe ishullin e Sazanit. Në të njëjtën kohë serbët dhe malazezët do të përparonin deri në Elbasan, Tiranë dhe Shkodër. Në të

⁴ Durham, Edith, Brenga e Ballkanit dhe vepra të tjera për Shqipërinë dhe Shqiptarët, Shtëpia Botuese "8 nëntori", f. 21

⁵ Durham, Edith, Brenga e Ballkanit..., f. 21

⁶ Samuel Haroe, Rescue in Albania-One hundred percent of Jews in Albania rescued from Holocaust, Brunswick Press Cathedral City, California, 1997, f. 25

vërtetë kjo do të thoshte mosekzistencë e atij shteti që vetëm më pak se tre vite më parë pati shpallur pavarësinë. Disfata e serbëve në vitin 1915 solli zëvendësimin e tyre me pushtimin austro-hungarez, i cili u shtri deri në Shkodër e Durrës. Ndërkohë në Vlorë vazhdonin të ishin italianët. Në të njëjtën periudhë, anglo-francezët duke qenë në konflikt me mbretin Kostandin të Greqisë, ua besuan trupave italiane pushtimin e krahinës së Gjirokastrës e madje edhe të Janinës, dhënë Greqisë në vitin 1913. Në të njëjtën periudhë trupat franceze arritën të drejtoheshin drejt Korçës, duke e marrë atë në tetor 1916.⁷ Në fund të vitit 1916, Shqipëria përveç se arenë lufte, ishte pre e pushtimit, duke u shndërruar realisht në vend i pushtuar. Në periudhën pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore, Shqipëria përsëri u bë teatër i pranisë ushtarake të huaj dhe objekt pushtimi. Nga shtatori i vitit 1918, me përjashtim të krahinës së Korçës dhe qytetit të Shkodrës, Shqipëria u pushtua nga ushtria italiane, sepse vendi duhej të mbahej nga trupat aleate deri sa të merrej vendimi përkatës nga Konferenca e Paqes. Në këtë situatë, serbët përfituan duke pushtuar Shkodrën. Por kjo nuk zgjati shumë, pasi prania e tyre u zëvendësua nga trupa ushtarake franceze, britanike dhe italiane.⁸ Largimi i italianëve nga Shqipëria u realizua vetëm në vitin 1920 dhe pas luftimeve të shqiptarëve të emërtuara si Lufta e Vlorës. Kjo gjendje vazhdoi deri në traktatin e paqes. Do të duheshin përpjekje dhe mbështetje që orekset e vazhduara të Italisë, Greqisë, Jugosllavisë të frenoheshin. Vetëm në pranverën e vitit 1920 u realizua rivendosja e shtetit shqiptar në kufijtë e njohur të vitit 1913.

Pas një pauze, jo vetëm pas muajit prill 1939, por edhe tetori i vitit 1940 e prezanton përsëri Shqipërinë arenë lufte. Territori shqiptar u shndërrua në teatër lufte. Italia përmes territorit shqiptar kaloi në agresion kundër Greqisë. Për italianët, territori shqiptar i pushtuar prej tyre, konsiderohej i përshtatshëm për të kaluar në agresion kundër Greqisë,

⁷ Castellan, Georges, Histori e Ballkanit, Çabej, f. 450

⁸ Duka, Valentina, Histori e Shqipërisë 1912-2000, Shtëpia Botuese "Kristalina", Tiranë, 2007, f. 100

pavarësisht nga natyra malore e shkëmbore e terrenit shqiptar. Data 28 tetor 1940 shënon fillimin e agresionit, por brenda një periudhe shumë të shkurtër forcat greke mundën t'i sprapsin trupat ushtarake italiane. Këto të fundit vepruan mandej brenda territorit shqiptar. Në këtë mënyrë pjesa dërmuese e Shqipërisë së Jugut u kthye në teatër të luftimeve mes dy vendeve të tjerë, Italisë dhe Greqisë.

“Për të mirën dhe të keqen e tyre” shqiptarët asnjëherë në historinë e tyre nuk janë prirur nga synime agresive, pushtuese. Ata kanë qenë të prirur për paqe e marrëdhënie të mira me fqinjët. Nga ana tjetër ata kanë reaguar dhe janë përgjigjur ushtarakisht ndaj çdo veprimi a ndërmarrje të armatosur kundër tyre.

Në kushtet kur mbreti Zog u largua nga vendi, kur uniteti i kombit ishte lëkundur jashtëzakonisht, shqiptarët e pritën me armë pushtimin fashist. Periudha e mëvonshme, d.m.th. pas datës 7 prill 1939, nuk evidentoi kundërshtime të strukturave ushtarake zyrtare shqiptare. Për më tepër pushtuesi në qershorin e 1939-s likuidoi si strukturat e Ministrisë së Brendshme, ashtu edhe të forcave të armatosura⁹. Tashmë ato ishin të përfshira në strukturat fashiste italiane. E gjithë periudha e Luftës së Dytë Botërore për shqiptarët karakterizohet nga kundërshtimi popullor i pushtimit fashist dhe më vonë nazist. Lëvizja shqiptare erdhi duke u rritur, konsoliduar dhe materializuar përmes krijimit dhe veprimtarisë luftarake të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, deri në çlirimin e plotë të vendit.

Shqiptarët nuk vrasin të pafajshmit, të dorëzuarit, të mundurit dhe viktimat

Kadare trajton me shumë realizëm Kanunin e Lekë Dukagjinit. “Ky kod, ligji themeltar i shqiptarëve gjatë shumë shekujve, ka vërtet një ftohtësi e ashpërsi tragjike, por edhe ky kod primitiv e i kritikueshëm fort, në bazën e tij, në pjesë

⁹ Duka, Valentina, Histori e Shqipërisë 1912-2000, f. 211

themelore, atë që përcakton “Rregullat e vdekjes”, përjashton në mënyrë absolute masakrën dhe gjymtimin. Ligji i parë i kësaj pjese është që në çdo grindje, në çdo hakmarrje, secila palë në konflikt, sado i rëndë të jetë ai, ka të drejtë vetëm për një vdekje. Ligji i dytë themelor është që vrasja mund të bëhet vetëm në distancë dhe trupi i viktimës nuk mund të preket kurrsesi.¹⁰ Kadare vijon më tej duke u shprehur i zemëruar e revoltuar që pavarësisht nga ç’ka treguar historia ndaj shqiptarëve, kjo meritë e shqiptarëve duhet njohur e vlerësuar, nuk mund të neglizhohet. Sipas tij, qëndrimi mosnjohës e injorues ndaj kësaj vlere nuk është më pak se mizori. Pjesë themelore e kodit shqiptar është qëndrimi ndaj të huajit, të panjohurit, të ardhurit nga vend tjetër, të bujtësit. Mbrojtja e tij është, sipas kodit, detyra e parë morale e njeriut shqiptar. Ky përcaktim është shprehur qartazi në rrjedhat e historisë së shqiptarëve në marrëdhënie me të tjerët, qofshin fqinjë, por edhe të largët. Sidomos kjo ka gjetur reflektim në ato periudha të historisë ku shqiptarët janë ballafaquar ushtarakisht me të tjerët. Ata kanë ditur që pavarësisht nga mungesa e shkollimit, apo kodeve përcaktuese të të sjellurit në luftë, të ndanin e dallonin luftëtarin në betejë nga luftëtarin e mundur, luftëtarin veprues si vrasës, nga luftëtarin e dorëzuar e të mundur, luftëtarin e huaj agresor, nga viktima e kështu me radhë. Dhe kjo është realizuar si me bindje e përgjegjësi, ashtu dhe me natyrë njerëzore e veprime praktike.

Shembujt për Shqipërinë e shqiptarët janë të shumtë. Historia na ofron pasuri të vyer në këtë drejtim. Në periudhën e luftërave ballkanike Shqipëria përveç se arenë lufte, ku ushtritë e tjera, përfshi të vendeve fqinjë kaluan e përdorën territorin shqiptar si teatër veprimesh luftarake, nuk u ndalën edhe para dëmeve shkaktuar shqiptarëve, duke pasur synim të aktualizojnë edhe pretendimet e tyre territoriale. Por, referuar dokumenteve apo dëshmime nga të huajt që ndodheshin në atë kohë në Shqipëri “...shqiptarët, edhe në këto kushte, kanë bërë më shumë se ç’mund të pritej prej tyre.

¹⁰ Lani Remzi, Mustafaj Besnik, Misha Piro, Lufta kundër Luftës (artikull i Ismail Kadare), f. 11

Megjithëse në vend kishte zi buke, ata ndihmuan ushtrinë serbe kur ajo u tërhoq nëpër territorin e Shqipërisë”.¹¹ Sipas autorit të librit “Shqipëria dhe SHBA-ja në Arkivat e Uashingtonit” Haris Silajxhiç, referuar deklaramenteve të bëra nga Erikson, dëshmitar ngjarjesh të asaj periudhe në Shqipëri, bën të ditur se ai, pra, Eriksoni ka jetuar disa vjet mes shqiptarëve së bashku me familjen dhe për këtë arsye ka të drejtë dhe e ndien si detyrë të thotë të vërtetën: *“Ata, shqiptarët, janë inteligjentë, fisnikë, punëtorë, e duan jetën familjare, seriozë, mikpritës... besnikë deri në vdekje. Të tillë popull kam njohur unë dhe jam krenar që sot po e përfaqësoj këtu”*.¹² Francesko Jakomoni në librin e tij “Politika e Italisë në Shqipëri”, bën të ditur se në Kongresin e Lushnjës ishte i pranishëm edhe misionari amerikan, i cili më vonë u zgjodh anëtar i delegacionit shqiptar në Konferencën e Paqes.

Sipas misionarit amerikan, në periudhën e luftërave ballkanike, me ndihmën e shqiptarëve, tragjedia e ushtrisë serbe mund të mënjanohej. Te shqiptarët gjen virtyte, të cilat do të ishin të dëshirueshme për shumë popuj të përparuar. Por që propaganda sistematike e asaj kohe i paraqiste shqiptarët armiq të qytetërimit.¹³ Shqiptarët, më tepër për arsye të natyrës së tyre humane kanë ditur të përcaktojnë rregulla të sjelljes në luftë. Ata kanë ditur të përcaktojnë rregulla për t’u zbatuar, të cilat kanë qenë në përputhje me rregullat e përfshira në konventa të ndryshme ndërkombëtare. Në kryengritjen e përgatitur në Kosovë në vitin 1919, Komiteti i Kosovës përgatiti programin e përgjithshëm të kryengritjes së Kosovës,¹⁴ ku ndër të tjera bëhet fjalë se: “asnjë kryengritës nuk guxon t’i dëmtojë shkiët e vendit veç atyre që qëndrojnë me armë në dorë kundër qëllimit shqiptar; asnjë kryengritës nuk guxon të djegë shtëpia, të rrënojë kisha e gjëra të tjera; plaçka është jasyk (e ndaluar) e kryengritjes; asnjë kryengritës nuk guxon të bëjë ndonjë shëmtim mbi trupat e të vvarëve të armikut, as t’ zhvesh ata armiq që vdesin a plagosen, ose që zihen robër etj.”

¹¹ Silajxhiç, Haris, Shqipëria dhe SHBA në Arkivat e Uashingtonit, f. 99

¹² Silajxhiç, Haris, Shqipëria dhe SHBA..., f. 99

¹³ Silajxhiç, Haris, Shqipëria dhe SHBA..., fq. 95

¹⁴ Tahiri, Bedri, Hasan Prishtina - Truri i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, Prishtinë, 2008, f. 107-108

Vlerat e shqiptarëve evidentohen edhe me përfundimin e Luftës së Vlorës në vitin 1920. Dëshmitë italiane¹⁵ bëjnë të njohur se trupat e mundura italiane janë shoqëruar deri sa të hipnin nëpër anije e niseshin drejt Italisë. Autoritetet shqiptare e kanë bërë këtë duke respektuar kodin e tyre njerëzor e të sjelljes ndaj të mundurit e të dorëzuarit.

Gjatë luftës italo-greke, grekët ishin në dyshim ndaj trupave ushtarake të atëhershme shqiptare nëse ato do të bashkoheshin me ta kundër italianëve.¹⁶ Por e vërteta ishte krejt ndryshe. Batalionet shqiptare që qenë inkuadruar në ushtrinë italiane, dezertuan dhe nuk pranuan të luftonin kundër grekëve. Referuar dokumenteve të arkivuar në Zyrën e Shtabit të Përgjithshëm të ushtrisë italiane mund të gjendet evidencë e bollshme e qëndrimit të shqiptarëve, efektivë të batalioneve shqiptare të inkuadruar në njësitë ushtarake italiane, qëndrim i cili nuk ka qenë në një linjë me atë italian. Në dokumentin e datës 11 nëntor 1940 të komandës së divizionit 83 të këmbësisë malore “Ferrara” drejtuar komandës së korparmatës “C”¹⁷, ndër të tjera bëhet e ditur se nga trupat shqiptare ka braktisje kolektive të frontit të luftës, të cilat lënë shumë për të dëshiruar. Në batalionin shqiptar “Dajti” verifikohen dezertime masive në bllok prej 30-50 vetë. Në momentin e përgatitjes së raportit, dy kompani shqiptare braktisin frontin. E njëjta situatë ndodh edhe me batalionin tjetër shqiptar “Gramozi”, ku një ditë më parë është realizuar largim në masë i shqiptarëve, aq sa komandanti i regjimentit italian arrin të grumbullojë pak më shumë se 200 vetë, ndërkohë që efektivitë i batalionit është 3-4 herë më i madh. Janë këto fakte që e detyrojnë komandantin italian të kërkojë tek eprori mospërfshirjen e trupave shqiptare në operacion.

¹⁵ Jakomoni, Francesco, Politika e Italisë në Shqipëri, Tiranë, 2005, f. 133

¹⁶ Samer, Haroey, Rescue in Albania... fq. 5

¹⁷ Crociani, Piero, Shqiptarët në Forcat e Armatosura Italiane (1939-1943), f. 234-235 - Dokumenti 8. D.S.B.203, Komanda e divizionit 83 të këmbësisë Malore “Ferrara”, Nr.Prot. 394/g, datë 11 nëntor 1940 - XiX, Objekti: batalionet shqiptare, drejtuar: Komandës të Korparmatës “C”, nga Komandanti Gjeneral L. Zannini

Gjithashtu, evidentohet se ka mungesë ndërlidhje mes batalioneve shqiptare me repartet italiane në vijën e frontit. Në batalionin “Dajti” ka mungesa organike, pasi në masë ka dezertime, apo edhe kalime në anën e grekëve. Këto janë njoftime të oficerëve shqiptarë drejtuar eprorëve italianë.¹⁸ Të gjitha këto fakte të evidentuara janë vetëm brenda dy javëve të para të agresionit italian kundër Greqisë.

Qëndrimi kundër agresionit nuk u shpreh vetëm nga ushtarakët shqiptarë të rreshtuar në radhët e ushtrisë italiane. Opinioni publik shqiptar gjithashtu ka qenë kundërshtues. “...Një fakt akoma më i rëndë, asnjë student universitar shqiptar nuk ka kërkuar që të shkojë në luftë, përkundrazi është vënë re që, në muajin nëntor, një lloj shpejtësie e gjithë studentëve për t’u nisur në Itali... Ky fenomen shfaqet akoma më preokupues kur mendohet se në verë, gjatë një fushate të organizuar qëllimshëm nga partia (kupto fashiste) për studentët universitarë, janë manifestuar propozime shumë nacionaliste dhe irredentiste”.¹⁹ Më tej bëhet e ditur se shqiptarët mbanin qëndrim kundërshtues për luftën kundër Greqisë sepse: “...kjo luftë nuk ishte lufta e tyre dhe nuk duhet që të marrin pjesë, pasi një patriot i vërtet ka për detyrë që të përfitojë nga të gjitha rrethanat për t’i bërë mirë dhe zmadhuar vendin e tyre, por ky nuk është një rast historik që mund të shfrytëzojnë shqiptarët”.²⁰ Qëndrimi i cituar u referohet shqiptarëve përmes raportit që bëhet për drejtuesit e partisë fashiste italiane. Përveç qëndrimit kundërshtues ndaj kësaj lufte, shqiptarët i shmangen lojës italiane që përmes agresionit kundër Greqisë do të mundësohet bashkimi me Çamërinë.

Gjatë Luftës Italo-Greke, megjithëse popullsia e krahinave të Jugut të Shqipërisë i kishte ende të freskëta në kujtesën e

¹⁸ Crociani Piero, Shqiptarët në Forcat e Armatosura Italiane, f. 236 - dokumenti arkivor Nr.9, H5b.53

¹⁹ Crociani, Piero, Shqiptarët në Forcat e Armatosura Italiane, f. 249 - dokumenti 12, Tiranë, më 18 dhjetor 1940, letër drejtuar Inspektorit të PNF (partia Kombëtare Fashiste) në Shqipëri) dëshmojnë dokumentet e asaj kohe, aktualisht në arkivat italiane.

²⁰ Crociani, Piero, Shqiptarët në Forcat e Armatosura Italiane, f. 250 - dokumenti i arkivuar Nr.12, Tiranë, më 18 dhjetor 1940

vet masakrat çnjerëzore të ushtrisë dhe banditëve grekë në vitet 1913-1914, strehoi, ushqe u dhe mjekoi ushtarakët grekë që vepronin në territorin shqiptar.²¹

“Shqipëria u bë vend i rrallë në Evropë që nuk u dorëzoi gjermanëve asnjë hebre gjatë Luftës së Dytë Botërore. Kur hebrenjtë e kuptuan se ç’do të thoshte për shqiptarët trajtimi i të huajit, të pafajshmit, të dëbuarit, të viktimës, vërshuan nga çdo anë për të kërkuar ndihmë te shqiptarët. Në fund të Luftës së Dytë Botërore, Shqipëria ishte i vetmi vend në Evropë, që në fund të luftës kishte numër më të madh hebrenjsh se para fillimit të saj. Domethënës është fakti se asnjë hebre nuk u dorëzua, apo ekspozua të tjerëve. Po kështu, asnjë hebre, jo vetëm ata që kishin shtetësinë shqiptare, por edhe ata të ardhur nga Austria, Gjermania dhe vendet fqinje nuk patën fat të ndryshëm. Të gjithë u konsideruan njëllëj.²² Prania e hebrenjve në trojet shqiptare është shumë e hershme, që para dy mijë vjetësh.²³ Ndërkohë, sipas Apostol Kotanit²⁴, legjendat flasin edhe për marrëdhënie mes hebrenjve dhe ilirëve që në lashtësi.

²¹ Kotani, Apostol, Shqiptarët dhe Hebrenjtë në Shekuj, Tiranë, 2007, f. 78

²² Gjatë pushtimit nazist në Shqipëri, një shqiptar i qytetit të Krujës strehoi 10 hebrej në shtëpinë e vet. Kur nazistët iu afruan shtëpisë së tij, ai i dërgoi hebrenjtë të fshihen në çati. Hebrenjtë e frikësuar pyetën se çfarë do të ndodhte nëse shtëpisë i vihej zjarri. Atëherë shqiptari dërgoi djalin e tij të fshihej bashkë me ta. Ky shqiptar i thjeshtë dëshmoi, ashtu si shumë e shumë të tjerë, për vlerën e institucionit unik të besës, këtë kod të lashtë shpirtëror shqiptar të mikpritjes ndaj miqve apo njerëzve në nevojë, si gjenë më të shtrenjtë që ai kishte. Shih: Topi, Bamir, Fjala e Presidentit në Konferencën Ndërkombëtare “Përballja me të nesërmen“, Jerusalem, 13 maj 2008

²³ Mordechai, Arbell, Konferenca Ndërkombëtare për Hebrenjtë, Tiranë, 21-22.05.2008

²⁴ Apostol Kotani është autori i librit “Shqiptarët dhe Hebrenjtë në shekuj“, në të cilin trajtohen me hollësi marrëdhëniet mes tyre, të cilat sipas autorit janë të lashta, kanë njohur ecuri të vazhdueshme dhe kanë shprehur karakteriatika nga më të mirat të dy popujve. Në librin e tij trajtohen lidhjet në këndvështrimin historik, duke nxjerrë në pah edhe të veçanta në periudha të caktuara historike, veçanërisht gjatë Luftës së Dytë Botërore. Libri jep një pasqyrë të qartë se çfarë u kanë ofruar shqiptarët hebrenjve për t’i mbrojtur ata nga nazizmi, duke prezantuar kështu qytetari e dashamirësi, që vështirë se gjendet në raste të tjera.

Autori trajton me detaje lidhjet mes shqiptarëve dhe hebrenjve, të cilat kanë njohur vijimësi, intensitet, dashamirësi, ndihmë reciproke, duke ardhur deri në ditët tona. Hebrenjtë kanë qenë të pranishëm jo vetëm në marrëdhënie tregtare, apo biznese të ndryshme por edhe në ushtri. Në vend të shërbimit ushtarak në ushtrinë osmane, ata paguanin një taksë për moskryerje të tij.²⁵ Por ata me dëshirë pranonin të rreshtoheshin në ushtri shqiptare²⁶, pavarësisht se ajo ishte pjesë e ushtrisë osmane. Dëshmi të qarta ekzistojnë për ushtrinë e Ali Pashë Tepelenës, ku hebrenjtë kanë qenë të përfshirë.

Në veçanti mund të flitet për atë çka shqiptarët kanë ofruar për hebrenjtë sidomos për periudhën para dhe gjatë Luftës së Dytë Botërore. Diplomacia shqiptare, pavarësisht se jo me përvojën e vendeve të tjera, edhe në vitin 1934 pat ndërhyrë te komisar i lartë për refugjatët të Lidhjes së Kombeve, për dërgimin dhe vendosjen në Shqipëri të një pjese hebrenjsh të përzënë nga nazistët.²⁷ Duke vazhduar me të njëjtin fakt, referuar vitit 1938, pra pragut të Luftës së Dytë Botërore, ndërkohë që hebrenjtë e Gjermanisë apo të Austrisë po fillonin të strehoheshin në Shqipëri, ambasadori amerikan Bernshtajn (Bernstein) shkruante: *“Në Shqipëri nuk ka gjurmë diskriminimi kundër çifutëve, sepse është një nga vendet e rralla të Evropës ku nuk ka as paragjykimë, as urrejtje fetare.”*²⁸

Ajo që bëri Shqipëria dhe shqiptarët për hebrenjtë gjatë Luftës së Dytë Botërore pati trajtim të veçantë në një Konferencë ndërkombëtare në Tiranë, në datat 20-21 maj 2008. Gjatë konferencës Mordechai Arbell, kryetar i Kongresit Botëror të Hebrenjve do të theksonte: “Shpëtimi heroik i hebrenjve në Shqipëri është shumë i veçantë”.²⁹ Dhe më tej: “Hebrenjtë janë mbrojtur në Shqipëri për pothuajse 2000 vjet. Jeta e veçantë harmonike mes besimeve fetare në këtë vend

²⁵ Samuel, Haroe, Rescue in Albania... f. 23

²⁶ Samuel, Haroe, Rescue in Albania... f. 23

²⁷ Asllan, Uran, prof. dr., Diplomacia dhe diplomatët shqiptarë 1912-1944, Shtëpia Botuese ILAR, Tiranë, 2006, f. 138

²⁸ Metais Serge, Histori e Shqiptarëve - Nga Ilirët deri te Pavarësia e Kosovës, f. 323

²⁹ Konferenca Ndërkombëtare për Hebrenjtë, Tiranë, 21-22.05.2008

duhet të jetë shembull për botën.³⁰ Në këtë mënyrë Shqipëria u shndërrua në parajsë të vërtetë për hebrenjtë që ndiqeshin e vriteshin kudo në atë periudhë. Gjithë këto fakte nuk kanë qenë theksuar më parë, nuk kanë qenë njohur e vlerësuar. Dhe kjo për arsye të izolimit të gjatë komunist të vendit.

A ishte e njëjtë situata e hebrenjve nëpër vende të tjera? Kurrësi. Hebrenjtë që banonin në Janinë apo në Korfuz patën ndërtuar e vijuar kontakte e lidhje me hebrenjtë në qytete shqiptare. Por ajo që ndodhi gjatë holokaustit tregoi se komuniteti i hebrenjve në Korfuz u zhduk, ndërkohë që në Janinë vetëm një numër i vogël hebrenjsh arriti të mbijetonte.³¹ Madje qeveria shqiptare e asaj periudhe ishte e gatshme për të pranuar hebrenj nga vende të tjerë. Italiani Francesko Jakomoni, dëshmitar i ngjarjeve, pasi ishte mëkëmbës i mbretit Viktor Emanueli gjatë pushtimit fashist në Shqipëri³² thekson vlerat e larta qytetare, mikpritëse e njerëzore të shqiptarëve ndaj hebrenjve. Këto vlera ai nuk i evidenton vetëm për qytetarët e thjeshtë, por edhe për qeveritë shqiptare të asaj periudhe, pavarësisht se ato ishin të shkrira me pushtuesin fashist. Të sille të në vëmendje që Jakomoni ishte autoritet dhe përfaqësues i lartë i vendit

³⁰ Konferenca Ndërkombëtare për Herenjtë, Tiranë, 21-22.05.2008

³¹ Samuel Haroey, *Rescue in Albania...* p. 12

³² Jakomoni Francesko, *Politika e Italisë në Shqipëri*, Tiranë, 2005, f. 304. Sipas autorit kur kryeministrit të qeverisë shqiptare Mustafa Kruja i kishte vajtur konsulli i Përgjithshëm i Gjermanisë dhe i kishte paraqitur një notë verbale, me anë të së cilës qeveria naziste kërkonte dorëzimin e 300 çifutëve, të ardhur nga Jugosllavia, ai nuk u tregua entuziast për përgjigje pozitive. Ndërkohë, komanda ushtarake gjermane e Beogradit, kishte njoftime të sakta për emrat dhe për vendet ku ishin strehuar në Kosovën shqiptare. Mustafa Kruja i kërkoi mëkëmbësit të mbretit, pra autorit të librit, që hebrenjtë të mos prekeshin fare në Shqipëri. Në atë periudhë nuk kishte asnjë ushtar gjerman që mund të zbulonte. Kështu, në bashkëpunim me palën italiane, u duk më e përshtatshme që çifutët mërgimtarë të dërgoheshin menjëherë në zonën e Gjirokastrës, që kufizohej me zonën greke dhe ishte nën pushtimin italian, ashtu si e gjithë Shqipëria. Këta hebrenj u pajisën me pasaporta shqiptare, me emër të rremë. Të gjithë këto masa i dhanë mundësi Mustafë Krujës që t'i përgjigjej pas disa ditësh konsullit të Përgjithshëm të Gjermanisë, se të gjitha hetimet që ishin bërë në Kosovë për emrat që ishin vënë në listë, kishin përfunduar të kota. Nga ana tjetër edhe pala italiane u tregua tolerante në këtë drejtim dhe nuk ndoqi qorrazi linjën naziste.

pushtues, i cili qëndronte në krahë të Gjermanisë naziste, e cila e kishte në filozofinë e saj zhdukjen e hebrenjve. Interesante është dëshmia, se kur mbreti Zog ishte në Britaninë e Madhe pas largimit me pushtimin e Shqipërisë nga Italia, ai i propozoi një plan udhëheqjes britanike për të vendosur hebrenj në Shqipëri.³³

Të gjithë faktorët shqiptarë kanë vepruar me dashamirësi e përkujdesje ndaj hebrenjve, duke marrë përsipër edhe rrezikun. Kjo mënyrë veprimi është plotësisht e admirueshme dhe tregon vlerat civilizuese të shqiptarëve e të Shqipërisë. Kjo evidencë përbën një fakt shumë domethënës. Nuk duhet harruar se para fillimit të Luftës së Dytë Botërore nazistët do të deklaronin: “*Sot Gjermania na përket ne, nesër e gjithë bota*” dhe në synimet e tyre do të përcaktohej: “*luftë në shkallë botërore; ideologji raciste përmes të cilës hebrenjtë duhet të eliminohen*”.³⁴ Për më tepër, duhet marrë parasysh fakti i një shteti tepër të brishtë shqiptar dhe i një populli të vuajtur dhe pa mundësi për të pasur një emër përballë të tjerëve dhe aq më pak përballë nazizmit. Por në fund mund të thuhet se ndaj hebrenjve Shqipëria e shqiptarët treguan vlera të larta civilizuese, të pashembullta dhe për t’u pasur zili edhe nga kombet e qytetëruara.

Shifra 1200 hebrenj të shpëtuar në Shqipëri, ku asnjë i vrarë, asnjë i dorëzuar është tepër e vogël para shifrës 6 milionë hebrenj, të vegjël e të mëdhenj, meshkuj e femra të vrarë gjatë Luftës në të gjithë botën. Por, krahasuar me numrin e popullsisë e të territorit të Shqipërisë dhe me kushtet e vendit në atë kohë, shpreh shumë. Në Shqipëri, ashtu si në

³³ Plani nënkuptonte vendosjen e 50000 familje hebrenjsh në Shqipëri. Ahmet Zogu përshkroi Shqipërinë si një vend shumë të pasur me njerëz të varfër. Vendi kishte një popullsi prej një milion dhe mund të absorbonte një popullsi prej pesë milion. Ai propozoi që për çdo nga 50 mijë familjet hebrenje të ofrohej tokë bujqësore, e cila ishte pronë shtetërore. Bordi i deputetëve britanikë e mori seriozisht propozimin, por jo Ministria e Jashtme (*British Foreign Office*) Kjo e fundit dyshonte se mbreti Zog do të rikrijonte monarkinë pas Luftës së Dytë Botërore Samuel. Shih: Haroey, *Rescue in Albania...*, f. 13

³⁴ Gitman Esther, Historian, New York, Dr. Aloysius Stepinac, Archbishop of Zagreb, under the lens of historians and diplomats (1941-1945), International Conference, September 19, 2008

Danimarkë, nuk ndodhi ajo që ndodhi në vendet e tjera.³⁵ Nga mbi 11 milionë hebrenj të shpërndarë nëpër Evropë u shfarosën rreth 6 milionë, ndër të cilët 1 milion e 500 mijë fëmijë.

Gjatë Luftës së Dytë Botërore, pas kapitullimit të Italisë fashiste, shqiptarët ditën të sillen edhe ndaj italianëve të mundur. Ata që dëshiruan u inkuadruan në radhët e përkrahë partizanëve shqiptarë në luftë kundër okupatorëve nazistë. Dëshmi e këtij realiteti është krijimi i batalionit “Antonio Gramshi” me rreth 1500 italianë.³⁶ Ndërkohë të dhëna të tjera bëjnë të ditur për numër më të vogël në këtë njësi ushtarake.³⁷ Bëhet fjalë për rreth 15 mijë ushtarakë italianë të dorëzuar pas kapitullimit të Italisë fashiste. Ata iu dorëzuan partizanëve shqiptarë, por vetëm ata më të vendosurit, rreth 2150 vetë u futën në formacionet partizane. 472 ushtarakë italianë u rreshtuan në brigadat sulmuese, 401 u bënë pjesë e shërbimit të prapavijës, ndërsa pjesa tjetër prej rreth 1270 vetash u angazhuan pranë komandave të vendit. Shumë të tjerë

³⁵ Në Gjermani nga 5 milionë hebrenj që ishin në vitin 1933, në mbarim të luftës mbetën gjallë vetëm 15 mijë; në Austri u vranë 61 mijë hebrenj; në Poloni u vranë 2 milionë e 900 mijë; në Belgjikë nga 43 mijë mbetën gjallë vetëm 515 hebrenj; në Holandë u shfarosën 90 mijë hebrenj; në Bashkimin Sovjetik, në pjesën e pushtuar nga nazistët u shfarosën 720 mijë hebrenj; në Itali nga të 15 mijë hebrenjtë që u dërguan në kampet e përqendrimit, vetëm 610 shpëtuan; në Greqi nga 69 mijë hebrenj që ishin para lufte, vetëm 7 mijë shpëtuan; në Bullgari nga të 48 mijë hebrenjtë që ishin, vetëm 7 mijë vetë u kapën drejtpërdrejt nga nazistët dhe u vranë, ndërsa të tjerët shpëtuan sepse nga njëra anë i mbrojtë populli e nga ana tjetër shtatmadhuria e ushtrisë bullgare nuk pranoi urdhrat naziste dhe nuk i dorëzoi; në Jugosllavi nga të 75 mijë hebrenjtë që banonin aty, u shfarosën mëse 80% e tyre; të 50 mijë izraelitët që banonin në Maqedoni u internuan në Auschwitz dhe u shfarosën të gjithë; sipas deponimeve të Wislicenit në gjyqin e Nurembergut edhe të 35 mijë hebrenjtë e Sllovakisë në pranverën e vitit 1942 u internuan në Lindje dhe u shfarosën; në qytetin e Rigës nga afro 80 mijë hebrenjtë që banonin aty para pushtimit nazist, çlirimi i qytetit gjeti vetëm 140 prej tyre: Për më tepër shih: Kotani, Apostol, Shqiptarët dhe Hbrenjtë në Shekuj, Tiranë, 2007, f.100-101

³⁶ *Metais Serge, Histori e Shqiptarëve - nga Ilirët deri te Pavarësia e Kosovës, Tiranë, 2006, f. 316*

³⁷ *Hasani, Proletar, prof. dr., Formacionet tona luftarake me ish ushtarakë të huaj, Revista Ushtarake, 2/2005*

mundën të largohen. Por pjesa e mbetur, nuk u masakrua. Përkundrazi, ata u pranuan nga shqiptarët dhe qëndruan nën kujdesin e tyre. U sistemuan në shtëpitë e shqiptarëve. Iu dha punë dhe kontribuonin në familjet shqiptare. Ata u miqësuan me shqiptarët, pavarësisht se më parë ishin në luftë për jetë a vdekje me ta. Ushtarët italianë, pushtues të djeshëm, të mbetur më 1943, pas kapitullimit të Italisë, në mëshirë të shqiptarëve, jo vetëm s'u prekën prej tyre, por u strehuan e u mbrojtën gjer në mbarimin e luftës. Sipas Kadaresë flitet për rreth 40 mijë ushtarë italianë.³⁸ Shqiptarët u zgjatën dorën e miqësisë pushtuesve të djeshëm duke i mbajtur nën kujdesin e tyre deri në përfundimin e luftës. Burime të tjera bëjnë fjalë për 25 mijë vetë³⁹, ose edhe për 45 mijë të mbetur brenda vendit⁴⁰, pjesëtarë të ish-ushtresë pushtuese fashiste të cilëve pas përfundimit të luftës iu krijua mundësia e riatdhesimit.

Në linjën e qëndrimit shqiptar ndaj të huajve, mund të shërbej edhe një fakt domethënës i ditëve tona. Si dihet, anarkia që përfshiu Shqipërinë në vitin 1997 u pasua me prani ushtarake ndërkombëtare të konkretizuar përmes Operacionit ALBA. Gjatë zhvillimit të këtij operacioni asnjë nga trupat ushtarake të vendeve të tjerë nuk u bë objekt sulmi apo objektiv për shqiptarët. Ushtarakët e huaj patën ardhur me mision paqeje në Shqipëri. Ata qenë të përgatitur për më të keqen. Pra, edhe për reagim të armatosur. Por pritja nga publiku shqiptar nuk qe e tillë. Ata janë pritur me dashamirësi, pasi i tillë qe misioni i tyre. Për më tepër, shqiptarët edhe njëherë shprehën traditën e mikpritjen ndaj të huajit e mikut. Me siguri mund të thuhet se shumë ushtarakë e autoritete ushtarake të huaja janë surprizuar nga një realitet i kësaj natyre, gjë që lehtësoi edhe kryerjen e misionit.

Për hir të së vërtetës, ajo që shqiptarët kanë bërë për të tjerët nuk ka ndodhur nga të tjerët në adresë të shqiptarëve.

³⁸ Lani, Remzi; Mustafaj, Besnik; Misha, Piro, Lufta kundër Luftës (artikull nga Ismail Kadare), f. 12

³⁹ Kotani, Apostol, Shqiptarët dhe hebrenjtë në shekuj, Tiranë, 2007, f. 79

⁴⁰ Bartl, Peter, Shqiptarët - nga Mesjeta deri në ditët tona, Instituti i Dialogut&Komunikimit, f. 228

Përmes dokumenteve apo dëshmime të ndryshme vetëm për 100 vitet e fundit ballafaqohemi me fakte tronditëse. Në periudhën e viteve 1913-1914 në Shqipërinë Jugore nga forcat greke, sipas raportit të gazetarit amerikan Uilliam U. Houard: “ishin djegur ose hedhur në erë mbi 300 fshatra me 35.000 shtëpi dhe kishin mbetur pa strehë 330.000 vetë. Sipas llogaritjeve të tij, ishin vrarë, therur me bajonetë ose djegur 20.000 burra, gra dhe fëmijë.⁴¹ E njëjta situatë, në të njëjtën periudhë, paraqitet nga serbët kundrejt shqiptarëve. Në pranverën e vitit 1914 udhëheqësit e disa komuniteteve në Shqipërinë Veriore, veçanërisht Kosova, u dërguan ministrave të jashtëm të Fuqive të Mëdha një protestë kundër mizorive të pamenduara të trupave serbe kundër grave, fëmijëve dhe pleqve. Në protestë theksohej se vrasjet qenë kryer me gjakftohtësi dhe jo në zjarrin e betejës. Protesta shoqërohej me një listë 50 fshatrash të rretheve të Gjakovës, Ipekut, Prizrenit, Dibrës dhe Ohrit duke bërë me dije për 359 shtëpi të djegura dhe 1827 njerëz të vrarë.⁴² Ndërkohë gazetari raportues Uilliam Houard, në një intervistë të titulluar “Le të vdesin shqiptarët: ata janë muhamedanë!” bën përshkrimin e mëposhtëm: “Regjimentet serbe prej 1100 vetash, nën komandën e gjeneral Karlos Poipovië, një nga pjesëtarët e komplotit të mbretit, hynë në Shqipëri të armatosur me vajgur, pompa spërkatëse dhe dinamit. Ata kapnin shqiptarë sa mundnin. Pastaj i lidhnin së bashku për krahu dhe i qëllonin. Gratë i përdhunonin. Besoj se çdo grua që binte në dorën e serbëve, bëhej viktimë e tyre. Pastaj ata i mbyllnin nëpër shtëpi dhe vendosnin bomba nëpër mure. Spërkatnin me vajgur

⁴¹ Ulliam U. Houard ka qenë gazetar, kishte përvojën e gazetarit në shumë vende. Gjatë një udhëtimi vëzhgues në Shqipëri, në moshën 50-vjeçare, ai përshkoi 600 km me kalë e më këmbë për të parë gjendjen me sytë e vet. Në Shqipëri ai u takua me Harold Sherud Spenser. Ky i fundit ishte një vullnetar amerikan pa pagesë, që mbështeste edhe të tjerë financiarisht, i cili gjithashtu ka marrë edhe vetë pjesë në luftime në krye të shqiptarëve kundër grekëve. Për më tepër shih: Jacques Edwin, Shqiptarët, Historia e Popullit shqiptar nga lashtësia deri në ditët e sotme, Fondacioni Abraham Lincoln, Kartë e Pendë, 1995, f. 389.

⁴² Jacques Edwin, Shqiptarët, Historia e popullit shqiptar nga lashtësia deri në ditët e sotme, f. 390

gjithandej dhe i vinin zjarrin. Kur flakët arrinin dinamitin, shtëpia hidhej në erë. Shqipëria është mbushur me pirgje gurësh të nxirë, që dikur ishin shtëpi”⁴³ Edhe gjatë Luftës së Dytë Botërore, në Kosovë, marrëdhëniet mes strukturave partizane të Jugosllavisë dhe popullit shqiptar të Kosovës nuk janë aq fort për t’u përshëndetur. Shqiptarët ishin bërë objekt masakrash për strukturat ushtarake jugosllave.⁴⁴

Rast e ngjarje makabre, tipike, dhe e pashembullt në kuptimin që një shtet realizon kundër një populli tjetër përfaqësohet me masakrën e Tivarit në vitin 1945. Në këtë ngjarje të pashembullt shteti jugosllav me pretekstin e lëvizjes së shqiptarëve të Kosovës, të organizuar ushtarakisht, drejt frontit kroat kundër nazistëve, duke kaluar përmes territorit shqiptar dhe Malit të Zi, arriti që të realizojë masakër duke asgjësuar rreth 4310 shqiptarë të Kosovës.⁴⁵ Fillimi i këtij marshimi u kamuflua me vajtjen në front në të mirë të Jugosllavisë. Por qëllimi ishte i ndryshëm. Shqiptarët u çarmatosën dhe ashtu të pambrojtur, pa kujdesje, pa bukë e pa ujë, nën ruajtje të rreptë, kanë marshuar për kohë të gjatë, janë vrarë, djegur, terrorizuar, duke finalizuar veprimin makabër ndaj tyre me masakrën e Tivarit, varrin më të madh të shqiptarëve pa asnjë skelet dhe dëshmi të krimeve serbosllave mbi popullin shqiptar.⁴⁶ Përgjegjësi e plotë bie edhe mbi shtetin e qeverinë komuniste shqiptare të asaj periudhe. Jo vetëm që u lejua ky marshim nëpër territorin e shtetit shqiptar, por nuk u bë asnjë reagim zyrtar, qoftë për likuidimet nëpër territorin shqiptar, ashtu edhe për ato që ndodhën në Tivar dhe për ngjarjet pasuese.⁴⁷ Në ditët tona, këto lloj qëndrimesh nuk pushuan. Tirani Milosheviç nuk do ta respektonte ligjin e brendshëm dhe nuk do të pranonte e respektonte identitetin shqiptar në Kosovë. Ai do të zbatonte

⁴³ Jacques Edwin, Shqiptarët, Historia e popullit shqiptar nga lashtësia deri në ditët e sotme, f. 390

⁴⁴ Ndoj, Gjetë, Gjini Marku dhe Lufta, Geer, Tiranë, 2008, f. 108

⁴⁵ Hajdini, Azem, Tragjedia e Tivarit, Botim i Dytë, Botues Shoqata e të Burgosurve Politikë, Prishtinë, 1998, f. 70

⁴⁶ Po aty, f. 87

⁴⁷ Po aty, f. 120-121

një politikë të egër gjenocidi, në emër të sovranitetit të shtetit serb. Për një kohë jo të shkurtër, komuniteti ndërkombëtar qëndroi pasiv. Ndërkohë që shqiptarët nuk vrasin të pafajshmit, me ta çfarë ka ndodhur? Koha e Milosheviqit në Kosovë është dëshmi e qartë e gjenocidit të sotëm. Ajo çka ndodhi në Kosovë është përsëritje e asaj që u ndodhi hebrenjve gjatë Luftës së Dytë Botërore, është përsëritje e tragjedisë së Tivarit në vitin 1945. Veprimi me vonesë i komunitetit ndërkombëtar në rastin e Bosnjës, por edhe në rastin e Kosovës, i la rrugë të lirë masakrave, zhdukjeve, dëmeve. Ajo që ndodhi në Srebrenicë të Bosnjes dhe Hercegovinës në korrik 1995 ku u shfarosën me mijëra qytetarë boshnjakë përfaqëson rastin më të madh të zhdukjeve njerëzore të pas Luftës së Dytë Botërore. Si duket ende nuk ishin nxjerrë mësim për veprim në kohë. Mosveprim i komunitetit ndërkombëtar ka qenë prezent edhe në kohën e Gjermanisë naziste. Shfarosja e çifutëve filloi më herët se viti 1939, kur filloi lufta botërore. Nëse do të veprime, atëherë do të ishte e mundur të shpëtoheshin të gjashtë milion hebrenjtë. Mosveprimi në kohë nga komuniteti ndërkombëtar, gjithmonë është shoqëruar me pasoja katastrofike për jetët njerëzore.

Shqipëria evidentohet me popullin e vet dashamirëse, mikpritëse, mbrojtëse, respektuese dhe shpëtuese ndaj atyre që shkelën në territorin e saj. Shqiptarët nuk vrasin. Ata nuk kalojnë në agresion e masakra ndaj të tjerëve. Sipas një shkrimtari izraelit, fqinjët i ka caktuar historia pranë njëritjetrit dhe prandaj duhet të mësojmë të jetojmë pranë njëritjetrit, ta pranojmë njëri-tjetrin, të bashkëpunojmë.⁴⁸ Pranverën e vitit 2007 në Shqipëri, në anketimin e zhvilluar nga ana e Institutit për Demokraci e Ndërmjetësim për anëtarësimin në NATO,⁴⁹ shqiptarët e konsiderojnë si më pak të mundshëm agresionin nga fqinjët. Dhe këtu nuk merret parasysh thjesht përdorimi i instrumentit ushtarak në secilin prej fqinjëve, pasi anketimi rezulton se sulmi ushtarak nga fqinjët ka shumë pak

⁴⁸ Lani, Remzi; Mustafaj, Besnik; Misha, Piro, Lufta kunër luftës

⁴⁹ Në këtë anketim të zhvilluar nga IDN, Tiranë, 2007, autori ka qenë i përfshirë si konsulent.

gjasa për të ndodhur. Pamja e re e mjedisit të sigurisë ka luajtur rolin e vet. Konfrontimi i dikurshëm ia ka lënë vendin bashkëpunimit dhe për publikun shqiptar nuk është e vështirë të reflektohet apo të përqafohet rruga e fqinjësisë së mirë, rruga e mirëbesimit, shkëmbimit, përfitimit të dyanshëm. Mesazhi është i qartë, ecja drejt së ardhmes së përbashkët dhe jo drejt së shkuarës konfrontuese, izoluese e rrënuese.

“Shqipëria e sotme, laike në kushtetutë, por me pasuri të trashëguar besimesh lëvron vlera të rralla të lirisë, tolerancës dhe harmonisë ndërfetare. Këto veti, këto attribute, shqiptari i ndien si të vetat, si pjesë të identitetit e jo si kontradikta që përçajnë personalitetin dhe shoqërinë. Marrëdhëniet mes besimeve, sa institucionale, por sidomos shpirtërisht dialoguese e ndërpranuese, historikisht kanë prodhuar një shoqëri shqiptare pa konflikte fetare e armiqtësi apo paragjykime besimesh e kulturash, një shoqëri shembull i rrallë i patjetërsueshëm i së shkuarës, së tashmes dhe të nesërmes globale”.⁵⁰ Përcaktimi i mësipërm vlen për të shkuarën shqiptare, që në lashtësi e duke vijuar me periudhën e gjatë nën Perandorinë Osmane, gjatë luftërave ballkanike dhe ato botërore të shekullit XX. Vlen për të sotmen në realitetin shqiptar, por edhe në marrëdhëniet me fqinjët, vlen për të ardhmen integruese të Shqipërisë. Pa mëdyshje mund të thuhet se harmonia ndërfetare përfaqëson një ambasador të Shqipërisë në botën e qytetëruar.

Shqiptarët në trojet e tyre janë krenarë. Por ata historikisht dhe aktualisht respektojnë e nderojnë të tjerët. Respekti e mirënjohja është virtyt i tyre. Hakmarrja kurrsesi. Me këto veti shqiptarët, aktualisht janë në rrugën e tyre të integrimi evropiane dhe euroatlantike.

Pëllumb Qazimi

⁵⁰ Topi, Bamir, Fjala e Presidentit Topi në Konferencën Ndërkombëtare “Përballja me të Nesërmen“, 13 maj 2008, Jerusalem

ENGLISH SUMMERY

NATO turns 60. How can it stay healthy?

Jos Boonstra

This policy brief in the 60 anniversary of NATO makes an analysis about its future and send a clear message as to the relevance and urgency of the tasks that lie ahead. The good news is that NATO is faring relatively well compared to other European-oriented security organisations. The EU is struggling with internal reforms and has put enlargement on the backburner, while the OSCE has lost relevance due to disagreement between eastern and western members over its values and purpose. Meanwhile, NATO is welcoming France back into its military structures and members are largely united on NATO's key roles: offering security guarantees; fostering transatlantic relations; and undertaking more effective operations. As NATO reaches the age of 60, no member is thinking of the Alliance's retirement. Nonetheless, the Alliance will need to adapt further to the current international environment and new security challenges. The following are some good health guidelines to enable NATO to stay fit at 60:

- NATO needs to develop a compact and realistic new Strategic Concept.
- The ISAF Afghanistan mission is not a test of survival but rather of being able to run large-scale, distant and long-lasting operations with a range of 'civilian' partners.
- NATO should not rush to rebuild relations with a Russia that needs time to find its place in and position towards the Alliance.
- The Alliance should continue its open door policy and contribution to the democratization of defense in partner countries; those that want to join and are ready should be welcome.

NATO at 60. A hollow alliance

Ted Galen Carpenter

As the North Atlantic Treaty Organization celebrates its 60th birthday, there are mounting signs of trouble within the alliance and reasons to doubt the organization's relevance regarding the foreign policy challenges of the 21st century. Several developments contribute to those doubts. Although NATO has added numerous new members during the past decade, most of them possess minuscule military capabilities. Some of them also have murky political systems and contentious relations with neighboring states, including (and most troubling) a nuclear-armed Russia. Thus, NATO's new members are weak, vulnerable, and provocative—an especially dangerous combination for the United States in its role as NATO's leader. There are also growing fissures in the alliance about how to deal with Russia. The older, West European powers tend to favor a cautious, conciliatory policy, whereas the Central and East European countries advocate a more confrontational, hard-line approach. The United States is caught in the middle of that intra-alliance squabble. Perhaps most worrisome, the defense spending levels and military capabilities of NATO's principal European members have plunged in recent years. The decay of those military forces has reached the point that American leaders now worry that joint operations with U.S. forces are becoming difficult, if not impossible. The ineffectiveness of the European militaries is apparent in NATO's stumbling performance in Afghanistan. NATO has outlived whatever usefulness it had. Superficially, it remains an impressive institution, but it has become a hollow shell—far more a political honor society than a meaningful security organization. Yet, while the alliance exists, it is a vehicle for European countries to free ride on the U.S. military commitment instead of spending adequately on their own defenses and taking responsibility for the security of their own region. American calls for greater burden-sharing are even more futile today than they have been over the past 60 years. Until the

United States changes the incentives by withdrawing its troops from Europe and phasing out its NATO commitment, the Europeans will happily continue to evade their responsibilities. Today's NATO is a bad bargain for the United States. We have security obligations to countries that add little to our own military power. Even worse, some of those countries could easily entangle America in dangerous parochial disputes. It is time to terminate this increasingly dysfunctional alliance.

Come home NATO: The atlantic alienates new strategic concept

Jens Ringsmose and Stenn Rynning

In this report, we provide an overview of the political and military issues that are likely to shape the coming discussions about NATO's new Strategic Concept. NATO's current Strategic Concept dates back to 1999 and over the last couple years an increasing number of policy-makers have suggested that it is time to take stock of the transatlantic Alliance. The exercise is significant because the Strategic Concept represents the operational view of the Washington Treaty-the basic text of NATO- and because it will bequeath a new strategic direction to the Alliance. In the report we present three arguments. One is that the Strategic Concept serves several functions: it codifies past decisions and existing practices; it provides strategic direction; and it serves as an instrument of public diplomacy. Our second argument is that the new Strategic Concept must balance the push and pull of two competing visions of NATO, one being 'Come home, NATO'; the other being 'Globalize, stupid'. The contest between these diverging visions has consequences for a number of issues that the Strategic Concept must address. Lastly, we argue that although the agenda of globalization is being questioned, NATO will continue down the path of global engagement.

Revision of the european security starategy: Beyond 2008 and beyond the foreign common security policy

Antonio Missiroli

This article makes an in-depth analyses of the European Security Strategy 'A more secure Europe in a better world' which has been approved in 2003 and make a complete reassessment of it. Prepared by a group of experts of Javier Solana this document is one of the best political documents of EU ever elaborated (together with Laeken Declaration). It took into account suggestions and critics from all 25 Ministries of Foreign Affairs of European countries. This strategy is still useful because all the threats identified in 2003 such as climate, energy, terrorism, nuclear threats ect are still present.

The revision of the European Security Strategy will be useful in order to adapt the objectives to which complementary elements might be added for future implementation of Common Foreign and Security Policy. The title of the Strategy must be changed 'A stronger Europe in a better world' emphasizing an approach less in defence and a more in-depth analysis of itself.

Adriatic charter - an effecting and developing regional cooperation model in Western Balkans

Elira Hroni

The development of this paper is mainly devoted to describing Adriatic Charter partnership of the Albania, Macedonia, and Croatia as a US sponsored initiative after US-Baltic countries partnership as successful regional effort to prepare these countries for NATO membership but also enhance regional cooperation and confidence building. The results have been magnificent, for as long as in the course of 5-6 years they received an invitation but also full accession to the Alliance¹. The

¹ Except for FYROM due to its bilateral problem of name with Greece.

intensive individual countries reforms of the Armed Forces and not only, the intensive cooperation and experience sharing among the three regional partners with Membership Action Plans reforms, the development of trilateral and bilateral cooperation in all fields, the very dynamic and intensive cooperation through an ever increasing number of joint exercises and other forms of activity that were included by the three countries into the Annual Plan of Action, the joint missions of the three partners in international arena may well be compared to all other regional initiatives that have been developed in the Western Balkans or South East Europe during the last two decades. This initiative clearly differs from the others in the sense of local and regionally owned initiative. Although the role of US was important, and vital for the achievement of the objectives, regional countries demonstrated individual commitment and an appropriate sense of responsibility.

The success of A3 was based also in Baltic cooperation model and this enhanced chances for its effectiveness, because the Atlantic community of countries, and NATO were just duplicating the same successful regional cooperation pattern. What made B-3 and A-3 a success was the direct output of the countries involved to achieve NATO membership in the time of half a decade for each of the groups.

In terms of the regional confidence building, the Albanian-Macedonian bilateral perspective is a most indicating of its impact to easing Macedonian society of the “serious” traditional threat that they felt or heavily prejudiced in the sincerity of its Western bordering neighbors, Albania. Furthermore, the Euro-Atlantic integration process and cooperation is bringing to an end for Macedonia, and not only, the solution of the Albanian national question to its national and territorial integrity.

Adriatic Charter partnership first and foremost became a regional success story because it was led and motivated by the wish of the national societies in the region to achieving a very important national objective: being part or Euro-Atlantic Security Area. Precisely this is was the core interest that is

making other regional countries be part and embark on the same partnership route. Bosnia and Herzegovina and Montenegro is already member of this regional cooperation model, while Serbia and Kosovo should follow suit.

A-5 will continue to lead the process of regional cooperation and experience sharing because it is related:

- with priority to further enhance this relation, and increase its efficiency on meeting NATO standards by the new members.
- with increased interoperability of Armed Forces with NATO, to Peace Support, and Crisis Respond Operations.
- with efforts of the A-3 group for strengthening the military cooperation with the armed forces of the countries in region, new members of the PfP Serbia, Bosnia and Herzegovina and Montenegro,
- with the essence Adriatic Charter as a dynamic initiative because it has always been an initiative in action, closely linked to NATO actions.
- with its obvious impact on regional cooperation and confidence building as new countries are applying to enter into this regional partnership scheme

While, all other existing regional initiatives do take their credit in work to achieve their founding missions, A-5 will continue to extend and possibly reform itself reflecting the new regional environment after all countries of Western Balkans have entered the Alliance in the decade to come.

World Financial Crises and its Effects on Security

Evis Gjebrea

Anyone who reads this title might think that these two concepts are not related. Most of us have had too much exposure to the problems of the financial crisis, but not as much to the issue of security. The question that arises is what “security” means in and of itself? or The question arises, “what does security mean”? Is it the internal security of a country or does the concept goes beyond this? This article will respond to these questions.

After the Cold War, it was the American government who introduced the concept of human security. Safety was no longer limited to the internal security of a country, but was extended further by having the focus on individual security, which contains several components. While we take into consideration the Strategic Documents of Albania we may conclude that the human security aspect is almost unknown and not sufficiently addressed. Human security includes the following components: economic security, food security, environmental security, personal security, health security, political security and community security.

The global financial crisis, which began September 14th 2008, shook the world's financial system, but this crisis very quickly transformed into a global economic crisis, affecting real economies of many countries of the world. As a result, there is no way that its effects have not been felt by individuals globally, thus threatening human security.

The Albanian Nation never an aggressor

Pëllumb Qazimi

In this article the author describes the challenges and threats regarding the territorial integrity of Albania in various periods on its history. The author emphasizes the fact that Albanians all along their history have never had invasive goals toward their neighboring countries and have only fought in order to defend their own country, freedom and peace. Some of their virtues are put in evidence by bringing examples such as the civilized example of protecting the Jewish during the Second World War. It is interesting to note that Albania was the only country in Europe that after the war had a greater number of Jewish compared with the beginning of the war. Another issue emphasized regards the fact that the existence of different religions has not been a reason for causing conflict, for intolerance and war.

INSTITUTI PËR DEMOKRACI DHE NDËRMJETËSIM
ÇËSHITJE TË SIGURISË - 13

Formati: 15.5 x 24 cm
Shtypur në Shtypshkronjën TOENA
Tel: + 355 4 240116
Tiranë, 2009